Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Strategjia e RrGK 2023-2026

© Rrjeti i Grave të Kosovës, 2022

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ky publikim mund të kopjohet dhe të shpërndahet në tërësi apo pjesërisht, duke u cituar autorët. Ky publikim është financuar nga Agjencioni Austriak për Zhvillim (ADA), përgatitur nga anëtaret e stafit të Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK), të përkrahura nga ADA, Bashkimi Evropian (BE), UN Women, Fondacioni Kvinna till Kvinna, Agjencioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), Sweden Sverige, dhe Sigrid Rausing Trust. Përmbajtja e këtij publikimi është vetëm përgjegjësi e RrGK-së dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron qëndrimin zyrtar të donatorëve të lartpërmendur.

www.womensnetwork.org

Përmbajtja

Hyrje 5

Përmirësimi i Barazisë Gjinore përmes Sundimit të Ligjit 9
Ligjet, Politikat dhe Mekanizmat Institucional 9
Situata 14
Arritjet Kryesore 22
Sfidat Kryesore 23
Strategjia e RrGK-së 28

Jeta pa dhunë me bazë gjinore 37
Ligjet, Politikat dhe Mekanizmat Institucional 37
Situata 41
Sfidat kryesore 51
Strategjia e RrGK 54
Grupet e interesit 57

Fuqizimi Ekonomik i Grave 59
Ligjet, Politikat dhe Mekanizmat Institucional 59
Situata 61
Sfidat kryesore 68
Strategjia e RrGK 69
Grupet e Interesit 72

Edukimi që transformon normat gjinore 74
Ligjet, Politikat dhe Mekanizmat Institucional 74
Situata 77
Sfidat kryesore 81
Strategjia e RrGK-së 83
Grupet e interesit 84

Qasja ndërlidhëse: Feminizmi 85
Situata 85
Sfidat kryesore 87

Strategjia e RrGK-së 90
Grupet e interesit 93

Qasja ndërlidhëse: Mbrojtja e Mjedisit 95
Ligjet, politikat dhe mekanizmat institucional 95
Analiza e situatës 95
Sfidat kryesore 96
Strategjia e RrGK-së 96

Gjithëpërfshirja 98

Monitorimi dhe Vlerësimi 100

Bibliografia 101

Hyrje

Fillimisht, në vitin 1996 u formua rrjeti i organizatave rurale të grave. Më pas, anëtaret e këtij rrjeti bashkë me organizata të tjera të grave themeluan Rrjetin e Grave të Kosovës (RrGK) në vitin 2000, si një rrjet joformal i grave dhe organizatave të cilat vepronin në rajone të ndryshme të Kosovës. Që atëherë, RrGK u zhvillua në një rrjet që avokon në emër të grave dhe vajzave kosovare në nivelin lokal, regjional dhe ndërkombëtar. Që nga regjistrimi si një organizatë formale në vitin 2003, RrGK ka rritur anëtarësinë e saj nga 42 në 192 organizata anëtare, të cilat veprojnë në 23 komuna të Kosovës.[1] Duke përfaqësuar interesat e organizatave anëtare, përfshirë këtu organizatat e grave të të gjitha grupeve etnike në mbarë Kosovën, RrGK njihet si një rrjet udhëheqës në Kosovë dhe rajon. RrGK rregullisht bashkëpunon me grupet tjera formale dhe joformale të grave në rajon dhe në nivel ndërkombëtar.

RrGK ka artikuluar dhe përfaqësuar interesat e grave dhe vajzave në disa takime në Kosovë dhe jashtë saj. Kjo ka ndikuar në vendime në nivel ndërkombëtar, duke përfshirë edhe Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. RrGK ka mbështetur nisma ndërkombëtare lidhur me proceset e paqe-bërjes, avancimit të lëvizjes feministe, rritjes së pjesëmarrjes së grave në politikë, procesin e anëtarësimit në BE dhe të përmirësimit të qasjes së organizatave të të drejtave të grave në financim. RrGK vazhdimisht ka bashkuar forcat me grupet e tjera të grave për të avokuar për çështjet me interes të përbashkët.

---

[1] Numri i anëtarëve të RrGK vazhdimisht ndryshon pasi që shumë organizata i bashkangjiten Rrjetit. RrGK përditëson rregullisht numrin e organizatave anëtare në faqen e saj të internetit.

Në vitin 2006, RrGK u bë rrjeti i parë i organizatave jo-fitimprurëse, jo-qeveritare (OJQ-ve) në Kosovë që ka miratuar Kodin e Mirësjelljes, duke vendosur një shembull të transparencës dhe llogaridhënies. Që atëherë, janë përmirësuar dukshëm kapacitetet e anëtarëve. Kodi i Mirësjelljes kërkonte nga anëtaret e RrGK që të kenë: mision të përcaktuar qartë; bord drejtues vullnetar dhe të efektshëm; burime njerëzore që kontribuojnë në arritjen e misionit; llogaridhënie financiare dhe transparencë; përgjegjësi dhe detyra në shërbim ndaj qytetarëve; dhe partneritete e rrjetëzime me organizata të tjera dhe organet jo-partiake të qeverisë.[2]

Mentorimi individual i vazhdueshëm ka kontribuar shumë në ngritjen e kapaciteteve të anëtareve të RrGK-së, përfshirë në planifikim më të mirë dhe në shkrimin e projekt-propozimeve, në menaxhimin e ciklit të projektit, sistemin për monitorim dhe vlerësim dhe në avokim përmes qasjes së "të mësuarit duke

vepruar".

Misioni i RrGK është që të përkrahë, mbrojë dhe të promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në tërë Kosovën, pavarësisht bindjeve të tyre politike, fetare, moshës, nivelit të edukimit, orientimit seksual dhe aftësive. RrGK

[2] RrGK, *Kodi mbi Etikën dhe Përgjegjësitë e RrGK-së*, Prishtinë, RrGK, 2007.

përmbush misionin e saj përmes shkëmbimit të përvojave dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimeve, hulumtimeve, avokimit dhe shërbimeve. RrGK **e ka vizion** një Kosovë në të cilën gratë dhe burrat të jenë të barabartë dhe të kenë mundësi të barabarta për arsimim, punësim, pjesëmarrje politike, kujdes shëndetësor dhe një jetë pa dhunë.

Drejt arritjes së vizionit dhe misionit të saj, RrGK ka hartuar Strategjinë për vitet 2023 – 2026 që të drejtojë punën e RrGK-së gjatë kësaj periudhe. Anëtaret e RrGK-së, Bordi Drejtues, partnerët tjerë kyç dhe palët tjera të interesit kontribuan në krijimin e Strategjisë përmes disa seancave konsultuese.

Strategjia e RrGK-së përfshin katër fusha programatike: 1. Përmirësimi i barazisë gjinore përmes sundimit të ligjit, 2. Jeta pa dhunë me bazë gjinore, 3. Fuqizimi ekonomik i grave, 4. Edukimi që transformon normat gjinore. Strategjia po ashtu përfshinë dy tema ndërlidhëse, Feminizmin dhe Mbrojtjen e Ambientit.

Këto ishin identifikuar nga anëtaret e RrGK si fushat kryesore në të cilat RrGK ka nevojë të fokusohet gjatë katër viteve të ardhshme. Për secilin nga këto programe, kjo Strategji ofron një pasqyrë të shkurtër të situatës së tanishme; arritjet kryesore të realizuara nga RrGK deri më sot; sfidat kryesore që mbeten për t'u adresuar; qëllimin afatgjatë të RrGK-së për programin; objektivat të cilat RrGK do të përpiqet t'i arrijë gjatë viteve 2023-2026; dhe rezultatet e pritura. RrGK gjithashtu ka identifikuar akterët tjerë që punojnë në këto fusha, në drejtim të nxitjes së koordinimit dhe bashkëpunimit ndaj veprimeve efikase dhe efektive.

Në kuadër të Strategjisë së saj për vitet 2023-2026, RrGK ka përfshirë edhe Strategjinë për Integrimin e Perspektivës Gjinore në Procesin e Anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE) dhe për Fuqizimin e Lëvizja Feministe. Këto strategji gjithashtu janë krijuar nga RrGK në konsultim të ngushtë me anëtaret e saj, Organizatat e Shoqërisë Civile të udhëhequra nga Gratë (OShCG), partnerët dhe palët e tjera të interesit. Kjo Strategji, e cila është integruar

brenda Strategjisë së përgjithshme të RrGK, synon të udhëheqë avokimin e ardhshëm të RrGK-së dhe partnerëve të saj drejt avancimit të një perspektive gjinore në procesin e anëtarësimit në BE. Përderisa Strategjia fokusohet në Kosovë, ajo gjithashtu përfshinë një perspektivë rajonale, duke marrë parasysh fushat potenciale për bashkëpunim dhe avokim të përbashkët me OShCG-të partnere në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor (BP). Kjo Strategji është një 'dokument i gjallë', i rishikuar rregullisht bazuar në zhvillimet dhe nevojat e reja.

Strategjia po ashtu është bazuar në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGj). Si dokument strategjik i Qeverisë së Kosovës, PKBGj i përcakton synimet, masat dhe akterët kryesor që janë përgjegjës për arritjen e barazisë gjinore në të gjitha fushat e jetës sociale, ekonomike, politike, arsimore, shëndetësore dhe kulturore për gratë dhe burrat në Kosovë. Strategjia e RrGK kontribuon në të gjitha shtyllat e Programit, përfshirë Shtyllën I: "Fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale", Shtylla II: Zhvillimi Njerëzor, Rolet, dhe Marrëdhëniet Gjinore", dhe Shtylla III: "Të Drejtat e Grave, Qasja në Drejtësi dhe Siguria". Strategjia po ashtu kontribuon në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe në Planin e Veprimit Gjinor të Bashkimit Evropian.

Përmirësimi i Barazisë Gjinore përmes Sundimit të Ligjit

Ligjet, Politikat dhe Mekanizmat Institucional

Programi i parë i Strategjisë së RrGK 2023-2026, sipas nevojës së identifikuar përgjatë viteve të kaluara, do të fokusohet në sundimin e ligjit, duke nënkuptuar njëherit se përgjithësisht, të gjitha ligjet në Kosovë janë relevante për sa i përket zbatimit të të drejtave të grave dhe vajzave si të drejta të garantuara me ligj. RrGK është e përkushtuar të mbrojë zbatimin e të gjitha të drejtave të mbrojtura me ligj, mirëpo, ky program përshkruan disa nga ligjet dhe politikat kyçe që janë veçanërisht të rëndësishme për fushat prioritare të RrGK-së në kuadër të strategjisë sonë. Disa nga këto ligje dhe politika, janë theksuar në vijim:

- Konventa e Kombeve të Bashkuara (KB) për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEDKG)[3] pohon se shtetet marrin të gjitha masat e duhura "për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në jetën politike dhe publike të vendit dhe në mënyrë të veçantë u sigurojnë grave, në të njëjtat kushte me burrat, të drejtën: (a) Për të votuar në të gjitha zgjedhjet dhe referendumet publike si dhe për të qenë të zgjedhura, në të gjitha organet e zgjedhura publikisht; (b) Për të marrë pjesë në përpunimin e politikës së shtetit dhe në zbatimin e saj; për të mbajtur poste publike dhe për të ushtruar të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisjes; (c) Për të marrë pjesë në organizatat dhe shoqatat joqeveritare që merren me jetën publike dhe politike të vendit". KEDKG është drejtpërdrejt e

[3] KEDKG.

zbatueshme në Kosovë në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

- Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (RKSOKB) 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë bën thirrje për pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje në institucionet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare në vendet pas konfliktit, duke përfshirë zgjidhjen e konflikteve dhe proceset paqësore[4].
- Këshilli Evropian miratoi propozimin për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) për Kosovën, e cila hyri në fuqi në prill të vitit 2016. Fillimisht, ky dokument ka pasur përfshirje shumë minimale të grave, pa analiza gjinore të njohura për të ofruar informata për hartimin e MSA-së. Sidoqoftë, progres është arritur në planin e veprimit të këtij dokumenti, të përditësuar gjatë viteve.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 7.2: "Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, dhe fusha të tjera të jetës shoqërore".
- Ligji për Barazi Gjinore (2015) mbështet politikën e shprehur në Kushtetutë dhe ndalon të gjitha format e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të diskriminimit gjinor.[5] Ai bën thirrje që gratë dhe burrat të kenë përfaqësim të barabartë (50/50) në pozita në të gjitha organet politike dhe publike në nivel lokal dhe qendror. Gjithashtu, Ligji bën thirrje për përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të

[4] Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (RKSOKB) 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.
[5] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Barazi Gjinore në Kosovë, Ligji nr. 05-L-020, Prishtinë: 2015.

respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve.[6]

- Në vitin 2005, u themelua Agjencia për Barazi Gjinore si institucion i veçantë qeveritar. Zyrtarët për Barazi Gjinore janë emëruar nëpër komuna, ministri, dhe disa agjenci.
- Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës[7] dhe Ligji për Zgjedhjet Lokale në Kosovë[8] përfshijnë kuotën 30% për pjesëmarrjen e grave dhe burrave në kuvendin e Republikës së Kosovës dhe kuvendet komunale. Këto dy ligje ende nuk janë në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore për pjesëmarrjen 50% të grave dhe burrave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes.
- Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026, thekson se do të kontribuoj drejt angazhimit për respektimin e të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë e konventa ndërkombëtare dhe arritjes së barazisë gjinore. Me konkretisht, Masa e tretë e kësaj objektive ka për synim përmirësimin e qasjes në drejtësi për personat dhe grupet e cenuara, në përputhje edhe me Konventën e KiE për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e cila është tanimë pjesë e Kushtetutës së Kosovës.
- Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimit ndalon diskriminimin në shumë forma, duke përfshirë atë në bazë të seksit, gjinisë, moshës, gjendjes martesore apo orientimit seksual.[9]
- Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga MSA-ja, Zyra e Kryeministrit në Kosovë ka hartuar Programin Kombëtar

---

[6] Po aty.

[7] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligji nr. 2008/03-L-073.

[8] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Ligji nr. 2008/03-L072.

[9] Kuvendi i Republikes se Kosoves, Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi.

për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA). PKZMSA-ja zëvendëson të gjitha dokumentet ekzistuese dhe strategjitë në lidhje me integrimin në BE, duke informuar procesin e pranimit të Kosovës deri në anëtarësimin eventual.[10] Fillimisht, PKZMSA gjithashtu nuk kishte një perspektivë gjinore; megjithatë, në kuadër të bashkëpunimit të RrGK-së me zyrën e Kryeministrit, specifikisht me zyrën e Integrimit Evropian (ish-Ministria e Integrimit Evropian) në kuadër të takimeve të strukturave të MSA-së, perspektiva gjinore në këtë dokument u përmirësua dukshëm.

- Në mënyrë që t'u jepet prioritet veprimeve të ndërmarra në Kosovë drejt anëtarësimit, në vitin 2016, BE-ja dhe MIE paraqitën Agjendën Evropiane të Reformave[11] Ky dokument përcakton prioritetet afatshkurtra në fushat e (I) qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, (II) konkurrencës dhe klimës së investimeve, dhe (III) arsimit dhe punësimit për Kosovën që të fokusohet në maksimizimin e përfitimeve ekonomike dhe politike të MSA-së. Pas konsultimeve që BE-ja organizoi me shoqërinë civile, perspektiva gjinore u përmirësua disi në këtë dokument, dhe këto përmirësime, reflektojnë më së miri në versionin e fundit të ARE (II)[12].
- Në kuadër të Strategjisë për Rregullim më të mirë, Institucionet e Kosovës u zotuan për përpilimin e Vlerësimeve të Ndikimit Gjinor në Politika Publike[13]. Ky zotim u theksua dhe konkretizua tutje, me manualin e

[10] Republika e Kosovës, Qeveria, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (PKZMSA), 2016.
[11] Kosovë - Dialogu i Nivelit të Lartë të BE-së mbi Prioritetet Kryesore - Agjenda Evropiane e Reformës (ERA), Prishtinë, 2016.
[12] Republika e Kosovës, Integrimi Evropian, Plani i veprimit mbi zbatimin e fazës së dytë të prioriteteve - ERA II.
[13] Republika e Kosovës, Qeveria, Zyra e Kryeministrit, Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021.

përpiluar nga Agjencia për Barazi Gjinore, e cila i udhëzon institucionet përkatëse hap pas hapi, drejt integrimit të perspektivës gjinore në politika publike përmes aplikimit të Vlerësimit të Ndikimit Gjinor.[14]

Më konkretisht, lidhur me të drejtën e grave për kujdes shëndetësor, ligjet dhe politikat e mëposhtme janë të rëndësishme për këtë Program:

- Ligji mbi Shëndetësinë[15] përfshin barazinë, gjithëpërfshirjen dhe jodiskriminimin midis parimeve të tij. Ai parasheh standarde të barabarta në kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët dhe banorët në të gjitha nivelet, si dhe siguron kujdes shëndetësor pa diskriminim 'në bazë të gjinisë apo orientimit seksual'.
- Ligji për Shëndetin Riprodhues[16] rregullon të gjitha aktivitetet në fushën e shëndetit riprodhues dhe mbron të drejtat riprodhuese të individëve duke mbuluar një spektër të gjerë çështjesh, duke përfshirë infeksionet seksualisht të transmetueshme, planifikimin e familjes, qasjen në informata, riprodhimin e asistuar dhe amësinë e sigurt.
- Ligji për Sigurimin Shëndetësor[17] parasheh që shërbimet shëndetësore të ofrohen në baza të barabarta për të gjithë personat e siguruar. Pavarësisht nga statusi i sigurimit, fëmijët mund të kenë qasje në shërbimet e kujdesit shëndetësor nga

---

[14] Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Agjencia për Barazi Gjinore, *Manuali për Vlerësimin e Ndikimit të Barazisë Gjinore*.
[15] Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji nr. 04/L-125 për shëndetësi, 2012, neni 5.1.2.
[16] Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji nr. 02/L-76 për Shëndetin Riprodhues, 2007.
[17] Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, 2014.

lista e shërbimeve themelore, dhe gratë shtatzëna ose nënat gëzojnë të drejtën për shërbimet esenciale të kujdesit shëndetësor. Ligji pritet të hyj në fuqi në një të ardhme.

- Ligji për Inspektoratin Shëndetësor[18] themelon Inspektoratin si "një autoritet administrativ të Ministrisë së Shëndetësisë që ushtron mbikëqyrjen e jashtme profesionale të institucioneve shëndetësore."

Situata

Respektimi dhe implementimi i ligjit, nënkupton realizimin e të drejtave të burrave dhe grave në Kosovë, në të gjitha fushat e jetës, dhe i kontribuon misionit të RrGK, njëherit, duke avancuar edhe qasjen në drejtësi dhe barazinë gjinore. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, i vitit 2021, thekson se drejtësia në Kosovë vazhdon të jetë e ngadaltë, jo-efektive, dhe tejet e ulët, si rrjedhojë e ndikimit politik, mes tjerash[19]. Sidoqoftë, Sundimi i Ligjit nuk nënkupton thjeshtë luftimin dhe parandalimin e dhunës në baza gjinore, por shkon përtej. Sundimi i Ligjit, nënkupton realizimin e të drejtave të të gjithë grave dhe burrave, në diversitetin e tyre, në Politikë, Arsim, Shëndetësi, Treg të punës, Ekonomi, Shërbime Sociale dhe Familjare, dhe në çështje mjedisore. Përfshirja e barabartë e grave dhe burrave në të gjitha këto sfera, nënkupton automatikisht sundimin e Ligjit, përkatësisht, të Ligjit për Barazi Gjinore, i cili garanton mundësi dhe trajtim të barabartë, në sferën publike dhe private të jetës shoqërore, duke përfshirë jetën politike dhe publike, punësimin, arsimin, shëndetësinë, ekonominë, përfitimet shoqërore, sportin, kulturën dhe sferat tjera[20].

---

[18] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji përinspektoratin shëndetësor, nr. 2006/02-L38, 2006.
[19] Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, Strasbourg, 19.10.2021.
[20] Ligji për Barazi Gjinore, Neni 2 – Fushëveprimi, 2015.

Gratë mbeten pamjaftueshëm të përfaqësuara në politikë dhe në vendimmarrje në nivel lokal dhe qendror në Kosovë. Sidoqoftë, në zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme të vitit 2021 është parë një përmirësim i situatës sa i përket zgjedhjes së grave në pozita vendimmarrëse.

Ndërkaq, në nivelin lokal, gratë vazhdojnë të mbesin të papërfaqësuara. Në zgjedhjet komunale të tetorit 2021, nga 165 kandidatë për kryetarë komunash vetëm 13 ishin gra. Si rezultat i këtyre zgjedhjeve, Kosova ka 36 kryetarë komunash, dhe vetëm dy gra serbe janë zgjedhur kryetare të komunave. Përfaqësuesit e partive politike kanë deklaruar se nënpërfaqësimi i grave është pjesërisht për shkak se gratë nuk janë të interesuara të kandidojnë në zgjedhjet për kryetar komune.

Nga 5,239 kandidatë për asamble komunale, 1,943 ishin kandidate gra (37%). Prej tyre, 364 gra janë zgjedhur këshilltare komunale ndërsa dy gra nga komuniteti ashkali dhe ai egjiptian, si dhe një grua me aftësi të kufizuara janë zgjedhur këshilltare komunale duke shënuar përmirësim në përfaqësimin e tyre krahasuar me vitet e mëparshme.

Ndërsa, në emërimin e kabinetit qeveritar, janë emëruar dy gra si zëvendëskryeministre dhe nga 15 ministri, pesë drejtohen nga gra (një rritje nga 18.8% në zgjedhjet e fundit në 33.3% në 2021).

Gratë deputete vazhdojnë të përfshihen në Grupin e Grave Deputete[21]. Ky grup ka një plan strategjik, si dhe një bord shtatë anëtarësh me nga një përfaqësues nga secila parti politike. RrGK ka mbështetur punën e tyre dhe ka bashkëpunuar në çështje me interes të përbashkët.[22]

Duke qenë se politikëbërja në Kosovë në masë të madhe është e kontrolluar nga partitë politike, këto të fundit duhet të fuqizojnë më shumë gratë dhe të respektojë Ligjin për Barazi

---

[21] Grupet parlamentare të Kosovës, *Grupet e grave*.

[22] Farnsveden, Ulf dhe Nicole Farnsworth, *Studim Gjinor* *në Kosovë,* Sida: Dhjetor 2012, f. 9.

Gjinore. Mungesa e demokratizimit brenda shumicës së partive politike dhe pjesëmarrja e pamjaftueshme e grave në vendimmarrje brenda partive historikisht ka nënkuptuar se gratë kanë pasur pak ndikim në vendimet në kuvendet lokale dhe qendrore.

Pas decentralizimit, nevojitet punë e mëtejshme për të ndërtuar kapacitetet njerëzore në nivel komunal, si dhe për të edukuar qytetarët për përgjegjësitë e reja komunale, në mënyrë që ata të mund të kërkojnë përgjegjësi nga institucionet. Duke pasur parasysh se gratë historikisht kanë pasur pak përgjegjësi në vendimmarrje në nivel komunal, fuqizimi i tyre vazhdon të mbetet vendimtar për të siguruar që gratë të kenë mundësi të barabarta dhe mund të realizojnë të drejtat e tyre për shërbimet publike.

RrGK, së bashku me akterë të tjerë, ka avokuar me sukses që ABGj të jetë e vendosur në nivelin më të lartë të vendimmarrjes (në kuadër të Zyrës së Kryeministrit), në mënyrë që ajo të jetë e pozicionuar të ndikojë në çështjet gjinore në të gjithë qeverinë dhe në të gjitha ligjet dhe politikat. ABGj, zyrtarët për barazi gjinore nëpër ministri, si dhe zyrtarët komunal për barazi gjinore, vazhdojnë të përballen me sfida. Atyre u mungojnë burimet e mjaftueshme financiare dhe njerëzore për kryerjen e përgjegjësive të tyre. Për më tepër, vullneti politik për përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse është minimal.

Me qëllim të fuqizimit të pozitës së gruas në politikë dhe vendimmarrje dhe adresimit të çështjeve të lartpërmendura, RrGK ka ndërmarrë disa iniciativa përmes Lobit për Barazi Gjinore në Kosovë (Lobi) dhe përmes FGK, duke përfshirë fushatat drejt zgjedhjes së sa më shumë grave në pozita vendimmarrëse; mbledhjen e të dhënave të grave në programe të partive politike; përfshirjen e votuesve në avokim tek autoritetet për të adresuar prioritetet e tyre në nivel lokal dhe qendror; avokimet për ndryshime të politikave; rishikimet e ligjeve dhe politikave nga perspektiva gjinore; etj. Si rezultat i

këtyre aktiviteteve, RrGK ka kontribuar në arritjet që janë përmendur në kutinë më poshtë.

Duke filluar nga viti 2000, RrGK ngadalë ka fituar qasje më të mirë në institucionet publike. Në bashkëpunim me akterë të tjerë, avokimi i RrGK-së ka kontribuar në disa ligje dhe politika në Kosovë, të cilat janë të rëndësishme nga perspektiva gjinore dhe për të drejtat e grave. Përveç kësaj, për ligjet e lartpërmendura, RrGK ka marrë pjesë edhe në hartimin dhe/ose ndryshimin e ligjeve dhe politikave në vazhdim, që prekin gratë: Ligji i Punës; Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore; Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje; Plani Kombëtar i Veprimit dhe Strategjia për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje; politikat për Mbrojtjen e grave që kanë vuajtur Dhunë Seksuale gjatë Luftës; PKZMSA; draft Plani Nacional i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2017-2019; Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-249 për Sigurimet Shëndetësore; draft Rregulloren mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve; Draft Ligji për Shërbime Sociale Familjare, Programi për Reforma Ekonomike, Agjenda e Reformave Evropiane, Draft Kodi Civil i Kosovës, Kodin Penal të Kosovës; dhe Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024, ndër të tjera.

RrGK ka përfshirë më shumë gra në avokimin për prioritetet e tyre, veçanërisht në nivelin komunal, përmes Fondit të Grave të Kosovës (FGK) dhe mbështetjen e vazhdueshme për Lobin. Kjo ka rezultuar me disa ndryshime të rëndësishme të politikave në nivel komunal, përfshirë: përmirësim të transportit publik për gratë për të pasur qasje në shkollë dhe në punë; qasje të përmirësuar në ndërtesa publike për personat me aftësi të kufizuara; vende pune për gratë e zonave rurale; hapësira publike për përdorim nga OShCG-të; zvogëlim të shpenzimeve të tyre organizative; alokimet buxhetore drejt barazisë gjinore në nivel komunal; interpretim për personat e shurdhër, në mënyrë që ata

të mund të ndjekin proceset politike dhe të kenë qasje në kujdes shëndetësor, ndër të tjera. Gjithashtu nëpërmjet Lobit, RrGK ka përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet grave nga parti të ndryshme politike dhe i ka fuqizuar ato që të avokojnë për çështjet me interes të grave në komunat e tyre.

RrGK mblodhi gratë në politikë në nivelin qendror dhe lokal, OShCG-të dhe gratë aktiviste dhe themeluan Koalicionin për Barazi, i cili ka për mision dhe vizion fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së grave në politikë dhe vendimmarrje dhe arritjen e barazisë gjinore në Kosovë, pa marrë parasysh preferencat politike, gjininë, moshën, etnicitetin, aftësinë, religjionin, pozitën gjeografike, nivelin e edukimit ose statusin shoqëror-ekonomik.

Përveç këtyre përpjekjeve, RrGK ka punuar ngushtë me gjashtë ministri dhe katër komuna për t'i mbështetur ato në institucionalizimin e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor (BPGj) në përputhje me detyrimet ligjore në Ligjin për Barazi Gjinore. Megjithatë, përkundër angazhimit të RrGK dhe përkundër përmirësimeve, BPGj ende nuk është institucionalizuar plotësisht. RrGK do të vazhdojë monitorimin e institucioneve, duke marrë parasysh që BPGj është i rëndësishëm jo vetëm për pjesëmarrjen në rritje dhe për të përmirësuar pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje, por edhe për shpërndarjen efikase dhe të drejtë të fondeve publike.

Deri më sot, përkundër disa përmirësimeve në nivelin qendror, procesit të anëtarësimit në BE vazhdon ti mungojë pjesëmarrja e mjaftueshme e grave të ndryshme.[23] Ekziston një vullnet i ngritur nga ana e qeverisë së Kosovës sidomos zyrës së Kryeministrit por edhe zyrës së BE në Kosovë, në lidhje me rëndësinë e përfshirjes së perspektivës gjinore në këtë proces, mirëpo përpjekjet për përfshirje substanciale të organizatave të

[23] Sidoqoftë, edhe burrat nuk kanë qenë mjaft të përfshirë. Megjithatë, të dhënat për pjesëmarrjen dhe përvoja e RrGK-së sugjerojnë se gratë në veçanti kanë qenë të nën-përfaqësuara. Kjo Strategji fokusohet tek gratë, duke pasur parasysh vizionin dhe misionin e RrGK-së.

grave ende mungojnë, përkundër faktit që RrGK ka shërbyer si urë lidhëse e qeverisë, me organizatat të cilat i kanë kontribuar kësaj fushe deri më tani. Diskutimet me gra të ndryshme në të gjithë vendin sugjerojnë se pak njerëz e kuptojnë se çfarë përfshinë saktësisht anëtarësimi në BE dhe se si mund të ndikojë në jetën e tyre, përfshirë *Acquis*-in e BE-së për Barazinë Gjinore. Edhe pse akterë të rëndësishëm brenda komuniteteve të tyre dhe me përvojë në arritjen e grave të ndryshme, pak OShCG kanë informata për procesin e anëtarësimit në BE.[24] Përkundër përpjekjeve të RrGK për ngritje të njohurisë së grave dhe OShCG-ve në lidhje me procesin e anëtarësimit në BE, vetëm disa OShCG u përfshinë në komentimin e projektligjeve dhe politikave të hartuara në lidhje me procesin e anëtarësimit të Kosovës në BE, përgjatë viteve të kaluara. Pak OShCG janë konsultuar në planifikimin e programeve IPA për sektorë të ndryshëm (p.sh., bujqësi, energji, mjedis, të drejtat e njeriut). Shkaqet kryesore duket se përfshijnë kuptim të pamjaftueshëm të rolit të institucioneve në lidhje me atë se çfarë OShCG-të mund t'i shtojnë procesit; dhe koha e pamjaftueshme brenda këtyre proceseve për konsultime adekuate dhe pjesëmarrëse. Fakti që OShCG-të kanë informata minimale për këto procese kontribuon në përfshirjen e tyre minimale në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e programeve IPA.[25] Kontraktuesit rrallë duket se e shohin rëndësinë e përfshirjes së grave. Burimet e kufizuara njerëzore, përkatësisht koha, për t'u angazhuar në këto procese gjithashtu pengojnë përfshirjen e OShCG-ve.

Përfshirja e pamjaftueshme e grave (dhe burrave) në procesin e anëtarësimit në BE mund të pengojë më vonë përpjekjet për të zbatuar reformat, pasi njerëzit nuk janë në dijeni të këtyre reformave ose nuk kuptojnë se si reformat e tilla janë të rëndësishme për jetën e tyre. Për më tepër, shqyrtimi i

[24] Diskutim me organizatat anëtare të RrGK-së gjatë takimit dymujor të anëtareve, nëntor 2017.
[25] Diskutimi i RrGK-së me OShCG-të, nëntor 2017.

pamjaftueshëm i interesave dhe nevojave të veçanta të grave mund të kontribuojë në një rrezik të ndryshimeve që lidhen me procesin e anëtarësimit, që nuk arrijnë t'u qasen grave apo edhe të shkaktojnë dëme.[26] Nëse këto politika injorojnë nevojat dhe interesat e grave të ndryshme, të drejtat e tyre janë në rrezik të shkelen dhe mund të ballafaqohen me diskriminim, edhe nëse është i paqëllimshëm. Nga ana tjetër, përfshirja e OSHCG-ve dhe grave në këto procese mund të përmbushin më mirë nevojat e tyre dhe potencialisht të kontribuojnë në zbatimin e reformave, pasi gratë dhe burrat e ndryshëm bëhen më të informuar dhe të përfshirë në mbështetjen e zbatimit të tyre.

Në pajtim me RKSKB 1325 dhe Planin e Veprimit Gjinor III, zyrtarët e ZBE dhe të BE-së që vizitojnë Kosovën duhet të konsultohen rregullisht me OShCG-të. Megjithatë, delegacionet politike zyrtare nga BE-ja rrallë takohen me aktivistë të të drejtave të grave gjatë vizitave të tyre në Kosovë. Për më tepër, zyrtarët vizitues shpesh takohen me aktivistë të të drejtave të grave në takime joformale pas orarit të rregullt të punës. Kjo mund të mbështesë mendimet se gratë dhe nevojat e tyre janë të parëndësishme, duke vendosur një shembull të dobët për zyrtarët qeveritarë lidhur me rëndësinë e konsultimeve me gratë për të dëgjuar perspektivat e tyre. Disa OShCG kryesore, kryesisht me bazë në Prishtinë, janë përfshirë, por shumë OShCG të vogla dhe lokale nuk janë konsultuar.

Sa i përket sektorit të shëndetësisë, të drejtave ligjore përqasje të barabartë në kujdesin shëndetësor themelor[27], riprodhues dhe gjinekologjik kualitativ mbetet e kufizuar në Kosovë. Buxheti i ulët i ndarë për shëndetësi ka rezultuar në një

[26] Për shembull, reformat që adresojnë ekonominë joformale pa analiza gjinore mund të rrezikojnë të ndikojnë negativisht në gratë nëse janë të mbipërfaqësuara në këtë sektor. Ndryshimet në ligjet e punës pa marrë parasysh rolet tradicionale gjinore të grave dhe sfidat kulturore të lidhura në Kosovë rrezikojnë të ndikojnë pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore.
[27] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi.

mungesë të pajisjeve mjekësore, një mungesë specialistësh mjekësor, cilësi të ulët të ofruesve të kujdesit shëndetësor, dhe infrastrukturë të dobët të objekteve të kujdesit shëndetësor (si p.sh. pa ashensorë apo ngrohje). Poashtu nuk ka buxhet për hulumtim dhe zhvillim të shërbimeve.

Në përgjithësi, 81% e kosovarëve e konsiderojnë shëndetin e tyre në gjendje të mirë apo shumë të mirë, edhe pse gratë mesatarisht e vlerësojnë gjendjen e shëndetit të tyre pak më keq se burrat;[28] ndërsa 23% raportojnë kufizime të dukshme gjatë jetës së tyre të përditshme për shkak të arsyeve shëndetësore.

Qasja e kufizuar në planifikim familjar dhe kontraceptivë falas ose me kosto të ulët pengon të drejtën e grave për të bërë zgjedhje të duhura në lidhje me shëndetin e tyre.[29] Edhe pse aborti (dhe ndonjëherë edhe aborti selektiv bazuar në seksin e fëmijës)[30] konsiderohet i pranueshëm në mesin e shumë grave të martuara, seksi paramartesor dhe aborti tek gratë e pamartuara janë tema tabu në shumë vende në Kosovë. Kjo ka rezultuar në abortime të pasigurta dhe në braktisje të fëmijëve nga nënat e reja. Përderisa vlerat dhe qëndrimet lidhur me marrëdhëniet seksuale paramartesore ngadalë po ndryshojnë, veçanërisht në qytete, më shumë vëmendje është e nevojshme për edukimin seksual dhe planifikimin familjar.

RrGK, përmes objektivave të vëna nën fushën e Zbatimit të Ligjit, synon të prekë:

- Ngritjen e numrit të grave në politikë, drejt zbatimit të LBGJ-së;

---

[28] RrGK, Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë, Prishtinë, 2016, në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/12/qasja.pdf; më shumë se 1,300 njerëz u anketuan si pjesë e sondazhit të realizuar në verën e vitit 2016, dhe 109 punonjës shëndetësorë dhe ekspertë të rëndësishëm u intervistuan.

[29] Po aty.

[30] Diskutime në mes të anëtareve të RrGK, gjatë takimit për hartimin e strategjisë, Durrës 2018.

- Ngritjen e perspektivës gjinore në procesin e para-anëtarësimit në BE, drejt zbatimit të PVGJ III dhe RKSKB 1325;
- Institucionalizimin e BPGJ-së, drejt zbatimit të LBGJ-së; dhe
- Përmirësimin e qasjes së grave dhe burrave në sistemin shëndetësor, drejt zbatimit të kornizës ekzistuese ligjore.

Arritjet Kryesore

- RrGK ka fuqizuar shumë gra për të kandiduar për pozita zyrtare, dhe ka kontribuar në zgjedhjen dhe emërimin e më shumë grave në postet vendimmarrëse në vitin 2021 si kurrë më parë. Në zgjedhjet parlamentare 2021, një grua kandidate ka marrë më së shumti vota se çdo kandidat në histori të Kosovës, si dhe mbi 60% e grave kanë marrë pjesë në zgjedhje. Më tej, 43 gra u zgjodhën deputete, katër më shumë se në vitin 2019, një rritje nga 32,5% në 35,8% në zgjedhjet e fundit. Vetëm nëntë gra u zgjodhën me kuotë gjinore, kurse 34 gra fituan mandatin me votën popullore.
- RrGK ka përfshirë mbi 2,058 gra të ndryshme në proceset vendimmarrëse gjatë viteve 2019-2022.
- Prej 2018, përmes iniciativave avokuese mbi 30 politika publike janë ndryshuar për të reflektuar më mirë prioritetet e grave, si rezultat i drejtpërdrejtë i mbështetjes së RrGK-së.
- Aktiv në 27 komuna, Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë, bashkon gratë e ndryshme nga shoqëria civile dhe politika. Ato kanë bashkëpunuar për të sjellë ndryshime të rëndësishme të politikave në nivel komunal.
- RrGK ka mbajtur me shume se 4,652 sesione mentorimi me grupet e Lobit gjithandej Kosovës. Këto sesione shërbejnë për të fuqizuar anëtarët e Lobit në avokimin e tyre për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore.
- Përmes këtyre dhe grupeve të tjera, gratë në politikë, OShCG-të dhe gratë votuese po komunikojnë dhe

bashkëpunojnë më tepër rreth çështjeve që gratë i konsiderojnë prioritete.

- U themelua Koalicioni për Barazi, që bashkon gratë në politikë në nivelin qendror dhe lokal, OShCG-të dhe gratë aktiviste, për fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së grave në politikë dhe vendimmarrje dhe arritjen e barazisë gjinore në Kosovë.
- Përgjatë katër viteve të kaluara, RrGK shqyrtoi nga një perspektivë gjinore dhe/ose dha informacion për mbi 60 ligje dhe dokumente të tjera të politikave. Në dokumentet kryesore në lidhje me procesin e anëtarësimit të Kosovës në BE, përqindja e rekomandimeve të integruara ka arritur tashmë në 75% (Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit – PKZMSA, Agjenda e Reformave Evropian II – ARE II, Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, Programi i Reformave Ekonomike - ERP).
- Rreth 40 organizata të grave, u përfshinë vazhdimisht në konsultimet e qeverisë dhe zyrës së BE në Kosovë, në lidhje me hartimin e dokumenteve të anëtarësimit në BE, dhe në kuadër të Nën Komiteteve, strukturave të MSA-së.
- Deri më sot, RrGK ka ndërtuar kapacitetet e më shumë se 286 zyrtarëve qeveritarë dhe 12 OShC-ve për të kryer BPGj-në.
- Me mbështetjen e RrGK, rreth 1,999 gra janë përfshirë në avokim për të drejtën e tyre për kujdes shëndetësor cilësor, zyrtarët kanë ndërmarrë të paktën 26 veprime për të adresuar çështjet që pengojnë qasjen e grave në kujdesin shëndetësor cilësor dhe 4,368 gra kanë pasur qasje në kujdesin shëndetësor që nga viti 2012.

Sfidat Kryesore

- Gratë mbeten të nënpërfaqësuara në nivel qendror, komunal dhe partiak. Gratë nuk përbëjnë 50% të pozitave vendimmarrëse në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore. Më tej, gratë ende varen kryesisht nga kuota në sigurimin e 30% të vendeve në kuvendet qendrore dhe komunale. Gratë nga grupet etnike minoritare dhe gratë me aftësi të kufizuara janë përfshirë pak më mirë se në të kaluarën por në përgjithësi ende mbeten shumë pak të përfaqësuara.
- Ligjet zgjedhore nuk janë të harmonizuara me Ligjin e ri për Barazi Gjinore.
- Avancimi i barazisë gjinore nuk është prioritet politik.
- Rrënjët e këtij problemi janë normat shoqërore, sipas të cilave gratë shpesh shihen si amvise dhe nëna, por jo si udhëheqëse politike. Normat shoqërore dhe kulturore inkurajojnë gratë të mbeten në shtëpi, ndërsa burrat punojnë në sferën publike. Standarde të tilla dekurajojnë gratë që të hyjnë në politikë.[31]
- "Oda e burrave" brenda dhe midis partive politike duket se ndikon në vendimet më të rëndësishme në Kosovë, duke lënë pak hapësirë për gratë. Mungesa e demokratizimit brenda partive politike e bën të vështirë për gratë që të shtyjnë çështje që ato i konsiderojnë prioritete.[32] Grave u mungojnë pozitat vendimmarrëse brenda partive politike dhe partitë politike vazhdojnë që të kenë kontroll të madh mbi të gjitha vendimet që bëhen në nivelet lokale dhe qendrore.[33] Në të njëjtën kohë, në mesin e aleancave të themeluara ndërmjet partive, gratë nganjëherë përballen me vështirësi në avokimin për çështjet që ndikojnë tek gratë,

---

[31] Qendra Kosovar per Studime Gjinore (QKSGJ), *Si votojnë gratë II*, Prishtinë: QKSGJ, 2013.
[32] Intervistat me gratë dhe burrat në partitë politike, shkurt 2014. Shih gjithashtu IKS, *A Power Primer*, Prishtinë: IKS, 2011.
[33] Shih IKS, *A Power Primer*.

edhe pse avokimi ndërpartiak është përmirësuar në vitet e fundit.

- Grave u mungon financimi për fushatat e tyre politike.[34]
- Edhe pse situata është përmirësuar, gratë, duke përfshirë edhe ato që konkurrojnë për poste politike, ende kanë mbulim të kufizuar dhe/ose të dobët mediatik.
- Nevojat e veçanta të grave pas luftës kanë qenë kryesisht të injoruara gjatë negociatave dhe Dialogut me Serbinë, veçanërisht të grave që kanë përjetuar dhunën seksuale, humbjen e të dashurve dhe humbje të konsiderueshme financiare. Çështja e personave të pagjetur gjithashtu nuk është adresuar në mënyrë adekuate.
- Edhe pse janë mbajtur trajnime për BPGJ me zyrtarë publik dhe aktivistët për të drejtat e grave, institucionalizimi i BPGJ-së ende vazhdon të jetë sfidë. BPGJ ende nuk është institucionalizuar apo integruar në kornizën ligjore të Kosovës, prandaj i njëjti edhe nuk aplikohet nga institucionet e Kosovës. Ende ka mungesë të analizës gjinore, e cila do të informonte më mirë aplikimin e BPGJ-së në fusha të ndryshme, përfshirë në shpenzimin e të ardhurave. Shumë gra dhe burra nuk kanë njohuri se si shpenzohen taksat e tyre dhe nëse ato shpenzohen për çështje që ndikojnë pozitivisht në jetën e tyre.
- Edhe pse është përmirësuar, OShCG-të ende nuk marrin pjesë mjaftueshëm në procesin e anëtarësimit në BE, dhe ky proces nuk është gjithmonë i informuar nga analizat gjinore dhe një perspektivë e ndërlidhur gjinore.
- OShCG-të nuk e kanë të qartë mënyrën se si ato mund t'i kontribuojnë procesit të anëtarësimit në BE, dhe çfarë roli kanë ato në strukturat e MSA-së.

---

[34] Demokracia per Zhvillim, *Kosto e Pabarazise: Financimi i Fushates Zgjedhore se Grave Kandidate*, 2021.

- PVGj III[35] mund të shërbejë si një dokument i rëndësishëm për përfshirjen e mëtejshme gjinore në proceset e pranimit në BE, aq më shumë tani që BE, dhe delegacionet përkatëse, kanë hartuar dhe publikuar Planet e Veprimit të Planit të Veprimit Gjinor në nivel vendi 2021-2025 (CLIP). [36] Megjithatë, sfidat të cilat RrGK kishte identifikuar lidhur me zbatimin e këtij dokumenti vazhdojnë të jenë aktuale. Implementimi i PVGJ III nuk është gjithmonë prioritet për BE-në.. BE-ja rregullisht mund të ngrejë çështjet lidhur me barazinë gjinore gjatë dialogëve politike, [37] por ata jo gjithmonë e bëjnë këtë.
- Në pjesën më të madhe, dokumentet e veprimit IPA III kanë përfshirë vëmendjen ndaj barazisë gjinore në analizat e situatës së tyre dhe kanë objektiva dhe tregues drejt barazisë gjinore. Disa përmbajnë tregues të ndarë sipas gjinisë aty ku është e rëndësishme, megjithëse kjo mund të përmirësohet. Përkundër kërkesës nga PVGJ III, pikat fokale gjinore, duke përfshirë ABGJ-në dhe zyrtarët e barazisë gjinore në ministri, institucione të tjera të nivelit qendror dhe komuna sugjerojnë se ata janë konsultuar minimalisht gjatë procesit të programimit të IPA-s, nëse jo aspak.
- Qeveritë nuk janë ligjërisht të obliguara të zbatojnë PVGj III. Prandaj, përveç nëse vetë legjislacioni i tyre kombëtar u dikton integrimin gjinor, të pakta janë nismat juridike nga ana e shtetit për zbatimin e PVGj III. BE-ja mund ta nxisë fuqishëm analizën gjinore dhe integrimin gjinor si pjesë e kërkesave të tyre për dhënien e financimit, por ata nuk mund

[35] EU Gender Action Plan III (PVGJ III), "An ambitious agenda for gender equality and women's empowerment in EU external".
[36] European External Action Service (EEAS), Country Level Implementation Plan, GAP III, Kosovo.
[37] Objektivi i PVGJ III, 7.1. Anagzhimi në dialog në lidhje me cështjet e barazisë gjinore me qeveritë, mekanizmat kombëtarë për barazi gjinore, parlamentin, dhe të tjerë akterë kyq institucional.

t'i *kërkojnë* domosdoshmërisht qeverive të zbatojnë PVGJ-në në lidhje me programimin për IPA-në. Në anën tjetër, qeveria e Kosovës nuk e ka publikuar ende Përgjigjen Strategjike IPA III dhe ende nuk është e qartë se cilat janë prioritetet për dritaret tematike që do të jenë pjesë e Përgjigjes Strategjike, të përgatitur nga qeveria e Kosovës.

- Ndoshta sfida më e madhe për qasjen e grave në kujdesin shëndetësor cilësor është sektori shëndetësor i financuar dobët në Kosovë. Kjo është për shkak të faktit se kujdesi shëndetësor nuk është konsideruar një prioritet në buxhetin e Kosovës. Financimi i pamjaftueshëm çon në burime dhe shërbime të dobëta.
- Edhe në vitin 2022 sigurimi shëndetësor publik ende nuk ekzistonte. Kjo parandalon disa kosovarë që të mos jenë në gjendje të përballojnë kujdesin shëndetësor cilësor. Korrupsioni dhe kontrolli i shërbimeve gjithashtu vazhdojnë të ndodhin brenda sistemit shëndetësor.[38] Duke pasur parasysh qasjen relativisht të kufizuar të grave në punë dhe burime familjare, ato janë më shumë të prekura nga kjo (megjithëse kërkimet e mëtejshme janë të nevojshme).
- Gratë me aftësi të kufizuara shpesh përballen me sfida shtesë në qasjen e kujdesit shëndetësor për shkak të lëvizjes së kufizuar, qasjes së kufizuar në hapësirat publike, mjete të pamjaftueshme financiare, dhe të kuptuarit jo adekuat të nevojave të tyre specifike.
- Gratë rurale dhe minoritare shpesh kanë qasje veçanërisht të kufizuar në realizimin e të drejtës së tyre për qasje në kujdesin shëndetësor. Posaçërisht gratë nga komunitetet

[38] UNDP, *Pulsi Publik Dokument Veprimi mbi Shëndetësinë në Kosovë: Kënaqshmëria me shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe Perceptimit mbi Praninë e Korrupsionit*, Prishtinë: UNDP, 2013.

minoritare si dhe gratë nga zonat rurale kanë qasje të limituar në kujdes shëndetësor.[39]

Strategjia e RrGK-së

Në mënyrë që të adresohen sfidat e lartpërmendura dhe për të kontribuar në objektivin e përgjithshëm të përmirësimit të barazisë gjinore përmes sundimit të ligjit, RrGK ka identifikuar objektivat e mëposhtme:

Objektivi 1.1. Rritet dhe përmirësohet pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimmarrje në nivel lokal dhe qendror sipas Ligjit për Barazi Gjinore (50%) dhe Rezolutës 1325[40]

Ngritja e nivelit të pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendim-marrje i kontribuon direkt sundimit të ligjit, duke përfshirë këtu implementimin e Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjit për Barazi Gjinore, të cilat parashohin pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave në të gjitha fushat e shoqërisë, përfshirë në vendim-marrje. Tutje, ngritja e pjesëmarrjes së grave në politikë mund të ndikojë në prioritizimin potencial dhe trajtimin e nevojave apo çështjeve të cilat gratë i konsiderojnë si prioritete, duke reflektuar kështu në barazi gjinore dhe balancim të ndjeshmërisë gjinore në proceset vendim-marrëse.

RrGK do të punojë drejt këtij objektivi përmes arritjes së rezultateve të mëposhtme.

---

[39] RrGK, *Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë*, 2016.

[40] Kjo Objektivë kontribuon në implementimin e Objektivës 3.2 të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore që thotë: "Objektivi Specifik 3.2 Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të barabartë në procesin e vendimmarrjes në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore". Objektiva po ashtu përputhet me Objektivin Specifik të PVGJ III së BE-së, "Burrat dhe gratë marrin pjesë në mënyrë të barabartë në proceset e vendimmarrjes, në të gjitha sferat dhe në të gjitha nivelet e jetës politike dhe publike, përfshirë online". Objektivi gjithashtu përkon me SDG 5, specifikisht me Objektivin 5.5: gratë janë të përfshira plotësisht dhe në mënyrë efektive dhe në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike, dhe publike.

Rezultati i pritur 1.1.1. Zhvillimi i kapaciteteve të grave në politikë për të avokuar për prioritetet e grave. RrGK do të vazhdojë fuqizimin e grave në politikë në nivele lokale dhe qendrore përmes Lobit dhe Koalicionit për Barazi Gjinore me trajnime, sesione mentorimi, rrjetëzim, dhe përkrahje në avokim.

Rezultati i pritur 1.1.2. Vetëdijesimi i rritur të zyrtarëve publik për rëndësinë e harmonizimit të Ligjit për Barazi Gjinore me ligjet zgjedhore. Ligjet zgjedhore duhet të harmonizohen me Ligjin për Barazi Gjinore, i cili konsideron përfaqësimin e barabartë gjinor si përfshirje 50% të secilës gjini. RrGK do të vazhdojë të avokojë për harmonizimin e këtyre ligjeve nëpërmjet takimeve me zyrtarë dhe fushatave vetëdijesuese në lidhje me rëndësinë e përfaqësimit të barabartë drejt qeverisjes së balancuar dhe demokratike.

Rezultati i pritur 1.1.3. Rritja e ndërgjegjësimit të zyrtarëve për nevojën për të përmirësuar integrimin e çështjeve gjinore në ligjet, politikat dhe programet. RrGK do të vazhdojë të përgatitë komentet dhe rekomandimet në ligjet, politikat dhe programet prej perspektive gjinore dhe do të dërgojmë te zyrtaret me përgjegjësit relevant. Përmirësimi i njohurisë së zyrtarëve publik në lidhje me nevojën e integrimit të perspektivës gjinore në politika publike, do të ndikojë në ngritjen e pjesëmarrjes së grave përfshirë në procese të cilat kanë për qëllim përmirësimin e kornizës ligjore dhe politikave publike, drejt sundimit të ligjit, por duke prioritizuar nevojat e grave. Fushat konkrete në të cilat integrimi i perspektivës është esencialisht i nevojshëm, janë të numërta, dhe theksohen edhe përgjatë kësaj strategjie, përfshirë çështjet mbi transportin e qasshëm, Agjendën e Gjelbër, energjinë, dhe digjitalizimin, ndër të tjera.

Rezultati i pritur 1.1.4. Rritja e ndërgjegjësimit të zyrtarëve qeveritarë, BE-së, OKB-së dhe akterëve të tjerë për rëndësinë e angazhimit të grave të ndryshme në proceset e paqes me Serbinë dhe adresimin e prioriteteve të grave në këto procese, sipas rezolutës 1325. RrGK do të vazhdojë të avokojë drejt angazhimit të grave në proceset e paqes dhe dialogut përmes avokimit, takimeve me zyrtarë publik, zyrtarë të BE-së, të OKB-së, dhe fushatave vetëdijesuese.

Rezultati i pritur 1.1.5. Përmirësimi i pjesëmarrjes së grave dhe vajzave të ndryshme në proceset e marrjes së vendimeve për çështjet e mjedisit dhe ndryshimet klimatike.[41] Specifikisht, RrGK do të hartojë një analizë gjinore në këtë fushë, do të organizojë takime dhe grupe punuese me gra të ndryshme aktive në këtë fushë, dhe do të avokojë tek institucionet përkatëse për integrim gjinor në çështjet e mjedisit dhe ndryshimet klimatike.

Objektivi 1.2. Përmirësimi i zbatimit të Planit të Veprimit Gjinor (PVGj) III të BE-së dhe perspektiva gjinore në procesin e anëtarësimit në BE.

PVGj III është një politikë publike që përmban objektiva drejt përmirësimit të drejtësisë dhe shtetit të së drejtës, ndër të tjera. Prandaj, përmirësimi i zbatimit të tij mund të kontribuojë në avancimin e sundimit të ligjit në Kosovë. Ndërkohë, RrGK do të shfrytëzojë procesin e anëtarësimit në BE përmes të cilit janë duke u miratuar ligje dhe politika të reja dhe duhet të zbatohen për t'u anëtarësuar në BE. Në këtë proces, RrGK do të kërkojë të përfshijë një perspektivë gjinore në ligjet e reja dhe të monitorojë zbatimin e ligjeve që kanë të bëjnë me procesin e anëtarësimit në BE, drejt rritjes së barazisë gjinore përmes sundimit të ligjit. RrGK do të punojë drejt këtij objektivi përmes arritjes së rezultateve të mëposhtme.

---

[41] E huazuar nga Objektiva Specifike e PVGJ III e BE-së në kuadër të Fushës Tematike: Tranzicioni i Gjelbër.

Rezultati i pritur 1.2.1. Rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve të zyrtarëve të BE-së si të zbatojnë PVGj III, veçanërisht duke përfshirë dhe mbështetur financiarisht dhe politikisht Organizatat e ndryshme të Grave të Shoqërisë Civile (OShCG). RrGK do të vazhdojë të ofrojë trajnim, mentorim dhe burime informatash për BE-në dhe shtetet anëtare, drejt zbatimit të PVGj III. Kjo përfshin monitorimin e rregullt të zbatimit të PVGj dhe avokimin që rekomandimet që rezultojnë nga monitorimi të zbatohen. Aty ku është relevante, RrGK gjithashtu mund të ndërmarrë avokim përmes takimeve, letrave dhe deklaratave.

Rezultati i pritur 1.2.2. Përmirësimi i integrimit të çështjeve gjinore në dokumentet që lidhen me anëtarësimin e Kosovës në BE dhe me zbatimin e tyre. RrGK vazhdimisht do të rishikojnë dokumente relevante që lidhen me anëtarësim në BE nga perspektiva gjinore dhe do të dërgoj rekomandime tek zyrtarët përkatës. RrGK do të avokojë për zbatimin e rekomandimeve të saj.

Rezultati i pritur 1.2.3. Përmirësimi i njohurive dhe kapacitetit të zyrtarëve të BE-së, Mekanizmave Kombëtare për Barazi Gjinore (MKBGj-së) dhe ministrive të linjës lidhur me integrimin e çështjeve gjinore në dokumentet e lidhura me anëtarësimin në BE dhe në lidhje me rëndësinë e përfshirjes së OShCG-ve në proceset e anëtarësimit në BE. Bazuar në kërkesë, RrGK do të vazhdojë të ofrojë trajnim dhe mentorim për këta akterë kyç në çështjet e përfshirjes gjinore në dokumentet e ndërlidhura me anëtarësimin në BE. Aty ku është relevante, RrGK do të ndërmarrë avokim drejt një reflektimi më të mirë të një perspektive gjinore në procesin e anëtarësimit në BE.

Rezultati i pritur 1.2.4. Përmirësimi dhe rritja e pjesëmarrjes së OShCG-ve në procesin e anëtarësimit në BE, duke përfshirë monitorimin e procesit nga perspektiva gjinore. Përmes takimeve të rregullta të RrGK-së si dhe përmes takimeve të lartpërmendura me Lobin dhe votuesit, RrGK do të informojë gratë lidhur me procesin e anëtarësimit në BE dhe se si ato mund të përfshihen. Artikujt në mediat sociale të RrGK-së dhe në buletinin elektronik gjithashtu do të mundohen të ngritin vetëdijen. Kur është relevante me punën e tyre, RrGK do të ftojë OShCG-të që të përfshihen në procese specifike, dhe t'i mentorojë ato, sipas nevojës. Poashtu Përmes takimeve dhe avokimit, strukturave të MSA-së, dhe strukturave të ngjashme konsultative, RrGK do të kërkojë të informojë më mirë ministritë, kontraktorët dhe zyrtarët e BE-së lidhur me rolin e rëndësishëm të OShCG-ve në procesin e anëtarësimit në BE, duke i inkurajuar ata që të përfshijnë më mirë OShCG-të.

Objektivi 1.3. Përmirësimi i institucionalizimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Kosovë, drejt përmirësimit të zbatimit të Ligji për Barazi Gjinore.[42]

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGj) është i rëndësishëm jo vetëm për rritjen dhe përmirësimin e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, por edhe për shpërndarjen efikase, transparente dhe të drejtë të fondeve publike. Prandaj, RrGK do të vazhdojë të monitorojë përpjekjet e institucioneve për të institucionalizuar BPGj-në. Kjo do të kontribuojë në përmirësimin e zbatimit të sundimit të ligjit sepse zbatimi i BPGj është obligim ligjor që buron nga Ligjin për Barazi Gjinore; duhet të bëhet pjesë e menaxhimit të financave publike në mënyrë që ky ligj të mund të zbatohet siç duhet. Kjo Objektivë do të kontribuoj në Kornizën Gjinore të Kornizës së Matjes së Performances të MFP të

[42] Objektivi gjithashtu përkon me SDG 5, specifikisht me Objektivin 5.c.1 Përqindja e vendeve që kanë sisteme për të identifikuar dhe për të publikuar alokimet buxhetore për barazi gjinore dhe fuqizimin e grave.

Shpenzimeve Publike dhe Përgjegjshmërisë Financiare (PEFA) si praktikë e mirë ndërkombëtare.

Rezultati i pritur 1.3.1. Politikat fiskale janë të informuara nga analiza gjinore. Me ekspertizën e brendshme për BPGj, RrGK do të kryej analiza gjinore të politikave fiskale, përfshirë këtu, ndër të tjera, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, Kornizat Afatmesme Buxhetore, Buxhetet Vjetore, Qarkoret Buxhetore.

Rezultati i pritur 1.3.2. OShC-të kanë më shumë kapacitete të avokojnë për zbatimin e BPGj. RrGK do të vazhdoj të ofroj trajnime, mentorim, grantet dhe forma të tjera të ngritjes së kapaciteteve për të gjitha OShC-të e interesuara.

Rezultati i pritur 1.3.3. Zyrtarët kanë më shumë njohuri rreth BPGj. RrGK do të vazhdoj të ofroj trajnime, mentorim, dhe forma të tjera të ngritjes së kapaciteteve për të gjithë zyrtarët relevant, përfshirë zyrtarë të buxheteve dhe financave, zyrtarë për barazi gjinore, dhe zyrtarë të tjerë.

Rezultati i pritur 1.3.4. Rritja e pjesëmarrjes së grave në konsultime publike rreth buxhetit. Përmes fushatave vetëdijesuese, grantet dhe aktiviteteve të informimit, RrGK do të punoj drejt rritjes së pjesëmarrjes së grave në konsultime publike buxhetore në nivel lokal, komunal dhe kombëtar.

Rezultati i pritur 1.3.5. OShC-të marrin pjesë në mënyrë aktive në përmirësimin e integrimit gjinor në financimin për ndryshimet klimatike. Bazuar në analizë gjinore, RrGK do të bashkëpunojë me anëtarët dhe partnerët e saj, duke përfshirë Rrjetin Mbikëqyrës të Buxhetit Gjinor, për të avokuar për përmirësime të bazuara në dëshmi për të integruar një perspektivë gjinore në financimin e lidhur me ndryshimet klimatike.

Objektiva Specifike 1.4. Përmirësimi i qasjes së grave dhe burrave për realizimin e të drejtave të tyre për shërbime shëndetësore, duke u bazuar në kornizën ligjore.
Ky objektiv synon të kontribuojë në përmirësimin e qasjes në shërbime cilësore të kujdesit shëndetësor, pa diskriminim, si një e drejtë ligjore, duke kontribuar kështu në sundimin e ligjit.

Rezultati i pritur 1.4.1. Gratë dhe vajzat janë më të vetëdijshme për të drejtën e tyre për kujdes shëndetësor dhe për rëndësinë e qasjes në kujdesin shëndetësor. Ndërgjegjësimi për të drejtat dhe rëndësinë e kujdesit parandalues është një parakusht për gratë për qasje në kujdes shëndetësor cilësor. Prandaj, përmes FGK-së, RrGK do të mbështesë OSHC-të në ngritjen e vetëdijes dhe avokimin që më shumë gra të kenë qasje në kujdes shëndetësor cilësor, bazuar në të drejtën e tyre për kujdes shëndetësor. Rritja e ndërgjegjësimit mund të përqendrohet në të drejtat dhe mbrojtjet ligjore për gratë për të pasur qasje në kujdesin shëndetësor dhe mënyrën e raportimit të shkeljeve të të drejtave, duke përfshirë çdo diskriminim në qasje në kujdesin shëndetësor bazuar në gjininë, përkatësinë etnike, aftësinë ose statusin tjetër social ose ekonomik. Anëtaret e RrGK-së do të synojnë që personat që nuk kanë qasje në informacione të tilla, duke përfshirë veçanërisht gratë në zonat rurale, personat me aftësi të kufizuara dhe disa grupe të pakicave etnike.

Rezultati i pritur 1.4.2. Më shumë gra avokojnë për të drejtat e tyre për kujdes shëndetësor cilësor. Përmes FGK, RrGK do të mbështesë përpjekjet e anëtareve për të përfshirë më shumë gra në avokimin për të drejtën e tyre për kujdes shëndetësor cilësor, sidomos kur të drejtat e tilla janë shkelur dhe/ose për t'iu drejtuar institucioneve lidhur me çështjet që minojnë qasjen e grave në kujdes shëndetësor cilësor. Iniciativat avokimit mund të përfshijnë, për shembull, avokim për institucionet që të mbledhin dhe të ruajnë të dhënat më mirë; për sigurim shëndetësor që do

të zbatohet dhe do të ofrojë qasje për të gjithë, duke përfshirë edhe gratë që punojnë në shtëpi; për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve shëndetësore të ofruara për gratë dhe burrat; për financim më të mirë nga shteti për kujdesin shëndetësor; për monitorim më të mirë të klinikave private shëndetësore; kundër diskriminimit nëse ndodh brenda institucioneve të kujdesit shëndetësor; që institucionet shëndetësore të rrisin prioritizimin e shërbimeve parandaluese; të përmirësojnë qasjen dhe infrastrukturën për personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht për gratë; dhe kundër privatizimit të kujdesit shëndetësor publik.

Grupet e interesit

Grupi i synuar dhe përfituesit kryesorë do të jenë gratë politikane në nivelet lokale dhe qendrore që do të marrin pjesë më shumë në proceset e politikës dhe vendimmarrjes, veçanërisht përmes Lobit dhe Koalicionit për Barazi. OShCG-të dhe gratë votuese gjithashtu do të jenë grupe të synuara dhe përfituese kryesore. RrGK do të fuqizojë ato të avokojnë për prioritetet e tyre dhe të luajnë rol më aktiv në proceset vendimmarrëse. Përfituesit tjerë do të përfshijnë njerëz në politikë të cilët do të mësojnë më shumë për prioritetet e grave dhe se si këto ndikojnë në shoqëri si tërësi; dhe burrat dhe fëmijët, të cilët mund të përfitojnë nga ndryshimet e politikave.

Organizatat anëtare të RrGK-së do të vazhdojnë të jenë partnere kyçe drejt realizimit të këtij qëllimi afatgjatë. Kjo do të ndihmojë edhe në uljen e dublimit të aktiviteteve dhe për të forcuar përpjekjet avokuese të grave. RrGK beson se zëri i saj do të vazhdojë të jetë më i fuqishëm kur disa organizata avokojnë së bashku. Në këtë drejtim, RrGK do të kërkojë të bashkëpunojë me OShCG-të tjera me interesa të ngjashme.

Lidhur me qasjen në kujdesin shëndetësor, grupi i synuar dhe përfituesit kryesorë po ashtu do të jenë gratë kosovare, veçanërisht ato me qasje të kufizuar në shërbime të kujdesit shëndetësor cilësor. Një grup tjetër i synuar dhe përfitues

potencial primar do të jenë zyrtarët brenda institucioneve shëndetësore, kapacitetet e të cilëve mund të rriten duke ndjekur përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit dhe avokim. Përfituesit sekondar do të përfshijnë të gjithë kosovarët, të cilët do të përfitojnë nga përmirësimet në sistemin e kujdesit shëndetësor.

RrGK do të vazhdojë të komunikojë dhe koordinojë punën e saj në këtë program edhe me akterët tjerë që kanë qëllime të ngjashme. Do të vazhdojnë të koordinohen me BE, Fondacioni Kvinna till Kvinna, Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Institutin Demokratik Kombëtar (NDI), UN Women, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), UNFPA, USAID, Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim, Helvetas Swiss Inter-cooperation, UNICEF dhe akterë të tjerë që mund të punojnë në këtë fushë në të ardhmen. Bashkëpunimi me akterët tjerë në vazhdim gjithashtu do të jetë thelbësor: BE, Sida, ABGj, Institucioni i Avokatit të Popullit, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Shëndetësisë Agjencia e Statistikave të Kosovës, Inspektorati i Shëndetësisë, deputetët dhe Komisionet Parlamentare. Sa i përket buxhetimit gjinor, RrGK do të vazhdojë bashkëpunimin e saj me Rrjeti i Mbikëqyrjes së Buxhetit Gjinor, BE, ABGj-në, Institutin e Kosovës për Administratë Publike, Ministrinë përgjegjëse për financa dhe UN Women.

RrGK parashikon se për këtë program do të marrë mbështetje nga ADA, Sida, BE dhe Fondacioni Kvinna till Kvinna.

Jeta pa dhunë me bazë gjinore

Ligjet, Politikat dhe Mekanizmat Institucional

- KEDKG te Rekomandimi 19 mbi Dhunën kundër Grave e ka vendosur parimin e përgjegjësisë së shtetit për të marrë masa adekuate për të luftuar të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë dhunën në familje, dhunën seksuale, abuzimin psikologjik, shfrytëzimin e grave (veçanërisht trafikimin), ngacmimet seksuale, dhe sterilizimin e detyruar.
- Deklarata e Parimeve Kryesore për Drejtësi ndaj Viktimave të Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit e OKB e ka caktuar bazën për intervenim dhe standardet për autoritetet për t'iu përgjigjur rasteve të dhunës familjare.[43] Këto masa u sigurojnë viktimave: përfaqësim gjyqësor; informata mbi procesin gjyqësor; dëmshpërblim gjyqësor ndaj dhunës së pësuar; mbështetje psikologjike dhe mjekësore; strehim dhe ndihmë.
- RKSKB 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë fton për mbrojtje nga dhuna seksuale gjatë luftërave. Ajo bën thirrje për drejtësi për krimet e këtij lloji.
- Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës në Familje dhe Dhunës kundër Grave e Këshillit të Evropës, e njohur ndryshe edhe si "Konventa e Stambollit", ka një definicion të gjerë të dhuna me bazë gjinore ndaj grave.[44] Ajo e kriminalizon abuzimin psikologjik, edhe pse ligjet e Kosovës

---

[43] Asambleja Gjenerale e Kombeve të Bashkuara, *Deklarata e KB-së për Parimet Bazë p*ër *Drejtësi te Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit, A / RES/40/34*, 1985.

[44] Këshilli i Evropës, Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, CETS Nr. 210, 2011.

nuk e bëjnë këtë. Që nga viti 2020 Konventa e Stambollit është pjesë e Kushtetutës së Kosovës.

- Në OZhQ-të 2015-2030, Qëllimi i Pestë mbi Barazinë Gjinore, pika 5.2 bën thirrje për eliminimin e të gjitha formave të dhunës kundër të gjitha grave dhe vajzave në sferat publike dhe private, duke përfshirë trafikimin dhe shfrytëzimin seksual dhe të llojeve të tjera, si dhe pika 5.3 mbi eliminimin e të gjitha praktikave të dëmshme, të tilla si martesa e hershme dhe e detyruar e fëmijëve dhe gjymtimi gjenital i vajzave.
- PVGJ III i BE thekson që: Barazia gjinore është vlerë themelore e BE-së dhe një e drejtë njerëzore universale. Po ashtu është parakusht për mirëqenien, rritjen ekonomike, prosperitetin, menaxhimin e mirë, paqen dhe sigurinë." Një ndër fushat tematike të PVGJ III është "Liria nga të gjitha format e dhunës në bazë gjinore,
- Kodi Penal i Kosovës[45] dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës [46] përfshin një numër të veprave penale të kryera në marrëdhëniet e brendshme familjare që mund të konsiderohen si dhunë familjare. Ato përmbajnë dispozita rreth formave të tjera të dhunës ndaj grave, si p.sh përdhunimi (përfshirë edhe dhunimin e të miturve), dhuna seksuale, trafikimi dhe forma të tjera të shfrytëzimit seksual.
- Ligji për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje synon parandalimin e dhunës, mbrojtjen e viktimave, trajtimin e kryerësve, dhe zbutjen e pasojave të dhunës në familje.[47]

---

[45] Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Kodi Penal i Kosovës*. 2019, Nr 06/L-074.

[46] Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Kodi i Procedurës penale* t*ë Kosovës*. 2013. Nr. 04/L-123.

[47] Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna Familjare*, Ligji nr. 03 / L-182, 2010.

Përshkruan procedurat dhe përmbajtjen e urdhrave të mbrojtjes. Në vitin 2022, ai ishte në proces ndryshimi.

- Ligji për Parandalimin dhe Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit kërkon të adresojë këtë problem dhe pasojat e tij.[48]
- Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile të Luftës dhe familjeve të tyre u ndryshua në vitin 2014 për të përfshirë gratë viktima të dhunës seksuale si të mbijetuara civile të luftës.[49]
- Ligji kundër Diskriminimit ndalon diskriminimin dhe ngacmimet, duke përfshirë sjelljen e padëshiruar seksuale dhe psikologjike që shkel dinjitetin e një personi.[50]
- Ligji për Barazi Gjinore thekson se ngacmimi seksual përbën diskriminim gjinor; dhe ndalon ngacmimin seksual në vendin e punës.[51]
- Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare përfshin dispozita për të ndihmuar personat në nevojë, si p.sh personat që kanë vuajtur dhunën në familje apo trafikim të qenieve njerëzore.[52] Në vitin 2022, ai ishte në proces ndryshimi.
- Protokolli Shtetëror i Trajtimit të Rasteve të Dhunës Seksuale në Republikën e Kosovës ka për qëllim standardizimin e veprimeve të nevojshme për një reagim të vazhdueshëm, gjithëpërfshirës e me përgjegjshmëri, për

---

[48] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, 2013, Ligji nr. 04 / L-218.

[49] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Rreth Statusit dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile të Luftës dhe Familjeve të tyre, Ligji nr. 2011/4-L-061 2014.

[50] Kuvendi i Kosovës, Ligji No. 05/L-021 - Ligji kundër Diskriminimit, 2015.

[51] Kuvendi i Kosovës, Ligji No. 05/L-020 - Ligji për Barazi Gjinore.

[52] Kuvendi i Kosovës, Ligji mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit No. 02/L-17 mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare, 2012.

identifikimin, mbrojtjen, trajtimin, dokumentimin, referimin, rehabilitimin dhe ri-integrimin e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të sulmeve dhe dhunës seksuale, përmes ndërhyrjeve të menjëhershme dhe profesionale të institucioneve përgjegjëse.

- Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2015-2019 ka për qëllim të koordinojë luftën kundër trafikimit.
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit (2022-2026)[53] synon për të "(a) fuqizuar mekanizmat ekzistues dhe për të themeluar mekanizma të rinj për reagim të shpejtë për mbrojtën dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje; (b) për të koordinuar veprimet dhe siguruar qëndrueshmëri financiare për të parandaluar, mbrojtur, trajtuar, rehabilituar dhe riintegruar viktimat të cilave duhet t'ju jepet mundësia të jetojnë të barabartë dhe me dinjitet si të gjithë anëtarët e tjerë të familjes e shoqërisë; (c) marrë masat adekuate për ndëshkimin (vënien përpara përgjegjësisë) dhe rehabilitimin e vazhdueshëm të kryesve të dhunës, si dhe (d) për të organizuar aktivitete informuese dhe fushata vetëdijesuese për angazhimin e mbarë shoqërisë kundër dhunës në familje"[54].
- Procedurat Standarde Operative (PSO) ofrojnë një kornizë mjaft gjithëpërfshirëse për 1) t'iu përgjigjur raporteve të dhunës familjare; dhe 2) marrjen e masave anti-trafik. Në vitin 2022, ishin në proces ndryshimi.
- Policia e Kosovës ka Njësitë e Hetimit të Dhunës Familjare në çdo stacion me dy oficerë të trajnuar mbi dhunën në familje (një grua dhe një burrë) në gjendje gatishmërie 24/7.

---

[53] Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Drejtësisë, Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026.
[54] Po aty.

Situata

Çdo formë e dhunës që ushtrohet nga një person ndaj një personi tjetër, vetëm për shkak të gjinisë së tij apo saj quhet dhunë me bazë gjinore. Dhuna ekonomike, fizike, psikologjike dhe seksuale janë disa forma të dhunës me bazë gjinore. Në Kosovë dhe në botë, forma më e shprehur e dhunës është dhuna në familje, përfshirë dhunën nga partnerët intim. Në raportin hulumtues të vitit 2015 *Mjaft më me Arsyetime*, RrGK ka gjetur se mbi 68% e grave në Kosovë kanë përjetuar dhunë në familje gjatë jetës së tyre (56% e burrave). Vetëm në vitin 2014, 42% e grave dhe 20% e burrave thanë se ata kanë vuajtur nga dhuna në familje.[55]

Edhe pse ekzistojnë bindje në mesin e qytetarëve se dhuna në familje ndodh kryesisht tek familjet e varfra, tek familjet ku anëtarët e familjes janë të paarsimuar, apo në vendet rurale, hulumtimi i RrGK i bërë në vitin 2015, ka dëshmuar të kundërtën. Bazuar në këtë hulumtim, nuk është vënë re ndonjë ndërlidhje në mes të prejardhjes gjeografike, arsimit apo kushteve ekonomike dhe përjetimit të dhunës në familje. Gratë janë shprehur të kenë përjetuar më shumë dhunë nga prindërit dhe nga partnerët, ndërsa burrat që kanë përjetuar dhunë, kanë përmend prindërit si ushtruesit kryesor të dhunës ndaj tyre. Një e gjetur mjaft interesante është se gratë që ishin në lidhje me partnerë të punësuar, kishin të ngjarë të përjetojnë më shumë dhunë në vitin 2014, sesa gratë partnerët e të cilave ishin të papunësuar. Sa i përket vetëdijes së qytetarëve rreth asaj se ku mund të adresohet dhuna në familje, 73,6% e tyre u përgjigjën se do ta kontaktonin policinë, ndërsa shumë pak përmendën institucionet tjera siç janë: Qendra për Punë Sociale apo Mbrojtësit e Viktimave.

Në vitin 2017, RrGK monitoroi ecurinë e zbatimit të kornizës ligjore në lidhje me dhunën me bazë gjinore, si dhe të

---

[55] Farnsworth, Nicole, Ariana Qosaj Mustafa, Iliriana Banjska, Adelina Berisha dhe Donjeta Morina, për RrGK, *Mjaft më me arsyetime*, Prishtinë, 2015, f. 5.

Strategjisë së Republikës së Kosovës dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016-2020. Ky raport i RrGK i publikuar në vitin 2018, i titulluar "Nga Fjalët në Vepra?", tregoi se është realizuar vetëm 19% e Strategjisë Kombëtare.[56] Monitorimi i RrGK-së sa i përket performancës së institucioneve, tregon se janë bërë disa përmirësime në zbatimin e kornizës ligjore në lidhje me dhunën në familje. Megjithatë, mbeten disa mangësi në lidhje me reagimin institucional ndaj formave të tjera të dhunës me bazë gjinore. Për shembull, përderisa Policia e Kosovës, veçanërisht Njësia kundër Dhunës në Familje kanë njohuri për dhunën në familje, ata kanë mungesë të njohurive për ngacmimin seksual apo trajtimin me dinjitetit të rasteve të përdhunimeve, veçanërisht një qasje të ndjeshme që mbron dinjitetin e personave që kanë vuajtur krime të tilla. Prokuroria Themelore ka emëruar prokurorë të cilët do të merren me rastet e dhunës në familje. Ata kanë njohuri sa i përket dhunës në familje, por njëjtë edhe ata kanë mungesë njohurish mbi format e tjera të dhunës ndaj grave apo mbi rëndësinë e të kuptuarit të marrëdhënies së pushtetit në mes të burrave dhe grave. Përderisa prokurorët kanë njohuri përkitazi me kornizën ligjore në ofrim të mbrojtjes së viktimave të krimit, ngarkesa që ata kanë me lëndë të ndryshme mund të ndikojë në performancën e tyre, thekson RrGK. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) gjithashtu ka emëruar gjykatës që do të merren me rastet e dhunës në familje, si në departamentin civil ashtu edhe në atë penal. Përderisa disa kanë ndjekur trajnime, disa gjykatës ende tentojnë të "fajësojnë viktimën"[57].

Nga të dhënat e KGjK del se prej 5,024 raste të dhunës me bazë gjinore të zgjidhura nga viti 2015 deri në vitin 2017, 73% rezultojnë me ndonjë formë dënimi. Në 1% të rasteve, janë liruar nga akuzat, 2% janë refuzuar nga gjykata, 16% janë mbyllur për shkak të parashkrimit dhe 8% janë zgjidhur në mënyra të

[56] RrGK, *Nga fjalët në vepra?*, Prishtinë: RrGK, 2018.
[57] RrGK, *Nga fjalët në vepra?*, f. 3.

ndryshme. Midis 76 rasteve të zgjidhura dhe që kishin të bënin me dhunën seksuale, 59% kanë rezultuar me ndonjë formë dënimi, 4% janë liruar nga akuzat, 5% janë refuzuar nga gjykata, 8% janë mbyllur për shkak të parashkrimit dhe 24% janë zgjidhur në mënyra të ndryshme. Pa marrë parasysh rrethanat specifike të secilit rast, kjo lë të kuptohet se rastet e dhunës seksuale kanë më pak të ngjarë të ndëshkohen dhe kanë më shumë të ngjarë të lirohen nga akuzat, apo të refuzohen nga gjykatat. RrGK poashtu ka gjetur se ato në mënyrë të konsiderueshme kanë më shumë të ngjarë të "zgjidhen ndryshe" në krahasim me rastet që kanë të bëjnë me krime të tjera.[58]

Në vitin 2021, RrGK përsëriti hulumtimin për monitorim të zbatimit të kornizës ligjore në lidhje me dhunën me bazë gjinore si dhe monitorim të Strategjisë së Republikës së Kosovës dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016-2020. Përveç kësaj, përmes këtij hulumtimi RrGK identifikoi boshllëqet e mbetura në kornizën ligjore të Kosovës drejt zbatimit të Konventës së Stambollit dhe për të informuar proceset në vazhdim me një vlerësim të njohurive, qëndrimeve dhe performancës së institucioneve përgjegjëse në zbatimin e kornizës ligjore përkatëse. Raporti "Nga Ligjet në Vepra", i publikuar në 2021, tregon se vetëm 52% e Strategjisë Kombëtare është realizuar.[59] Monitorimi i RrGK-së dhe intervistimi i përfaqësuesve në institucione, tregon se ka përmirësime në lidhje me dhunën në familje. Megjithatë, zyrtarët institucional kanë më shumë njohuri rreth

[58] Po aty, f. 53.
[59] RrGK, *Nga Ligjet në Vepra*, Prishtinë: RrGK, 2021.

dhunës në familje por jo rreth dhunës me bazë gjinore në përgjithësi. Zyrtarët kanë mungesë të njohurive për ngacmimin seksual, përdhunimin, gjymtimin e organeve gjenitale dhe në shumicën e rasteve ngatërrojnë ngacmimin seksual me sulmin seksual. Prokurorët e emëruar nga Prokuroria Themelore për trajtim të rasteve të dhunës në familje kanë njohuri sa i përket dhunës në familje dhe formave të tjera por kanë pasiguri në lidhje me mënyrën se si të përdorët vepra e re penale e dhunës në familje, veçanërisht në kombinim me vepra të tjera. Emërimi i gjyqtarëve në departamentin civil dhe penal që trajtojnë raste të dhunës në familje nga KGjK nuk mungon. Por, pavarësisht trajnimeve të shumta që kanë ndjekur, gjykatësit ende priren të pajtojnë qiftet kur ndodhë dhuna në familja, megjithëse kjo nuk është brenda mandatit të tyre kur gratë dhe fëmijët janë në rrezik të dhunës. Monitorimi i RrGK-së tregon që vonesat vazhdojnë, duke i vendosur gratë në rrezik të madh të dhunës së mëtejshme. Fenomeni i grave që "tërheqin" dëshmitë e tyre dhe akuzave penale që u hodhën siç duket vazhdon, pavarësisht nga detyrimet e qarta ligjore për të vazhduar sipas detyrës zyrtare ndjekjen penale. Dënimi për krimet e dhunës në familje ende mbetet i ulët.

Një formë tjetër e dhunës seksuale është ajo e kryer ndaj grave gjatë luftës në Kosovë. Dhuna seksuale, duke përfshirë përdhunimin, është përdorur si një armë lufte kundër civilëve.[60] Kjo përfshinte lënien shtatzënë në mënyrë të dhunshme të grave nga forcat serbe, e cila është përdorur si një taktikë e spastrimit etnik.[61] Në përgjithësi, burimet e ndryshme kanë vlerësuar se

---

[60] Shih Human Rights Watch (HRW), Shkeljet e të Drejtës Njerëzore në Kosovë, SHBA: HRW, 1998; HRW, Një Javë Tmerri në Drenicë: Shkeljet e të Drejtës Njerëzore në Kosovë, SHBA: HRW, 1999; OSBE, Kosove / Kosova: Siç shihet, si tha, Pjesa III; UNFPA, Dhuna Gjinore në Kosovë, Prishtinë: UNFPA, 2005, f. 6; dhe Chris Corrin, "Situata post-konfliktuoze në Kosovë" në Nëse jo tani, kur?, 2001, f. 93.

[61] HRW, Kosova: Dhunimi si armë e spastrimit etnik; OSBE, Kosovë /

prej 10 deri 45 mijë gra u përdhunuan gjatë luftës.[62] Dhuna seksuale gjithashtu është raportuar të jetë ushtruar ndaj burrave dhe djemve, dhe poashtu ndaj grave të etnive të ndryshme edhe pse kjo ka qenë më pak e folur në publik. Për këtë krim thuajse nuk ka pasur drejtësi.[63] Gratë që kanë vuajtur dhunën seksuale gjatë luftës përballen me vështirësi të qëndrimit në izolim, trauma të patrajtuara, sëmundje fizike dhe varfëri.[64]

Në dhjetor 2022, në Prishtinë u lansua Protokolli i parë Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale, në pajtim me Konventën e Stambollit. Ky proces është asistuar nga RrGK në bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë dhe të gjitha institucionet relevante për punën, udhëheqjen dhe bashkëpunimin në finalizimin e këtij Protokolli, në veçanti Institutin e Mjekësisë Ligjore, Ministrinë e Drejtësisë dhe UN Women. RrGK e ka mbështetur këtë proces duke marrë pjesë në grupet punuese qeveritare, përfshirë kontraktimin e ekspertes që e ka hartuar Protokollin, Dr. Monika Kocaqi; duke plotësuar draftin me të dhëna nga hulumtimet dhe përvojat tona dhe duke organizuar konsultime me 142 përfaqësues të mekanizmave koordinues në nëntë komuna/rajone në të gjithë Kosovën. Tani që protokolli është miratuar, qeveria duhet të alokojë mjete për implementimin e tij dhe duhet t'i reflektojë përgjegjësitë e specifikuara në protokoll për institucionet përkatëse edhe në Ligjin e ardhshëm për Mbrojtje nga Dhuna me Bazë Gjinore. Këtu duhet të përfshihen edhe mjetet e alokuara dhe specifikimi i nevojës së funksionalizimit të qendrave referuese për menaxhim të krizave të përdhunimit dhe atyre të dhunës seksuale.

Kosova, siç shihet, si tha; Coomaraswamy, para. 82; Corrin, "Situata post-konfliktuoze në Kosovë," f. 93; dhe UNIFEM, f. 62.

[62] Nga Farnsworth, Nicole për RrGK, Hulumtim Kërkimor mbi Shkallën e Dhunës me Bazë Gjinore në Kosovë dhe Ndikimi i saj në Shëndetin riprodhues të grave, RrGK, Prishtinë: 2008.

[63] Shih RrGK, *Fakte dhe Fabula për Rezolutën 1325*, Prishtinë: RrGK, 2022.

[64] Diskutimet e anëtareve të RrGK me gra.

Forca e madhe ushtarake "paqeruajtëse" në Kosovë menjëherë pas luftës ka krijuar një kërkesë për shërbime seksuale e cila rezultoi me rritje të trafikimit, veçanërisht të grave dhe vajzave.[65] Trafikimi për shfrytëzim seksual duket se ka rënë prej vitit 2002. Qeveria i identifikoi 22 viktima, krahasuar me 17 viktima në vitin 2020. Prej tyre, 19 ishin viktima të trafikimit seksual.[66] për shërbime seksuale nuk ka marrë vëmendjen e mjaftueshme publike në Kosovë. Pabarazitë gjinore që mbështesin dhe potencialisht kontribuojnë në prostitucion gjithashtu nuk janë diskutuar fare. Edhe pse RrGK nuk punon direkt me rastet e trafikimit, organizatat anëtare të RrGK janë të përfshira direkt në këtë fushë.

Ngacmimet seksuale ndodhin në vendin e punës, shkolla, universitete dhe institucione publike. Në vitin 2016, RrGK publikoi raportin "Ngacmimi Seksual në Kosovë", rezultatet e të cilit treguan se rreth 48.5% e kosovarëve kanë përjetuar ngacmim seksual në jetën e tyre. Vetëm në vitin 2014, u deklaruan të kenë përjetuar ngacmim seksual 45.2% e kosovarëve. Gratë dhe vajzat janë më të prekura nga ngacmimi seksual duke përbërë 64.1% të rasteve. Një studim i Qendrës për Studime Gjinore të Kosovës i vitit 2010 verifikoi se 16.6% e nëpunësve civil kishin përjetuar ngacmime seksuale të paktën një herë gjatë karrierës së tyre.[67] Ndërkaq, fokus grupet që janë mbajtur në Universitetin e Prishtinës (UP) kanë sugjeruar se ngacmimi seksual është me sa duket i përhapur, por jo i raportuar sa duhet. Edhe kur është raportuar, është injoruar. Për të adresuar nevojat e studentëve dhe të stafit akademik dhe administrativ të UP-së, RrGK në bashkëpunim me disa organizata anëtare, stafin dhe studentët e UP-së, kanë ndërmarrë disa

---

[65] RrGK, *1325 Fakte & Fabula*.

[66] US Embassy, *Raporti i vitit 2022 mbi trafikimin e personave Kosova* (Niveli 2).

[67] Demolli, Luljeta për QKSGJ, *Perceptimet e shërbyesve civilë Lidhur me ngacmimin seksual në vendin e punës, Prishtinë*: QKSGJ, 2010, f. 10.

iniciativa për të përmirësuar raportimin dhe trajtimin e ngacmimeve seksuale në UP. Kjo përfshinë përkrahjen e hartimit të rregullores për raportimin e ngacmimeve seksuale, krijimit të mekanizmave raportues dhe krijimin e planit të veprimit për parandalim dhe mbrojtje nga ngacmimi seksual.

Legjislacioni aktual është mjaftë konfuz sa i përket raportimit të ngacmimeve seksual.[68] Në vitin 2017 dhe 2018, RrGK ka avokuar për futjen e ngacmimit seksual si një vepër e veçantë penale në Kodin Penal, definicion ky që u pranua nga Ministria e Drejtësisë dhe Kuvendi i Kosovës, e që hyri në fuqi nga viti 2019.

Dhuna me bazë gjinore prek gjithashtu edhe personat Lesbike, Gej, Biseksualë, Transgjinorë dhe Intersex (LGBTI). Edhe pse Kushtetuta dhe Ligji kundër Diskriminimit e adresojnë diskriminimin e tillë, përgjigjet institucionale dhe mekanizmat e raportimit mbeten të zbehta.[69] Shumë persona LGBTI kanë qenë subjekt i ngacmimeve verbale dhe dhunës fizike.[70] Me sa duket, perceptimet e përhapura publike rreth personave LGBTI sugjerojnë nevojën për rritjen e mëtejshëm të ndërgjegjësimit në lidhje me të drejtat e komunitetit LGBTI.

Gratë me aftësi të kufizuara gjithashtu mund të përballen me sfida të shtuara në qasjen e shërbimeve kur përballen me dhunën me bazë gjinore për shkak të sfidave të shtuara me të cilat

---

[68] RrGK, *Ngacmimi Seksual në Kosovë*, Prishtinë: RrGK, 2018.

[69] Intervistat e RrGK, 2014.

[70] Shih: Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR) dhe Qendra për Zhvillimin Social Group, *Liri dhe Mbrojtje për lezbiket, homoseksualët, Bisexuals and transgjinoret në Kosovë*, Prishtinë: YIHR, 2013; Savić, Marija për Fondin Heartefact, *LGBT Invisible: Raport mbi pozitën e komunitetit LGBT në Kosovë*, Beograd: Fondi Heartefact, janar 2013; Huygens, Pierre, Eva Marn, dhe Nenad Maksimović, *Gjendja dhe Analiza Përgjigje: Vulnerability LGBT në Kosovë në vitin 2012: Në emër të "Traditës"*, 2013; Libertas, *Anketa mbi qëndrimet e shoqërisë kosovare ndaj homoseksualitetit: hulumtim sasior dhe cilësor mbi opinionet e qytetarëve të Kosovës*, Prishtinë: Libertas, 2012; Parlamenti Evropian gjithashtu ka shprehur shqetësimin lidhur me diskriminimin në bazë të orientimit seksual në Rezolutën e tij 29 mars 2012 Më Procesin e Integrimit Evropian të Kosovës, 2011/2885 (RSP), parag. 38.

përballen me izolimin, transportin e qasshëm dhe qasjen në informacion për të drejtat e tyre.

Siguria e përgjithshme e grave dhe burrave ngrit disa shqetësime të tjera. RKSKB 1325 bën thirrje për sigurinë e grave dhe vajzave në situatat post-konfliktuale. Megjithatë, infrastruktura e dobët në Kosovë, si ndriçimi i pamjaftueshëm i vendeve publike gjatë natës, mund të krijojnë një mjedis të përshtatshëm për dhunën me bazë gjinore. Grupet Lokale të Veprimit dhe Këshillat e Sigurisë në Bashkësi kanë iniciuar disa projekte për të adresuar çështje të tilla, duke përfshirë shtimin e dritave në rrugë dhe që të merren parasysh faktorë të tillë si udhëtimi i vajzave dhe grave për në punë dhe shkollë. Gratë në veri të Kosovës mund të përballen me shqetësime të tjera të sigurisë si rezultat i sundimit të dobët të ligjit dhe mosmarrëveshjeve mbi kompetencat institucionale mes Kosovës dhe Serbisë, së bashku me gjendjen e përgjithshme të pasigurisë atje.[71]

RrGK ka organizuar disa fushata kombëtare që kanë zvogëluar paragjykimet ndaj personave të cilët kanë vuajtur nga dhuna me bazë gjinore dhe ka inkurajuar njerëzit për të raportuar dhunën duke e shndërruar atë nga një çështje private në një çështje shumë publike. Puna e RrGK-së në lidhje me këtë program në vitet e mëparshme ka treguar disa rezultate (shih kutinë).

[71] RrGK, "Një ulëse në tryezë, Kontributi i grave në proceset e ndërtimit të paqes në Kosovë dhe pritjet e tyre nga këto procese", 2021.

Arritjet kryesore të RrGK

- RrGK ka bashkëpunuar me ekspertët dhe anëtaret e saj për të hulumtuar dhe siguruar të dhëna për miratimin e shumicës së ligjeve dhe politikave të lartpërmendura drejt adresimit të dhunës me bazë gjinore në Kosovë. Për shembull, RrGK ka kontribuar në draftimin ePlanit të Veprimit të ERA II, nga perspektiva gjinore t, ku janë përfshirë 70% e rekomandimeve të RrGK Rekomandimet e RrGK-së gjithashtu janë marrë parasysh në ndryshimet e fundit të Kodit Penal për të përfshirë ngacmimin seksual dhe dhunën në familje si vepra penale, Programin për Reforma në Ekonomi, Strategjinë për Sundim të Ligjit, Programin Kombëtar për Barazi Gjinore 2020-2024, mes tjerash.
- Monitorimi i vazhdueshëm i RrGK ndaj institucioneve, i cili ka përfshirë hulumtime periodike dhe publikim të gjetjeve, ka ndihmuar që të ngrisë vetëdijen e institucioneve dhe llogaridhënien e tyre në lidhje me rastet e dhunës me bazë gjinore, dhe me një angazhim më të theksuar në definimin e përgjegjësive institucionale.
- Pas avokimit të RrGK-së dhe organizatave anëtare të saj, tani janë vendosur 19 politika për adresimin e ngacmimeve seksuale.
- Në dhjetor 2022, në Prishtinë u lansua Protokolli i parë Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale, në pajtim me Konventën e Stambollit. Ky proces është asistuar nga RrGK në bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë dhe të gjitha institucionet relevante për punën, udhëheqjen dhe bashkëpunimin në finalizimin e këtij Protokolli, në veçanti Institutin e Mjekësisë Ligjore, Ministrinë e Drejtësisë dhe UN Women.
- RrGK poashtu ka punuar ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë dhe me mekanizmat koordinues lokalë, duke i trajnuar ata në lidhje me trajtim dhe menaxhim më të mirë të rasteve të dhunës.

Arritjet kryesore të RrGK

- RrGK ka mbështetur strehimoret duke avokuar me sukses për financim nga Qeveria, për të mbështetur ofrimin e shërbimeve të strehimoreve.
- RrGK dhe anëtaret e saj kanë zgjeruar kapacitetet e policisë, si dhe të forcave paqeruajtëse vendore dhe ndërkombëtare, lidhur me mënyrat e përshtatshme për të bashkëvepruar me gratë që kanë përjetuar dhunë me bazë gjinore.
- Përmes një demonstrate me 8 marsit 2012, RrGK ka tërhequr vëmendjen e publikut rreth mungesës së njohjes, shërbimeve dhe ndihmës për gratë që kanë vuajtur dhunë seksuale gjatë luftës. Kjo rezultoi në dispozita të reja ligjore për mbrojtjen e tyre. RrGK gjithashtu mbështeti krijimin e Këshillit Kombëtar të Presidentit për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë Luftës. RrGK dhe organizatat anëtare të saj kanë ndërmarrë më shumë se 30 iniciativa për të mbështetur gratë që kanë pësuar dhunë seksuale gjatë luftës.
- RrGK ka mbështetur përmirësimin e koordinimit ndërmjet akterëve të ndryshëm lokal dhe ndërkombëtarë që punojnë në çështjet e trafikimit dhe dhunës në familje. Kjo përfshinte avokimin për koordinatorët kombëtarë për dhunën në familje dhe të trafikimit, respektivisht, të cilët monitorojnë dhe raportojnë mbi zbatimin e ligjeve dhe të politikave ekzistuese.
- Institucionet kanë zbatuar më shumë se 41 rekomandime të RrGK, dhe 122 rekomandime u dërguan nga RrGK për përmirësimin e Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave, 36 nga ato u aprovuan.
- 84 rekomandime u dërguan nga RrGK për të përmirësuar Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, ligji ende nuk u miratua.
- Së paku 117 gra që kanë pësuar dhunë me bazë gjinore kanë marrë ndihmë juridike nga RrGK dhe partnerët e saj.
- Përmes fushatave vetëdijesuese, më shumë se 250 qytetarë u vetëdijesuan për të drejtat e tyre dhe përgjegjësitë e institucioneve.

Sfidat kryesore

Korniza ligjore dhe institucionale për adresimin e dhunës me bazë gjinore është gjithëpërfshirëse dhe koordinimi në mes të OShCG-ve dhe institucioneve përgjegjëse është rritur. Megjithatë, disa sfida mbeten të lidhura me normat shoqërore dhe zbatimin e kuadrit ligjor:

- Në vitin 2022, korniza ligjore nuk është plotësisht e harmonizuar me Konventën e Stambollit. Duhet të krijohet ligji për trajtimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore (dhe jo vetëm dhunës në familje); të qartësohen përgjegjësitë e institucioneve, duke përfshirë përmirësimin e koordinimit në menaxhimin e rasteve; të përmirësohen sistemet e menaxhimit të të dhënave; zhvillimi i kapaciteteve për institucionet përgjegjëse; dhe të alokohet buxhet adekuat. Qendra e Krizave të Përdhunimeve, Qendrat e Referimit të Dhunës Seksuale dhe linja telefonike SOS, ende duhen të krijohen, ashtu siç kërkohet nga Konventa e Stambollit.
- Individët shpesh ia atribuojnë dhunën në familje situatës së vështirë ekonomike, papunësisë, alkoolit, traumave nga lufta, si dhe mungesës së arsimimit. Kjo në mënyrë false justifikon dhunën dhe dekurajon njerëzit nga raportimi i dhunës në polici.[72]
- Martesat zakonisht përfundojnë me divorc nëse raportohet dhuna dhe shumë gra nuk kanë burime të mjaftueshme financiare për të mbështetur veten pas divorcit.[73] Gjendja relativisht e dobët financiare e grave është një arsye e zakonshme sipas të cilës gjykatat ia japin kujdestarinë e fëmijës dhunuesit burrë; gjendja ekonomike e burrave

[72] UNDP, *Pulsit Publik Gjinor*, f. 39; RrGK, *Siguria fillon në shtëpi*, f. 16-22.
[73] Për më shumë informacion, shih RrGK, *Më shumë se vetëm "Fjalë në Letër"? Përgjigja e Organeve të Drejtësisë ndaj Dhunës në Familje në Kosovë*, Prishtinë: RrGK, 2009.

prioritizohet për mirëqenien fizike dhe psikologjike të fëmijës. Dhënia e kujdestarisë së fëmijës tek kryesi i veprës mund t'i vë fëmijët në rrezik të madh të dhunës dhe mund të tregojë që gratë nuk e raportojnë dhunën në familje.[74]

- Vonesat mbeten në kuadër të sistemit gjyqësor në dorëzimin e vendimeve dhe lëshimin e urdhrave të mbrojtjes në kuadër të kornizës ligjore të nevojshme.[75]
- Perceptimet patriarkale të ngulitura në shoqëri mund të ndikojnë negativisht në opinionet gjyqësore dhe në rrjedhën e procedurës.[76] Gjykatat dhe avokatët preferojnë pajtimin, por kthimi i viktimave në vendbanimet e tyre të mëparshme, shpesh ka rezultuar joefektiv. Vlerësohet se 80% e njerëzve (kryesisht gratë) që vuajnë nga dhuna janë kthyer në familje në të njëjtën shtëpi pas kohës së kaluar në një strehimore.[77] Qasja e pamjaftueshme në drejtësi, si dhe drejtësia joefektive dhe joefikase për krimet e kryera kontribuojnë në përsëritjen e dhunës.[78]
- Pavarësisht përmirësimit të alokimeve buxhetore, mbështetja financiare për strehimoret e financuara nga shteti ka qenë jokonsistente dhe e pamjaftueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet e tyre, pjesërisht për shkak se është dorëzuar me vonesë për shkak të procedurave problematike të prokurimit. Cilësia e shërbimeve të ofruara nga strehimoret kërkon përmirësime të mëtutjeshme. Kosova vazhdon të ketë mungesë të sistemeve të mjaftueshme të rehabilitimit dhe riintegrimit.
- Ekziston komunikimi i pamjaftueshëm në mes të gjykatave dhe policisë. Gjykatat rrallë ndërhyjnë kur urdhrat e mbrojtjes shkelen dhe/ose kur ushqimi ose alimentacioni nuk paguhet.

---

[74] RrGK, *Siguria fillon në shtëpi*, f. 85.
[75] *Analiza Gjinore e Kosovës*, f. 18; *Siguria fillon në shtëpi*, f. 82.
[76] RrGK, *Më shumë se vetëm "Fjalë në Letër?"*, f. 29.
[77] Po aty, f. 19.
[78] Po aty, RrGK, f. 6.

Policia e Kosovës nuk bën monitorim të duhur të zbatueshmërisë së urdhrave të mbrojtjes. Koordinim të pamjaftueshëm ka në tërësi mes mekanizmave koordinues për trajtimin e dhunës me bazë gjinore edhe pse ka përmirësime në këtë aspekt në krahasim me vitet e kaluara. [79] Shpesh ka vonesa në trajtimin e rasteve të pazgjidhura. Qendrat për punë sociale vazhdojnë të mbesin problematike, në mungesë të infrastrukturës, burimeve njerëzore dhe profilizimit.

- Disa prokurorë nuk kanë njohuri lidhur me rregulloret e dhunës në familje. Përveç kësaj, mungesa e një sistemi funksional për mbrojtjen e dëshmitarëve mund të parandalojë viktimat apo dëshmitarët të raportojnë rastet e dhunës me bazë gjinore. Më tej, tarifat ligjore janë shpesh penguese dhe ndihma ligjore falas nuk është gjithnjë e arritshme.[80]
- Urdhrat mbrojtës shpesh përdoren në vend të fillimit të procedurave penale, edhe pse krimet e kryera në kuadër të një marrëdhënieje familjare duhet të ndiqen penalisht ex officio (sipas detyrës zyrtare).[81]
- Shërbimet e ofruara nga policia, gjykatësit dhe prokurorët mund të përmirësohen më tej, duke përfshirë më shumë trajnim nëpërmjet KGjK dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.[82]
- Përdhunimi nuk raportohet, veçanërisht në marrëdhëniet familjare, ku shumë njerëz nuk e konsiderojnë si krim, edhe pse kjo është një vepër penale.
- Ngacmimi seksual duket të jetë një çështje serioze në institucione publike, UP, biznese dhe shoqëri në përgjithësi. Pak njerëz e raportojnë atë, veçanërisht për shkak të situatës ekonomike dhe frikës nga humbja e vendit të punës.

---

[79] RrGK, "Nga Ligjet në Vepra, Monitorimi i reagimit institucional ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë", 2021.
[80] Farnsworth et al. për RrGK. *Me çfarë çmimi?*.
[81] RrGK, *Më Shumë se vetëm "Fjalë në Letër?"*, f. 6.
[82] RrGK, "Nga Ligjet në Vepra".

- Nuk ka pasur drejtësi për krimet me bazë gjinore të kryera gjatë luftës në Kosovë. Gratë që kanë vuajtur dhunën me bazë gjinore kanë nevojë për mbështetje në drejtim të rehabilitimit.

Strategjia e RrGK

Duke marrë parasysh këto sfida, qëllimi afatgjatë i këtij programi është: **Përmirësimi i reagimit ndaj dhunës me bazë gjinore, drejt uljes së saj.**[83] Objektivat, rezultatet e pritura dhe aktivitetet drejt arritjes së këtij qëllimi janë detajuar më poshtë.

Objektiva specifike 2.1. Përmirësimi i kualitetit dhe zbatimit të kornizës ligjore për dhunën në baza gjinore, duke përfshirë përgjegjësinë institucionale për të ndihmuar personat që kanë pësuar dhunë.

Përmirësimi dhe zbatimi i kornizës ligjore lidhur me dhunën në baza gjinore do të kontribuojë në përmirësimin e reagimit ndaj dhunës me bazë gjinore duke parandaluar dhunën, duke inkurajuar drejtësinë, duke parandaluar përsëritjen dhe duke ofruar trajtim më të mirë për personat që kanë përjetuar dhunë. Përmirësimi i kornizës ligjore dhe zbatimi i saj do të qartësojë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve, koordinimin e tyre dhe alokimet e nevojshme buxhetore për përmirësimin e menaxhimit të rasteve dhe trajtimin e rasteve. Një reagim i përmirësuar institucional mund të kontribuojë në reduktimin e dhunës duke fuqizuar dhe aftësuar gratë të jetojnë në mënyrë autonome dhe duke siguruar drejtësi dhe mbështetje financiare nga abuzuesit, si dhe duke parandaluar recidivizmin përmes

[83] Kjo Objektivë përputhet me disa objektive në PVGJ III të BE-së brenda fushës tematike "Liria nga të gjitha format e dhunës në bazë gjinore" Objektiva gjithashtu përputhet me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, konkretisht OZHQ 5, posaqërisht qëllimin 5.2: Të eliminohen të gjitha format e dhunës ndaj vajzave dhe grave në sferën publike dhe private, përfshirë trafikimin dhe eksploatimin seksual.

vlerësimeve të duhura të rrezikut, menaxhimit të rasteve dhe koordinimit institucional. Rezultatet e mëposhtme do të kontribuojnë në arritjen e kësaj objektive.

Rezultati i pritur 2.1.1. Institucionet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të DhBGJ janë më llogaridhënëse në lidhje me performancën e tyre. Përmes këshillave juridike dhe procedurave gjyqësore strategjike, RrGK do të angazhojë avokat që do të përfaqësojnë individët dhe familjet me qëllim të kërkimit të drejtësisë. Monitorimi i rasteve gjyqësore që janë në vazhdim e sipër dhe analiza e rasteve të përfunduara gjithashtu do të ketë për qëllim ngritjen e performancës së institucioneve vendore në adresimin e dhunës me bazë gjinore.

Rezultati i pritur 2.1.2. Zgjerohen njohuritë në lidhje me shkallën në të cilën është zbatuar korniza ligjore që ka të bëjë me dhunën në baza gjinore, si dhe vetëdijesimin dhe prevalencën e dhunës në familje.[84] E përkrahur nga ADA, RrGK do të përsërisë monitorimin e zbatimit të kornizës ligjore dhe të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (2022-2026). Gjetjet do të promovohen publikisht dhe do të diskutohen me institucionet drejt rritjes së ndërgjegjësimit të tyre lidhur me situatën dhe përmirësimet e rekomanduara, duke ndjekur përvojën e RrGK-së në kryerjen e raporteve të ngjashme monitoruese.

---

[84] Ky aktivitet do të kontribuoj direkt në implelemtimin e Objektivit 2 të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje 2016-2020, aktiviteti 2.3.7 'Shtimi i burimeve dhe i stafit, të Zyrës së Koordinatorit Nacional kundër DhF-së, të cilët në përshkrimin e tyre të punës duhet të kenë përgjegjësi specifike për mbështetjen e zbatimit dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje'. Poashtu, kjo do të kontribuoj në monitorim të Objektivit 3, aktiviteti 3.3.2 'Zbatimi efektiv i urdhërave mbrojtës, monitorimi dhe ndëshkimi adekuat si dhe sensibilizimi mbi shkeljet e tyre, përfshirë edhe ngritjen e kapaciteteve të Shërbimit Sprovues të Kosovës për të zvogëluar shkallën e recidivizmit'.

Rezultati i pritur 2.1.3. Më shumë njerëz të informuar në lidhje me kornizën ligjore dhe të drejtat e tyre. Kjo do të kontribuojë në mënyrë të qartë drejt rritjes së ndërgjegjësimit të publikut, gjë që mund të kontribuojë në rritjen e raportimit të dhunës dhe në këtë mënyrë në përmirësimin e aftësisë së institucioneve për të trajtuar rastet (të cilat është vështirë të trajtohen të vështira nëse nuk raportohen). Ajo do të përfshijë fushata vetëdijesuese në nivel kombëtar dhe komunal, si dhe të përfshijë organizatat anëtare përmes mbështetjes së FGK. Fokusi i veçantë do të vendoset në format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore, përfshirë ngacmimin seksual dhe përdhunimin. Do të bëhen përpjekje për të transformuar normat shoqërore, drejt parandalimit të dhunës.

Rezultati i pritur 2.1.4. RrGK, anëtaret e RrGK dhe OSHC-të të angazhuara për zbatimin e kornizës ligjore për trajtimin e dhunës me bazë gjinore. RrGK do të bashkëpunojë dhe do të mbështesë organizatat anëtare sidomos të strehimoreve, nëpërmjet FGK, në avokimin për zbatimin e kornizës ligjore. Kjo mund të përfshijë, për shembull, avokimin për: sigurimin e financimit të qëndrueshëm për ofruesit e shërbimeve me të mire; ngritjen e shërbimeve të rehabilitimit dhe riintegrimit të personave të cilët kanë vuajtur nga DhBGj nëpërmjet përmirësimit të përgjigjes ndër-institucionale; dhe avokimin për rekomandime të tjera që rezultojnë nga hulumtimi dhe monitorimi.

Rezultati i pritur 2.1.5. Përmirësimi i përformancës dhe cilësisë së shërbimeve të strehimoreve dhe ofruesit e shërbimeve të tjera që punojnë me viktima të dhunës me baza gjinore, veçanërisht në drejtim të rehabilitimit dhe riintegrim. RrGK do të bashkëpunojë më shumë me organizatat anëtare të saj, veçanërisht me strehimoret, dhe institucionet publike (përkatësisht Departamentin e Mirëqenies Sociale), në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimeve të ofruara për personat që kanë vuajtur dhunën në familje dhe forma të tjera të dhunës me

bazë gjinore. RrGK do të vazhdojë të ofrojë mbështetje për zyrtarët e shërbimeve sociale dhe mekanizmat koordinues drejt përmirësimit të menaxhimit të rasteve, koordinimit dhe reagimit të përgjithshëm ndaj rasteve. Kjo do të përfshijë avokimin për rritjen e fondeve shtetërore për të mbuluar të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me shërbimeve, strehimin, duke përfshirë rehabilitimin dhe riintegrimin, si dhe punën me strehimoret për të siguruar financim të qëndrueshëm. RrGK do të bashkëpunojë me ministritë përgjegjëse për prioritizimin e trajnimit profesional dhe punësimit për gratë që kanë përjetuar dhunë me bazë gjinore drejt riintegrimit të tyre.

Rezultati i pritur 2.1.6. Rekomandimet e dërguara për përmirësim të ligjeve dhe politikave. RrGK do të vazhdojë të shqyrtojë projektligjet dhe politikat tjera që paraqiten për konsultim publik, si dhe të marrë pjesë në grupet punuese të qeverisë, duke shfrytëzuar ekspertizën e saj për të dhënë të input nga aspekti gjinor në projektligjet dhe politikat. RrGK do t'i dërgojë letra avokuese qeverisë dhe parlamentit, si dhe do të publikojë letra në media, sipas nevojës, për të avokuar që rekomandimet e saj të adresohen në ligje dhe politika.

Grupet e interesit

Përfituesit kryesor të këtij programi do të jenë gra dhe vajza që kanë përjetuar dhunë, janë duke përjetuar, ose në rrezik të vuajnë dhunën me bazë gjinore. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e kornizës ligjore ekzistuese mbi dhunën me bazë gjinore do të targetohen, duke përfshirë: Koordinatorin Nacional kundër Dhunës në Familje (ose DhBGj), ABGj-në, mekanizmat e koordinimit, Policinë e Kosovës, Qendrat për Punë Sociale, sistemin e drejtësisë, strehimoret, Zyrat për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave, Zyrat e Ndihmës Ligjore, KGjK dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës. Përveç kësaj, qytetarët në përgjithësi do të targetohen për rritjen e vetëdijesimit lidhur me kornizën ligjore ekzistuese, mënyrat për

të kërkuar ndihmë, si dhe drejt transformimit të normave shoqërore.

RrGK do të vazhdojë bashkëpunimin e ngushtë me organizatat e saj anëtare, veçanërisht me strehimoret, dhe me rrjetin rajonal për të trajtuar dhunën me bazë gjinore ndaj grave. RrGK gjithashtu do të koordinohet me akterët e tjerë, përfshirë: Grupin Koordinues për Siguri dhe Çështje Gjinore, UNKT, UN Women, UNDP, UNFPA, UNICEF, OSBE, BE, Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX), Programin Universitar për Studime dhe Hulumtime Gjinore në UP, Care International, Save the Children, Qendrën Evropiane për Çështje të Minoriteteve, dhe Qendrën për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal. Në lidhje me të drejtat e LGBTI, RrGK do të vazhdojë bashkëpunimin e ngushtë me organizata të tjera të fokusuar në mbështetjen e personave LGBTI.

RrGK parashikon se do të marrë mbështetje për këtë program nga ADA dhe UN Women.

Fuqizimi Ekonomik i Grave

Ligjet, Politikat dhe Mekanizmat Institucional

- Direktiva e BE-së mbi Trajtimin e Barabartë bën thirrje për mundësi dhe trajtim të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit.[85]
- Direktiva e BE-së për Punëtoret Shtatzëna cakton udhëzimet për punëtoret gjatë dhe pas shtatzënisë.[86] Ajo mbulon tema të tilla si: ekspozimi ndaj aktiviteteve potencialisht të rrezikshme, kohëzgjatja e pushimit të lehonisë dhe koha e lirë për vizitat te mjeku. Kjo nuk është e përfshirë plotësisht në kornizën ligjore të Kosovës.
- Direktiva e BE-së mbi Krijimin e një Kornize të përgjithshme për Trajtimin e barabartë në Punësim dhe Profesion përcakton një kornizë të përgjithshme për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion. Përderisa Udhëzimi nuk është miratuar në Kosovë, ai ka shërbyer si një burim për Ligjin kundër Diskriminimit.[87]
- Direktiva e BE-së mbi Pushimin Prindëror përcakton të drejtën për një minimum prej katër muajve të pushimit për nënat dhe baballarët e rinj.[88] Ky Udhëzim ende nuk është përfshirë në kornizën ligjore të Kosovës.
- PVGJ III ka një fushë tematike që specifikisht fokusohet në fuqizimin ekonomik të grave. Fusha: "Avancimi i të drejtave ekonomike, sociale, dhe fuqizimi i grave dhe vajzave". Kjo fushë ka tetë Objektiva specifike që fokusohen në fuqizimin ekonomik të grave.

---

[85] BE, Direktiva mbi Trajtimin e Barabartë, 2006/54/EC, 2006.
[86] BE, Direktiva për Punëtoret Shtatzëna, 92/85/EC, tetor 1992.
[87] BE, Direktiva mbi krijimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion, 2000/78/EC, dhjetor 2000.
[88] BE, Direktiva mbi mbi Pushimin Prindor, 2010/18/BE-së 2010.

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës bën thirrje për qeverinë që të sigurojë barazi gjinore, përfshirë edhe në qasjen në punësim.
- Ligji i Punës ka për qëllim të rregullojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga punësimi.[89] Kjo vlen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit në sektorin publik dhe privat, dhe merret me çështje të tilla si pushimi i lehonisë. Një grua e punësuar ka të drejtën e 12 muajve të pushimit të lehonisë, me gjashtë muaj të kompensimit në 70% të pagës bazë të paguar nga punëdhënësi, tre muaj e paguar nga qeveria në 50% të pagës mesatare në Kosovë, dhe tre muaj pa pagesë. Ai gjithashtu jep leje pushimi për baballarët pasi të lind fëmija, por vetëm për dy javë pa pagesë dhe dy ditë me pagesë.
- Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndalon diskriminimin në shumë forma, duke përfshirë edhe në bazë të gjinisë, moshës, statusit martesorë apo orientimit seksual, dhe zbatohet në vendin e punës.[90]
- Ligji për Trashëgiminë i Kosovës përcakton se burrat dhe gratë kanë të njëjtat të drejta të trashëgimisë, edhe pse kjo nuk zbatohet domosdoshmërisht.[91]
- Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Pronësore merret me pronësinë e sendeve fizike, duke përfshirë edhe braktisjen dhe regjistrimin e pronës.[92] Ligji i trajton të gjitha palët si neutrale sa I përket gjinisë dhe nuk ofron asnjë dispozitë të drejtpërdrejtë në lidhje me të drejtat e grave në pronësi.

---

[89] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212.
[90] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, Ligji Nr. 05/L-021.
[91] Kuvendi i Kosovës dhe UNMIK-ut, Ligjin për Trashëgiminë i Kosovës, Ligji Nr. 2004/26.
[92] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Ligji Nr. 03/L-154.

- Ligji për Barazi Gjinore në mënyrë eksplicite cekë që duhet të ketë mbrojtje dhe trajtim të barabartë në bazë të përkatësisë gjinore në marrëdhëniet e punës (këtu përfshihet ndalimi i diskriminimit gjinor në marrëdhëniet e punës dhe në skemat e sigurimit shoqëror në punë, vlerësimi i punës së papaguar dhe në qasje dhe furnizim me mallra dhe shërbime).[93]
- Vizioni i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe MPMS-së për vitin 2020 është të krijojë një shoqëri, "ku të gjithë njerëzit në moshë pune dhe të aftë për punë janë të trajnuar dhe të kenë mundësi të barabarta në punësim." Objektivat strategjike të MPMS përfshijnë rritjen e punësimit dhe të aftësive, rritjen e mirëqenies sociale me fokus në grupet e rrezikuara dhe zvogëlimin e punësimit jo-formal.
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 cek që është e nevojshme të "rritet përfshirja e fëmijëve në institucione parashkollore në mënyrë që të rritet pjesëmarrja e grave në tregun e punës."[94]
- Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat në Kosovë 2018-2022 në një paragraf të titulluar "Gratë në ndërmarrësi" përshkruan nevojën për të mbyllur "boshllëkun gjinor në sektorin privat në mënyrë që të rritet numri total i sipërmarrësve, duke rezultuar në më shumë punësim dhe produktivitet dhe duke pasur një ndikim pozitiv në rritjen ekonomike".[95]

Situata

Në Kosovë, vetëm 22% e grave janë të regjistruara si pjesëmarrëse aktive në tregun e punës, ndërkohë që kjo shifër

---

[93] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligjit për Barazi Gjinore, Ligji Nr. 05/L-020, Kapitulli III.
[94] Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, *Strategija Kombëtare për Zhvillim 2016-2021*.
[95] Republika e Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, *Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2018-2022*.

për burrat është 56%.[96] Sa i përket normave të punësimit, vetëm 17% e grave në moshë pune janë të punësuara, përderisa 47% e burrave janë të punësuar.[97] Në vitin 2017, sektorët e arsimit, shëndetësisë dhe tregtisë punësuan më së shumti gra (47% të të gjitha grave të punësuara).[98] Për burrat, sektorët kryesorë të punësimit janë prodhimi dhe tregtia (47% e të gjithë burrave të punësuar).[99] Këto përqindje nuk kanë ndryshuar shumë me kalimin e viteve, gjë që tregon se tregu i punës në Kosovë është i ndarë nga perspektiva gjinore.

Hendeku më i thellë gjinor mund të gjendet në normat e joaktivitetit, ku 80% e grave që janë në moshë pune janë joaktive, ndërkohë që 34% e burrave janë pjesë e kësaj kategorie.[100] Mosha ka rëndësi sidomos për gratë, meqenëse papunësia e përgjithshme te gratë është 37%. Megjithatë, papunësia te të rejat është 64%, dhe 48% në mesin e të rinjve (të moshës 15 deri 24-vjeçare).[101] Diferenca midis totaleve dhe të rinjve është 18.5%. Shkaku i joaktivitetit që mbizotëron më së shumti te burrat është se ata ose shkojnë në shkollë, ndjekin arsimin apo trajnohen (37%).[102] Ndërkohë, për gratë, ky është shkaku i dytë që jepet më së shumti. Shkaku kryesor pse gratë janë joaktive është se ato kanë përgjegjësi për t'u kujdesur në shtëpi, për fëmijët (32%).[103] Shumë pak burra e përmendën këtë si arsyen që i ndalon ata të marrin pjesë në tregun e punës: vetëm 1.1%.[104] RrGK-ja ka sugjeruar prej shumë kohësh se vënia në dispozicion e kujdesit për fëmijë të përballueshëm ekonomikisht, do t'u

---

[96] Agjencioni i Statistikave te Kosoves, *Anketa e Fuqise Punetore TM4*, 2021.
[97] Po aty.
[98] RrGK, *Analiza Gjinore e Kosovës*, Prishtinë: 2018, f. 37.
[99] Po aty.
[100] Po aty.
[101] Po aty, f. 2.
[102] Po aty.
[103] Po aty.
[104] Po aty.

mundësonte më shumë grave të hynin në tregun e punës, si përmes krijimit të vendeve të reja të punës ashtu edhe përmes lehtësimit të qasjes në kujdesin për fëmijë. Këto përqindje ilustrojnë mënyrën se si burrat dhe gratë e kalojnë në përgjithësi ditën e tyre. Përmes një ankete për shfrytëzimin e kohës, u konstatua se burrat, mesatarisht, shpenzojnë 400% më shumë kohë (3.9 orë në ditë) në marrëdhënie pune sesa gratë (0.9 orë në ditë).[105] Ndërsa, gratë shpenzojnë 300% më shumë kohë sesa burrat për punët e shtëpisë dhe për t'u kujdesur për familjen (përkatësisht 7.1 orë dhe 2.3 orë).[106]

Qytetarët e Kosovës, të cilët morën pjesë në anketë, renditën trajtimin e barabartë për gratë dhe burrat në vendin e punës (32.2%), pagën e barabartë për mundësi të barabarta (25.4%), disponueshmërinë e vendeve të punës me gjysmë orar ose punëve fleksibile (16.6%) dhe qasjen te qendrat e kujdesit për fëmijët (14.2%) si nisma kyçe që gratë të bëhen më aktive në tregun e punës.[107]

Hulumtimet e kryera nga Instituti "Riinvest" tregojnë se 'në sektorin publik, një përqindje më e lartë e grave, rreth 72%, kanë kontratë pune pa afat, ndërsa rreth 28% kanë kontratë me afat, me kohëzgjatje mesatare prej 14 muajsh'.[108] Gjithashtu, 'në sektorin publik, kontratat në përgjithësi zgjaten pasi skadojnë, meqenëse ekzistenca e kontratave me afat shpeshherë është thjesht formalitet'. Ndërkohë, atë gjetën se 'më pak se gjysma e grave që punojnë në sektorin privat (48%) kanë kontratë afatgjate dhe rreth 52% e tyre kanë kontrata me afat, të cilat zgjasin mesatarisht 10 muaj."[109]

---

[105] Millennium Challenge Corporation, Studimi mbi Fuqinë Punëtore të Kosovës dhe Përdorimin e Kohës, Prishtinë: 2017, f. 12.
[106] Po aty.
[107] RrGK, *Analiza Gjinore e Kosovës*, f. 38.
[108] Instituti Riinvest, *Gratë në Tregun e Punës: Analizë e Kushteve të Punës për Gratë në Kosovë*, Prishtinë: 2017, f. 39.
[109] Po aty.

Në sektorin privat, rreth 30% e grave punojnë pa kontratë dhe rreth 50% kanë kontratë me afat të caktuar.[110] Në sektorin publik, vetëm 25% e grave kanë kontratë me afat të caktuar.[111] Besohet (edhe pse ekzistojnë shumë pak numra konkretë) se sektori jo-formal përfshin afërsisht 10% të ekonomisë së Kosovës, dhe shumica e atyre që janë përfshirë, janë gra.[112] Kjo dukuri ka shumë pasoja negative në fuqizimin ekonomik të grave, përfshirë pagat e ulëta, kushtet e vështira të punës, mungesën e mbrojtjes sociale dhe mungesën e fondeve të akumuluara të pensioneve.

Sipas normave kulturore, burrat kanë tendenca të menaxhojnë asetet dhe pasurinë familjare. Pavarësisht faktit se ligjet u garantojnë grave të drejtën e trashëgimisë së pronës, shumë familje vazhdojnë të ndjekin traditat sipas të cilave prona u jepet vetëm burrave. Përvoja sugjeron se gratë heqin dorë vetë nga të drejtat e tyre për të trashëguar pasuri familjare, në bazë të normave kulturore ekzistuese dhe për të ruajtur marrëdhënie 'të mira' me pjesëtarët e familjes. Pa këto asete, gratë nuk kanë kurrfarë garancie për të marrë kredi dhe në këtë mënyrë, nuk kanë qasje në kapital për zhvillimin e bizneseve të tyre. Gratë kryefamiljare përballen me kushte veçanërisht të vështira, meqenëse shpeshherë nuk kanë qasje në asete për zhvillimin e bizneseve të tyre ose tregjeve për të shitur produktet e tyre (detyrë kjo që më përpara kryhej nga bashkëshortët e tyre). Gratë kryefamiljare janë në radhët e personave më të varfër në Kosovë.

Shumë gra shesin produkte të tilla si perime dhe ushqime të përpunuara. Ato gjithashtu shpesh ofrojnë shërbime në familje, përkujdesje dhe rregullim të flokëve. Në zonat rurale, gratë kontribuojnë në shërbime të papaguara, siç janë përkujdesja për

---

[110] Po aty, f. 9.
[111] Po aty.
[112] Riinvest 2013, f. 7.

kafshët në ferma, puna e papaguar në dyqane në pronësi të familjes dhe puna në bujqësi.[113] Megjithatë, meshkujt tradicionalisht tregtojnë produktet dhe menaxhojnë financat e familjes. Prandaj, shumë pak gra korrin shpërblimet e punës së tyre të vështirë, dhe ato kanë shumë pak të drejtë në vendimet financiare të përfituara në kuadër të familjes.[114]

Qasja e pamjaftueshme në tregun e punës, pronë dhe financa të familjes i më gratë në një pozitë të pasigurt. Grave u mungojnë fuqitë e vendimmarrjes brenda familjeve të tyre. Gratë të cilat përjetojnë dhunë në familje nuk kanë mundësi ti largohen situatave të dhunshme dhe i frikësohen humbjes së kujdestarisë së fëmijëve të tyre.[115] Pa arsimim e pa aftësi të punës, gratë që kanë qenë viktima të dhunës në familje luftojnë për të siguruar punësim dhe të ri-integrohen në shoqëri. Mbështetja e grave në qasjen në arsim, punësim dhe kapital është kyçe për fuqizimin ekonomik të grave.

---

[113] Hulumtimi i ardhshëm i RrGK mbi bujqësinë dhe jetesën rurale, i kryer për FAO, përshkruan sfidat shtesë me të cilat përballen gratë rurale. Ky hulumtim do të publikohet gjatë vitit 2023.

[114] *Profili Gjinor i Vendit,* f. 17.

[115] RrGK, *Siguria fillon në shtëpi dhe Më Shumë se "Fjalë në Letër"?.*

Me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës, Shoqata Iniciativa e Grave ka përkrahur gratë e reja me trajnim profesional dhe ka avokuar tek Kryetari I Dragashit për punësimin e tyre. Si rezultat, tani 24 gra janë të punësuar në fabrikën e re.

Arritjet kryesore të RrGK

- Si rezultat i drejtpërdrejtë i mbështetjes nga FGK, më shumë se 41 gra, kryesisht nga zonat rurale, kanë siguruar punësim.
- RrGK ka përkrahur rreth 30 grupe të grave për të ndihmuar anëtaret e tyre të identifikojnë tregje të reja për prodhimet e tyre, të rrisin produktivitetin dhe të rrisin fitimet e tyre. Si rezultat, 223 gra janë trajnuar të zhvillojnë dhe menaxhojnë biznese të suksesshme dhe 125 gra kanë qasje më të mirë në tregje.
- Pas publikimit të raportit 'Arritja e ekuilibrit', RrGK-ja i është bashkuar Forumit Ekonomik të Grave, ku është duke bashkëpunuar me akterë të tjerë për të avokuar për ndryshimin e politikave për të adresuar çështjen e diskriminimit gjinor në vendin e punës dhe për të ndryshuar dispozitat aktuale të pushimit të lehonisë, atësisë dhe të pushimit prindëror.
- RrGK-ja realizoi dhe publikoi një hulumtim për kërkesën, ofertën dhe opsionet për rritjen e disponueshmërisë së kujdesit për fëmijë në Kosovë, të titulluar 'Kush kujdeset?'. Ky hulumtim shqyrton kërkesën e mbuluar dhe të pambuluar për shërbime të kujdesit për fëmijë në Kosovë. Kjo është duke avokimin për më shumë shërbimeve të kujdesit për fëmijë.
- RrGK ka rritur vetëdijen për rëndësinë që ka regjistrimi i pronës nga ana e grave. Si rezultat i kësaj iniciative, 6,088 qytetarë në pesë komuna (3,150 gra dhe 2,938 burra) janë më të vetëdijshëm për rëndësinë e regjistrimit të pronës nga ana e grave, përderisa 153 gra kanë filluar procesin e regjistrimit të pronës.
- RrGK gjithashtu ka avokuar me sukses që Qeveria të shtynte afatin e Udhëzimit Administrativ për Regjistrimin e Përbashkët të Pronës.
- Me mbështetjen e FAO, RrGK ka kryer analizën e parë gjithëpërfshirëse gjinore në Kosovë për bujqësinë dhe jetesën rurale, e cila gjithashtu shqyrton dixhitalizimin. RrGK ka kryer gjithashtu analiza inovative gjinore mbi dixhitalizimin, e cila mund të informojë strategjitë e qeverisë në lidhje me arsimin dhe zhvillimin ekonomik nga perspektiva gjinore.

Sfidat kryesore

Sfidat kryesore për fuqizimin ekonomik të grave në Kosovë rrjedhin kryesisht nga normat kulturore.

- Zbatimi i dobët i ligjeve ekzistuese të trashëgimisë dhe pronësisë dhe ndërgjegjësimi i ulët në mesin e gjykatësve se si të trajtojnë rastet që kanë të bëjnë me të drejtat e grave në pronë dhe trashëgimi, pengojnë gratë të realizojnë të drejtat e tyre pronësore.[116]
- Gratë kanë vështirësi në marrjen e kredive, për shkak se ato nuk kanë kolateral, histori të kredive dhe lidhje. Vetëm 3% e kredive bankare komerciale shkojnë për gratë. Kjo e bën sfiduese blerjen e pronës dhe fillimin e bizneseve.[117]
- Normat sociale inkurajojnë gratë të qëndrojnë në shtëpi si kujdestare dhe burrat të punojnë jashtë shtëpisë si mbajtës të familjes. Kjo mund të ndikojë tek fakti nëse gratë zgjedhin të kërkojnë punë, nëse bashkëshortët dhe anëtarët e familjeve do të kishin lejuar/inkurajuar ato për të punuar dhe nëse punëdhënësit (zakonisht burra) do të zgjedhin ti punësojnë ato. Puna e grave kompensohet pak, edhe pse shoqëria mbështetet në këtë punë të lirë që të funksionojë. Mungesa e kopshteve dhe qendrave për kujdes ditor të përballueshme ekonomikisht dhe me cilësi, gjithashtu minon aftësinë e gruas për të hyrë në fuqinë punëtore.
- Disa punëdhënës duket se diskriminojnë gratë në punësim dhe nuk paguajnë për pushimin e lehonisë. [118] Burrat janë të diskriminuar nga dispozitat ligjore që lidhen me lejen e atësisë, të cilat u lejojnë baballarëve pak kohë për të kaluar me fëmijët e tyre të sapolindur.

---

[116] QKSGJ, *Të Drejtat e Grave në Pronë në Kosovë*, 2011.
[117] UNDP, *Raporti i zhvillimit njerëzor në Kosovë, 2012*.
[118] RrGK, *Arritja e ekulibrit*, Prishtinë: 2016, f. 7 & 30.

- Ligji aktual i punës kontribuon në diskriminimin ndaj grave dhe burrave, si dhe përforcon normat tradicionale gjinore që pengojnë qasjen e grave në punësim.
- Ekonomia joformale është e përhapur dhe e kuptuar pak, duke mundësuar shkelje të të drejtave të punës së grave dhe burrave dhe duke kontribuar në varfërinë gjatë pleqërisë.

Strategjia e RrGK

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është: **Gratë dhe burrat kanë mundësi më të barabarta ekonomike në shtëpi dhe në sferën publike.**

Objektivi 3.1. Përmirësimi i kushteve për pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore.

Në mënyrë që gratë dhe burrat të kenë më shumë mundësi të barabarta në ekonomi dhe në shtëpi, duhet përmirësuar kuadri ligjor dhe pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore duhet të rritet. Strategjia e RrGK-së ka një bashkëveprim me Agjendën Kombëtare për Fuqizimin Ekonomik të Grave, të përpiluar nga Forumi Ekonomik i Grave, e cila udhëzon përpjekjet e avokimit drejt fuqizimit ekonomik të grave në Kosovë.

Rezultati i pritur 3.1.1. Ngritja e vetëdijes se institucioneve dhe akterëve të tjerë ne lidhje me harmonizimin e legjislacionit të punës dhe kornizën e BE-së, dhe për përmirësime të tjera të nevojshme në kuadrin ligjor. RrGK do të vazhdojë të bashkëpunojë me Forumin Ekonomik të Grave për të avokuar për ndryshime ligjore dhe politika të bazuara në fakte në përputhje me Acquis të BE-së për Barazinë Gjinore.

Rezultati i pritur 3.1.2. Institucionet dhe akterët kryesor janë më të vetëdijshëm për diskriminimin me bazë gjinore dhe politikat e përgjegjshme gjinore për ta adresuar atë. Kjo do të ndihmojë në adresimin e pengesave lidhur me punësimin e grave. RrGK do të avokojë për ndryshime të ligjeve dhe politikave dhe zbatimin e

tyre, bazuar në hulumtimin e zhvilluar në vitin 2018 dhe 2022 në kuadër të projektit rajonal të RrGK-së, i cili synon të luftojë diskriminimin gjinor në punë dhe të fuqizojë organizatat e grave që të kenë aftësitë të mbajnë përgjegjëse institucionet relevante për zbatimin e legjislacionit kundër diskriminimit dhe të drejtat e grave në punë. Avokimi gjithashtu do të kontribuojë në përmirësimin e qasjes së grave në drejtësi në fushën e diskriminimit gjinor në vendin e punës. Përveç kësaj, duke përdorur hulumtimin që RrGK kreu në vitet 2016 dhe 2018 mbi diskriminimin gjinor në punë, RrGK do të vazhdojë të avokojë për zbatimin e rekomandimeve të dala prej tij, duke përfshirë rekomandimin për dhënien e lejes së përbashkët prindërore për t'i siguruar grave dhe burrave mundësi të barabarta për kujdesin familjar dhe punësimin. Kjo do të kontribuojë në përafrimin e legjislacionit të Kosovës me Direktivën e BE-së për Pushimin Prindër dhe Direktivën për Punëtoret Shtatzëna.

Rezultati i pritur 3.1.3. Qasja në drejtësi në rastet e diskriminimit gjinor në lidhje me punë dhe shkeljen e të drejtave të grave në vendin e punës, është përmirësuar. RrGK do të bashkëpunojë me partnerët e saj në Kosovë dhe në rajon për të mbështetur gratë në kërkimin e drejtësisë për diskriminimin gjinor në punë, përmes këshillave ligjore dhe proceseve gjyqësore strategjike.

Rezultati i pritur 3.1.4. Ngritja e njohurive rreth ekonomisë joformale dhe si ta trajtojmë atë duke përdorur një qasje të përgjegjshme gjinore. RrGK do të kryejë një analizë gjinore të ekonomisë joformale dhe do të publikojë rekomandime për të informuar strategjinë e qeverisë për trajtimin e joformalitetit me një qasje të përgjegjshme gjinore dhe qasje "mos bëj dëm". RrGK gjithashtu do të avokojë për implementimin e këtyre rekomandimeve RrGK do të avokojë tek institucionet e Kosovës që t'i mbledhin më mirë dhe t'i bëjnë të qasshme për publikun të dhënat lidhur me ekonominë joformale. Informata të tilla mund të mbështesin RrGK-në, anëtaret e saj dhe akterë të tjerë të

avokojnë për politika më të mira dhe masa afirmative në adresimin e pabarazive lidhur me pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore, duke kontribuar kështu në rritjen e pjesëmarrjes së tyre.

Rezultati i pritur 3.1.5. Më shumë zyrtarë janë të vetëdijshëm për nevojën për më shumë qendra parashkollore dhe qendra të kujdesit për fëmijë, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, sidomos në zonat rurale. Kujdesi ndaj fëmijëve, të moshuarve, dhe personave me aftësi të kufizuara është thelbësor për t'iu mundësuar më shumë grave që të punojnë. Prandaj, RrGK do të bashkëpunoj me organizatat e saj anëtare dhe veçanërisht me Forumin Ekonomik të Grave që të vazhdojë të avokojë për hapjen e më shumë qendrave për përkujdesje ditore, çerdheve dhe mundësive tjera alternative për përkujdesje për fëmijët, të moshuarit, dhe personat me aftësi të kufizuara.

Rezultati i pritur 3.1.6. Rritet qasja e grave në trashëgimi dhe pronësi nëpërmjet reformave ligjore, ndërgjegjësimit dhe ndihmës ligjore. Mundësitë e barabarta për trashëgimi dhe pronësi janë vendimtare për fuqizimin ekonomik të grave. Rritja e pronësisë së grave do të krijojë një ambient më miqësor për gratë që të fillojnë dhe të rrisin bizneset e tyre, duke kontribuar në zbatimin e Strategjisë së Sektorit Privat. RrGK do të koordinohet me akterët tjerë që punojnë në këtë çështje drejt efikasitetit dhe efektivitetit në realizimin e qëllimeve të përbashkëta. Ndër të tjera RrGK këtu planifikon të avokojë për të hequr nga ligji mundësinë që gratë të refuzojnë të drejtën e tyre për trashëgimi. RrGK dhe anëtaret e saj të mbështetura përmes Fondit të Grave të Kosovës do të marrin pjesë në fushatat e ndërmarra në bashkëpunim të ngushtë me akterë të tjerë, në drejtim të: 1) rritjes së ndërgjegjësimit në familje, në mesin e grave, burrave, djemve dhe vajzave, në lidhje me rëndësinë e faktit që gratë dhe burrat të kenë të drejta të barabarta në pronë dhe trashëgimi; dhe 2) për regjistrimin e

pronës në emër të grave. Kjo do të përfshijë fushata të bashkërenduara në media, takime publike, si dhe vizita derë-më-derë të realizuara nga anëtaret e RrGK që kanë qasje brenda komuniteteve të tyre.

Rezultati i pritur 3.1.7. Përmirësohet zbatimi i rekomandimeve në drejtim të përmirësimit të jetesës së grave rurale dhe grave me aftësi të kufizuara. RrGK do të avokojë për zbatimin e rekomandimeve që dalin nga hulumtimet dhe analizat gjinore mbi bujqësinë, jetesën rurale, ekonominë joformale dhe digjitalizimin, veçanërisht duke përfshirë vëmendjen ndaj nevojave të grave rurale dhe grave me aftësi të kufizuara. Kjo përfshin avokimin për përmirësimin e financimit të asistentëve personalë për personat me aftësi të kufizuara, duke siguruar që të drejtat e tyre të punës mbrohen.

Rezultati i pritur 3.1.8. Më shumë zyrtarë të institucioneve ndërkombëtare të financimit janë të informuar rreth politikave të përgjegjshme gjinore. RrGK do të bashkëpunojë me partnerët në Kosovë, rajon dhe ndërkombëtarisht për të avokuar që institucionet financiare ndërkombëtare (BE, Bankën Botërore, (IMF) të bazojnë vendimet e tyre në analizë gjinore dhe të bëjnë konsultime adekuate me organizatat për të drejtat e grave. Kjo mund të përfshijë dërgimin e letrave avokuese për të informuar strategjitë e financimit, pjesëmarrjen në konferenca dhe takime dhe shkrimin e letrave avokuese, ndër aktivitete të tjera.

Grupet e Interesit

Gratë do të jenë përfitueset kryesore të këtij programi, veçanërisht gratë e margjinalizuara deri më tani. Familjet e tyre do të jenë përfitues dytësor dhe do të jenë në pozitë më të mirë ekonomike. Institucionet e shënjestruara për zhvillimin e kapaciteteve dhe rekomandimeve, gjithashtu mund të jenë përfitues pasi që do të përmirësohen aftësitë e tyre për të çuar

më tej qasjen e barabartë të grave në programet e financuara nga shteti.

RrGK do të vazhdojë bashkëpunimin me organizatat anëtare të saj, veçanërisht me ato që janë të fokusuara në fuqizimin ekonomik, ngritjen e vetëdijes, monitorimit dhe ndihmës ligjore.

RrGK do të bashkëpunojë dhe do të mbështesë G7, Odën e Ekonomike të Grave, dhe Gratë për Gratë. RrGK do të koordinojë ngushtë veprimet me akterët e tjerë të përfshirë në fuqizimin ekonomik të grave, përfshirë ABGj-në, ministritë përgjegjëse për punën dhe shërbimet sociale, tregtinë dhe industrinë, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Agjencinë Kadastrale të Kosovës, Odën e Noterëve të Republikës së Kosovës, USAID/TetraTech Programi për të Drejtat Pronësore, BE-në, GIZ-in, UNDP, UN Women, ILO, OSBE-në, Bankën Botërore dhe programe të tjera.

RrGK parashikon se do të marrë mbështetje për këtë program nga Agjencia Austriake për Zhvillim dhe Komisioni Evropian.

Edukimi që transformon normat gjinore

Ligjet, Politikat dhe Mekanizmat Institucional

Ekzistojnë ligje dhe mekanizma institucional të shumtë drejt ngritjes së qasjes së vajzave dhe grave në edukim:

- Rekomandimi nr. 3 i Përgjithshëm i KEDKG i nxit shtetet që të miratojnë programe për edukimin dhe informimin publik, të cilat do të ndihmojnë në eliminimin e paragjykimeve dhe të praktikave që e pengojnë barazinë sociale të grave.[119]
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës[120] e njeh të drejtën e të gjithë fëmijëve për arsimim. Kjo Konventë bëhet drejtpërdrejtë e zbatueshme në Kosovë përmes Kushtetutës.[121]
- Direktiva e rimodeluar përmban dispozita për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë në aftësimin profesional dhe në sigurimin e barazisë në çështjet e profesionit dhe punësimit. Direktiva kryesisht është transpozuar në legjislacionin e Kosovës, por zbatimi mbetet i dobët.[122]
- Objektivi i katërt i Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) i OKB-së synon sigurimin e arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë, si dhe promovimin e mundësive të të nxënit gjatë gjithë jetës për të gjithë.[123]
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës e garanton të drejtën e shkollimit themelor falas dhe obligon institucionet publike të

---

[119] OKB, KEDKG, 1981.
[120] OKB, Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, 1990, neni 28.
[121] Kushtetuta, neni 22.
[122] Cleff le Divellec dhe Miller për RrGK-në, 2017.
[123] OKB, Synimet e Zhvillim të Qëndrueshëm.

sigurojnë mundësi të barabarta për arsimim për të gjithë, sipas aftësive dhe nevojave të tyre.[124]

- Ligji mbi Edukimin Parashkollor e parasheh pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse të djemve dhe vajzave në edukimin parashkollor.[125]
- Ligji për Arsimin në komunat e Kosovës obligon MASHT-in që të promovojë një sistem arsimor jo-diskriminues, ku respektohen të drejtat e secilit person për arsim dhe ku për të gjithë vihen në dispozicion mundësitë e shkollimit.[126]
- Ligji për Arsimin Parauniversitar siguron pjesëmarrjen e vajzave dhe djemve në sistemin arsimor. Ky ligj, garanton qasje në arsimin parauniversitar pa asnjë lloj diskriminimi, duke përfshirë gjininë dhe statusin martesor, ndër të tjera.[127] Ligji poashtu kërkon që arsimi parauniversitar të përfshijë edhe përgatitjen e nxënësit për jetë të përgjegjshme të bazuar në frymën e barazisë gjinore.[128] Tutje, ai thekson që promovimi i barazisë gjinore duhet të merret parasysh në të gjitha fazat: planifikimin, menaxhimin dhe ofrimin e arsimit parauniversitar.[129]
- Ligji për Arsimin e Lartë përshkruan parimet e barazisë, mundësive të barabarta pa diskriminim dhe diversitetitin si parime themelore të arsimit të lartë.[130] Ai poashtu siguron

---

[124] Neni 47.
[125] Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji nr. 02/L-52 mbi edukimin parashkollor, 2006, neni 1. Regjistrimi është në baza vullnetare.
[126] Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji nr. 03/L-068 për arsimin në komunat e Kosovës, 2008, neni 3(b).
[127] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, 2011, neni 3.6.
[128] Po aty, neni 1.2.5.
[129] Po aty, neni 3.4.
[130] Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji nr. 04/L-37 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, 2011, neni 2.

pjesëmarrjen e burrave dhe grave, duke iu garantuar atyre të drejtën për qasje në arsim pa diskriminim.[131]

- Ligji për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur[132] siguron që burrat dhe gratë mund të marrin pjesë në arsimin dhe aftësimin për të rritur.
- Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional[133] bazohet në parimin e gjithëpërfshirjes, duke siguruar që gratë dhe burrat mund të marrin pjesë në arsim dhe aftësim profesional.
- Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë[134] i detyron institucionet që të sigurohen që të rinjtë të marrin pjesë dhe të kanë ndikim në proceset e rëndësishme vendimmarrëse, të cilat i prekin interesat e tyre. Ligji poashtu i detajon fushat në të cilat është e detyrueshme pjesëmarrja e të rinjve, përfshirë: arsimin, punësimin, çështjet sociale dhe shëndetin publik.
- Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021 përfshinë pikëpamjen gjinore në lidhje me arsimin, duke përfshirë edhe tregues e aktivitete specifike sipas gjinisë, si stimulimi i vijimit të edukimit parashkollor dhe organizimi i aktiviteteve për vetëdijesimin e komuniteteve rom dhe ashkali për rëndësinë e regjistrimit me kohë dhe vijimin e shkollimit, me fokus të veçantë te vajzat.[135]
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021 i jep prioritet përfshirjes së fëmijëve të moshave 0-6 vjeç në

---

[131] Po aty, neni 5.
[132] Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji nr. 04/L-143 për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës, 2013.
[133] Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji nr. 04/L-138 për arsimin dhe aftësimin profesional, 2013, neni 3.1.
[134] Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji nr. 03/L-145 për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë, 2009.
[135] Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, "Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2020", 2017.

programet parashkollore. [136] Aty ndër të tjera theksohet se kjo do ndikojë pozitivisht në rritjen e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore.

- PKZMSA e synon përmirësimin e standardit të arsimit, duke e përfshirë fushën e arsimit dhe atë të aftësimit profesional, si dhe punën në zhvillimin e politikave për të rinjtë e të rejat, pa diskriminim në bazë të gjinisë, racës, fesë, besimit, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar, moshës ose orientimit seksual. [137]
- Agjenda për Reforma Evropiane (ARE) ndër të tjera thekson se ajo duhet të zbatohet në përputhje me LBGj-në, duke përfshirë edhe zbatimin në lidhje me reformat e politikave arsimore, duke e rritur pjesëmarrjen në nivelin e arsimit parashkollor dhe duke e përmirësuar cilësinë e AAP-së dhe kalimit nga shkolla në punë.[138]

Situata

RrGK i gjen rrënjët e saj fillestare në Rrjetin e Grave Rurale, i cili u përqendrua kryesisht në zgjerimin e qasjes në arsim për vajzat gjatë viteve 1990.[139] Aktivizmi bazë i disa prej organizatave më të vjetra anëtare të RrGK ka kontribuar në ndryshime thelbësore në qasjen e vajzave në arsim. Pjesërisht për shkak të përpjekjeve të tyre, përqindja e grave të reja që ndjekin arsimin ka shënuar një rritje të konsiderueshme në dy dekadat e fundit. Shumë anëtare të RrGK-së vazhdojnë punën e tyre të rëndësishme sot, duke u fokusuar në përmirësimin e qasjes në

---

[136] Republika e Kosovës, Qeveria, Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021, 2016.
[137] PKZMSA 2017-2021.
[138] Republika e Kosovës, Qeveria, Agjenda për Reforma Evropiane (ARE), 2016. Ajo përcakton prioritete afatshkurtra në fushat vijuese a) qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit; b) konkurrueshmëria dhe klima e investimeve; dhe c) punësimi dhe arsimi.
[139] Në prill të vitit 2018, anëtaret e RrGK-së vendosën të shtojnë këtë program në Strategjinë e RrGK-së.

arsim për grupet etnike minoritare dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

Përtej konceptit klasik të arsimit, RrGK e interpreton këtë program në atë mënyrë që të përfshijë arsimin joformal në lidhje me feminizmin.

Në nëntor të vitit 2013, RrGK ka Organizuar Forumin Rajonal të Feministeve të Reja 2013, ku 40 feministe të reja nga Kosova dhe nga vendet fqinje (Serbia, Maqedonia e Veriut, Kroacia) u mblodhën në Prishtinë dhe diskutuan strategjitë e avokimit, feminizmin dhe pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje. Në Deklaratën përfundimtare të Forumit[140], vajzat ndër të tjera, sa i përket fushës së arsimit, kërkuan që Ministria e Arsimit,

Forumi Rajonal i Feministeve të Reja

Shkencës dhe Teknologjisë, ajo e Financave dhe Parlamenti të sigurojnë libra dhe transport për vajzat, veçanërisht në qoftë se familjet e tyre nuk mund të përballojnë shpenzimet për shkollimin e tyre për shkak të kufizimeve financiare. Feministet e reja poashtu kërkuan nga Qeveria që të zbatohet Ligji për Arsimin Parauniversitar, i cili kërkon nga prindërit që ti dërgojnë fëmijët në shkollë. Ato gjithashtu bënë thirrje për psikologët në shkolla për të ndihmuar vajzat e reja në tejkalimin e sfidave që mund ti ndalojnë ato për të vazhduar shkollimin. RrGK ka

[140] RrGK, Deklarata e Forumit Rajonal të Feministeve të Reja.

vazhduar të avokojë për këto çështje dhe shumë prej këtyre feministëve të rinj kanë vazhduar punën e tyre të avokimit si pjesë e lëvizjes më të gjerë feministe.

Në vitin 2013, RrGK vazhdoi të përkrahë arsimin e vajzave, përmes përkrahjes së themelimit të Fondacionit për arsimimin e vajzave "Çifti Buçinca". Për 60 vite me radhë, Naxhije dhe Fahri Buçinca kanë punuar për arsimin formal dhe joformal të vajzave, ata krijuan këtë Fondacion, për të vazhduar kontributin e tyre duke u mundësuar vajzave qasje në arsim për vitet në vijim. RrGK përkrahu mbrëmjen gala që mblodhi shumën prej 23,969€ për Fondacionin, kryesisht nga bizneset lokale, organizatat dhe individët. RrGK gjithashtu ofroi një donacion prej 1,000€ për këtë Fondacion. RrGK gjithashtu ka nderuar kontributin çiftit Buçinca me një certifikatë mirënjohjeje.

Në vitin 2016, RrGK publikoi raport in "Buxhetimi drejt një arsimimi më të mirë."[141] RrGK bashkëpunoi me MAShT-in drejt institucionalizimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, që përfshinte një analizë gjinore të punës së Ministrisë. Kjo ka identifikuar disa fusha në të cilat barazia gjinore mund të përmirësohet në lidhje me arsimin në Kosovë.

Ndërkaq, RrGK ka përkrahur iniciativa të ndryshme avokuese drejt rritjes së qasjes së vajzave dhe grave në edukim përmes përkrahjes së organizatave anëtare përmes FGK.

[141] RrGK, *Buxhetimi drejt një arsimimi më të mirë*, Prishtinë: RrGK, 2016.

Në vitin 2017, i përkrahur nga FGK, Aksioni për Nëna dhe Fëmijë (AMC) ka avokuar tek Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë, për të vendosur bashkëpunim të vazhdueshëm me AMC-në për të angazhuar studentët në projektet e AMC-së. Gjithashtu, avokimi i AMC-së tek Udhëheqësja e Divizionit për Shëndetin e Nënës dhe Fëmijës në Ministrinë e Shëndetësisë, bëri që ata të përfshinin depresionin e pas-lindjes në kurrikulën edukative në Klasat për Nëna.

Aksioni për Nëna dhe Fëmijë trajnon infermieret dhe mamitë si ti trajtojnë gratë me depresion pas lindjes

Poashtu, e përkrahur nga FGK, Qendra për Art dhe Komunitet "Artpolis" në partneritet me Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave përdori artin që të vetëdijesojë 130 gra dhe vajza nga komuna e Prishtinës dhe ajo e Drenasit në lidhje me të drejtat e tyre të shëndetit riprodhues dhe edukimin seksual. Organizatat anëtare të RrGK-së poashtu avokuan tek MASHT për futjen dhe zbatimin e edukimit seksual në kurrikulat mësimore për shkollat e mesme.

Një çështje tjetër e rëndësishme është edukimi seksual i pamjaftueshëm në shkolla. Gjersa kurrikula ekziston, nxënësit raportojnë se pak mësues e ndjekin atë. Kjo është pjesërisht për shkak të normave kulturore që e bëjnë tabu diskutimin e temave të tilla në publik dhe trajnimi i pamjaftueshëm i mësuesve se si t'iu përgjigjen pyetjeve të tilla. OShCG-të kanë punuar për të ngritur vetëdijen për sëmundjet seksualisht të transmetueshme në mesin e të rinjve dhe grupeve të margjinalizuara. Megjithatë, nevojitet një qasje më e institucionalizuar.

Sfidimi i normave dhe marrëdhënieve gjinore përmes arsimit mbetet çelësi për transformimin e normave gjinore në jetën e përditshme. Investimi në përmirësimin e kurrikulave dhe metodave të mësimdhënies është i rëndësishëm për adresimin sistematik të shkaqeve rrënjësore të pabarazive gjinore.

Sfidat kryesore

- Shkalla e vijueshmërisë së arsimit parauniversitar për vajzat dhe djemtë është e ngjashme (48.7% vajzat ndaj 51.3% djemtë), me përjashtim të arsimit parashkollor, ku vijueshmëria e djemve është pak më e madhe (53.8%).[142] Në përgjithësi, vijueshmëria në arsimin parashkollor në Kosovë është e ulët për shkak të pamjaftueshmërisë të institucioneve parashkollore që janë të përballueshme nga familjet kosovare,[143] gjë që bën që Kosova të jetë larg nga Objektivat e Barcelonës të BE-së.[144]
- Sa i përket përkatësisë etnike, shkalla e vijueshmërisë së nxënësve në arsimin parauniversitar, është pothuajse në proporcion me demografinë e Kosovës.[145] Mirëpo, sistemi arsimor nuk ka të dhëna të mjaftueshme të ndara sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë, gjë që e bën të vështirë kuptimin e dallimeve në mes të djemve dhe vajzave.[146]
- Në Kosovë, ekzistojnë pesë Qendra Burimore dhe dy shkolla për fëmijët me nevoja të veçanta dhe më shumë djem

---

[142] Donjeta Morina për Këshillin e Evropës, "Analiza Gjinore Ndërsektoriale në arsimin parauniversitar", 2020.
[143] Shiko, RrGK, *Kush kujdeset?* Prishtinë: RrGK, 2016.
[144] "Objektivat e Barcelonës", u caktuan në 2002 nga prijësit e BE-së. Ato thonë se arsimi parashkollor duhet të ofrohet për 90% të fëmijëve mes moshës tre vjeç dhe moshës së shkollimit të detyrueshëm dhe për 33% të fëmijëve nën moshën tre vjeç (KE, *Objektivat e Barcelonës: Zhvillimi i institucioneve për kujdesin e fëmijëve për fëmijët e vegjël në Evropë me qëllim të rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse*, f. 5).
[145] RrGK, *Analiza Gjinore e Kosovës*, 2018.
[146] RrGK, *Analiza Gjinore e Kosovës*, f. 36.

(59%) se vajza (41%) me nevoja të veçanta vijojnë arsimin e detyrueshëm[147] Edhe pse me ligj parashihen dispozita të veçanta për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore,[148] mungon alokimi i buxhetit për përmbushjen e tyre.

- Në arsim të mesëm të lartë 58.5% të mësimdhënësve janë burra krahas 41.5% grave. Në nivelin para-fillor, fillor, dhe të mesëm të ulët 42.5% janë burra, krahas 57.5% grave, ndërsa në nivelin parashkollor 100% të mësimdhënësve janë gra.[149]
- Kurrikulat mësimore ekzistuese në Kosovë, në të gjitha nivelet e arsimimit, dhe metodat e mësimdhënies në shumë raste ende fuqizojnë stereotipet gjinore.[150] Transformimi i roleve të ndara gjinore brenda kurrikulave dhe metodat e mësimdhënies mund të promovojë barazinë gjinore në të gjitha sferat e jetës.
- Si duket, në shkolla, pak të rinj mësojnë rreth çështjeve që ndërlidhen me seksualitetin dhe shëndetin seksual dhe riprodhues.[151] E njëjta vlen edhe sa i përket mësimit rreth përdorimit të kontraceptivëve, ku thuhet se mësimdhënësit rregullisht e anashkalojnë edukatën e shëndetit riprodhues pa e ligjëruar fare.[152] Kjo mund të ndikojë në informimin e pasaktë. Njohuritë e kufizuara rreth kontraceptivëve mund të ndikojnë në shkallën e abortit ose në rritjen e riskut nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme.[153]

---

[147] Donjeta Morina për Këshillin e Evropës, "Analiza Gjinore Ndërsektoriale në arsimin parauniversitar".
[148] Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenet 39 dhe 40.
[149] Donjeta Morina për Këshillin e Evropës, "Analiza Gjinore Ndersektoriale në arsimin parauniversitar".
[150] Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë (YIHR KS), Gjuha diskriminuese në tekstet shkollore, 2017.
[151] RrGK, *Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë*.
[152] Sipas vrojtimeve të anëtareve të RrGK.
[153] RrGK, *Analiza Gjinore e Kosovës*, 2018, f. 56.

Strategjia e RrGK-së

Duke marrë parasysh këto sfida, qëllimi afatgjatë i këtij programi është: **Përmirësimi i qasjes në arsim cilësor që sfidon normat ekzistuese gjinore dhe marrëdhëniet e pushtetit.** Objektivat dhe rezultatet e pritura janë të renditura detajisht më poshtë.

Objektivi specifik 4.1. Përmirësohet mënyra e mësimdhënies nga mësimdhënësit për kurrikulat dhe tekstet shkollore, nga perspektiva e edukimit transformues gjinor dhe feminist.

Nëse kurrikulat si dhe edhe metodat e mësimdhënies që përdoren nga mësuesit përmirësohen për të përfshirë një qasje transformuese gjinore, atëherë kjo do të kontribuojë në arsim me cilësi më të lartë që sfidon normat dhe marrëdhëniet gjinore.

Rezultati i pritur 4.1.1. Rekomandimet ekzistojnë dhe u dërgohen akterëve përkatës për përmirësimin e mësimdhënies nga mësimdhënësit për kurrikulat dhe tekstet e kurrikulës. RrGK do të monitorojë procesin e rishikimit të kurrikulës nga perspektiva gjinore. Bazuar në monitorimin, RrGK do të ofrojë rekomandime për ndryshimin e kurrikulave për institucionet me qëllim të reduktimit të pabarazive gjinore, transformimit të roleve gjinore dhe ndryshimit të normave gjinore dhe marrëdhënieve të pushtetit. Tekstet arsimore universitar, do të duhej të synonin edukimin e avokatëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve të ardhshëm të Kosovës se si duhen trajtuar rastet e dhunës me bazë gjinore. RrGK do të bashkëpunojë me akterë të tjerë për të avokuar për rishikimin dhe rishikimin e teksteve aktuale, për të promovuar më mirë barazinë gjinore dhe qasjen në drejtësi për gratë.

Rezultati i pritur 4.1.2. Institucionet janë më të përgjegjshme duke transformuar normat gjinore për mësimdhënien në lëndën e edukimit seksual në shkolla. Tekstet shkollore duhet të jenë ndër burimet kryesore të informacionit të saktë mbi seksualitetin

dhe shëndetin seksual dhe riprodhues, si dhe për përdorimin e kontraceptivëve. Informacioni i saktë zvogëlon rrezikun e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, si dhe shkallën e aborteve. RrGK-ja do të bashkëpunojë me anëtarët e saj për të monitoruar cilësinë dhe shpërndarjen e këtij edukimi, si dhe të avokojë për përmirësimin e edukimit seksual në shkolla.

Rezultat i pritur 4.1.3. Më shumë vajza, gra, djem dhe burra të vetëdijshëm për normat gjinore dhe feminizmin.

Grupet e interesit

Grupi i synuar dhe përfituesit potencial primar do të jenë zyrtarët brenda institucioneve arsimore, kapacitetet e të cilëve mund të rriten duke ndjekur rritjen e ndërgjegjësimit dhe përpjekjet avokuese. Përfituesit sekondar do të përfshijë të gjithë kosovarët, të cilët do të përfitojnë nga përmirësimet në sistemin e arsimit.

Organizatat anëtare të RrGK-së do të jenë partnerët kryesorë në zbatimin e këtyre përpjekjeve. RrGK gjithashtu do të kërkojë që të bashkëpunojnë dhe koordinojnë me akterë të tjerë të fokusuar në këtë sektor, si MASHT, komunat e Kosovës duke përfshirë Departamentet për Arsim, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Programi Universitar për Studime dhe Hulumtime Gjinore, ABGj, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë (PEN), Zyra e BE-së në Kosovë, ADA, GIZ, USAID, UNICEF, Care International, Balkan Sunflowers, Këshilli Rinor Kosovar dhe OJQ The Ideas Partnership.

Qasja ndërlidhëse: Feminizmi

Situata

RrGK është rrjet feministë me qëllime feministë. Për këtë arsyeje, secili nga programet më lart do të kontribuojë në edhe në Fuqizimin e Lëvizjes Feministe në Kosovë.

Historikisht, dhe deri së fundi, pak gra në Kosovë donin të përdornin fjalën 'feminizëm'. Zhvillimet e fundit mund t'i atribuohen punës së organizatave të të drejtave të grave, Programit Universitar për Studime dhe Hulumtime Gjinore në Universitetin e Prishtinës, i cili ka edukuar shumë të rinj në teorinë feminist, dhe informacioneve të shumta që janë në dispozicion përmes internetit rreth lëvizjeve feministe. Progresi është bërë falë akterëve të ndryshëm nga universiteti, organizata të ndryshme dhe aktivistë individual, të cilët kombinuan përpjekjet për të avokuar për barazi gjinore duke rritur qasjen ndërlidhëse, gjatë ngjarjeve si Dita Ndërkombëtare e Gruas dhe Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut. Iniciativat e përbashkëta në këto ditë, të mbajtura nga kolektivet e tyre organizuese, shërbejnë si një bazë e rëndësishme për të çuar përpara lëvizjen feministe në Kosovë.

Pa marrë parasysh përparimin, ende ka mungesë të solidaritetit mes grave. Marrëdhëniet e pushtetit në mes grave ende mund të minojnë një lëvizje feministe gjithëpërfshirëse dhe të larmishme. Për më tepër, shumë njerëz ende nuk e dinë kuptimin e asaj se çka është feminizmi, çfarë do të thotë të jesh një feminist në praktikë dhe se si feminizmi lidhet me aktivizmin.

Për RrGK-në, mbështetja e anëtareve tona, aktivistëve të ndryshëm për të drejtat e grave dhe grave të ndryshme që ata mbështesin, kontribuon në avancimin e lëvizjes feministe në

Kosovë. Duke fuqizuar organizatat dhe aktivistët e ndryshëm për të drejtat e grave, ne mbështesim rritjen e një lëvizje feministe të

Arritjet kryesore të RrGK-së

- Ofrimi i komunikimit dhe bashkëpunimit të rregullt dhe të vazhdueshëm ndërmjet anëtarëve të RrGK-së dhe palëve të tjera të interesuara përmes takimeve të rrjetëzimit. Takimet krijuan një hapësirë për gratë aktiviste për të diskutuar çështje, për të strategjizuar dhe për të ndërtuar solidaritetin si një lëvizje feministe.
- Përfshirja e së paku 3,670 aktivistëve të rinj në lëvizjen në Kosovë përmes aktiviteteve, praktikave apo vullnetarizmit në RrGK, duke fuqizuar liderët e rinj.
- Përmirësimi i kapaciteteve institucionale dhe avokuese të RrGK-së dhe anëtarëve të tij, drejt qëndrueshmërisë afatgjatë. Organizatat më të forta kontribuojnë në një lëvizje më të fortë.
- Rritja e bashkëpunimit mes grave në rajon lidhur me lëvizjen feministe.
- Rritja e solidaritetit, mbështetjes dhe bashkëpunimit ndërmjet organizatave anëtare gjatë pandemisë COVID-19 përmes vlerësimeve të rregullta të nevojave, një strehimi të fuqizimit, granteve të FGK-së që arrijnë në 1699 përfitues të drejtpërdrejtë dhe avokimit që institucionet dhe delegacionet ndërkombëtare të adresojnë nevojat e aktivistëve gjatë pandemisë.

grave në Kosovë. Prandaj, pjesa më e madhe e punës sonë të mëparshme është përqendruar në fuqizimin e anëtareve tona.

Sfidat kryesore

Duke marrë parasysh arritjet e RrGK-së në vitet e kaluara, OShCG-të dhe lëvizja feministe në Kosovë ende përballen me sfidat e mëposhtme:

- Frika nga feminizmi mbetet e përhapur në mesin e shumë grave dhe burrave në Kosovë, gjë që mund të minojë ndërtimin e një lëvizjeje feministe.
- Vlerat feministe mbeten të paqarta për shumëkënd në Kosovë, duke përfshirë mënyrën e zbatimit të tyre në praktikë brenda lëvizjes (p.sh. nevoja për të sfiduar strukturat ekzistuese të pushtetit që minojnë barazinë dhe nevojën për të siguruar një qasje ndërsektoriale).
- Mediat dhe fushatat negative kundër gjinisë në mediat sociale mund të arrijnë të bëjnë konfuz shumë njerëz, duke minuar qëllimet feministe.
- Ndërsa qasjet e mëparshme derë më derë që përfshinin uljen me gratë dhe burrat për të ndryshuar pikëpamjet tradicionale kanë qenë efektive, ato janë të vështira për t'u organizuar duke pasur parasysh se ato kërkojnë kohë dhe burime intensive, veçanërisht në mes të një rënie të përgjithshme të vullnetarizmit në krahasim me vitet 1990.
- Komunikimi dhe bashkëpunimi i pamjaftueshëm mes feministëve, i shoqëruar me konkurrencën për financim minon solidaritetin dhe ndërtimin e një lëvizjeje efektive feministe. Çështjet personale, interesat individuale (përfshirë nepotizmin), thashethemet dhe përgojimet mund të ndikojnë negativisht në ndërtimin e një lëvizjeje të fortë feministe.
- Është bërë pak përpjekje për të lëvizur feminizmin përtej diskutimeve teorike, për të vendosur strategji që forcojnë lëvizjen feministe ose për të inkorporuar parimet feministe në politikë dhe vendimmarrje. Feministët në Kosovë, rajon dhe më gjerë, nuk kanë strategji të qarta se si të avancojnë

lëvizjen feministe, duke përfshirë farkëtimin e lëvizjeve feministe të ndërlidhura, përfshirëse lokale dhe globale.

- Lëvizja përballet me disa sfida të burimeve njerëzore dhe financiare që minojnë efikasitetin, efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e tyre.[154]
- Proceset e prokurimit gjatë aplikimeve për grante mund të rezultojnë që burimet t'u shkojnë kompanive që shkruajnë propozime të forta, por nuk kanë domosdoshmërisht ekspertizë për të avancuar më tej barazinë dhe të drejtat e grave. Gjithashtu, proceset e prokurimit mund të rezultojnë në konkurrencë ndërmjet OShCG-ve, në vend të bashkëpunimit që mund të kontribuojë në ndryshime më të mira.
- Fondet shpesh rezervohen ose 'lidhen' me aktivitete të veçanta, duke parandaluar fleksibilitetin për aktivizmin e OShCG-ve.
- Kufizimet e donatorëve me të cilat ballafaqohet RrGK ndonjëherë transferohen tek anëtarët e RrGK-së, veçanërisht kohëzgjatjet e granteve dhe kufizimet buxhetore. RrGK ka avokuar që nga viti 2012 për të rritur ndërgjegjësimin e donatorëve mbi nevojat e OShCG-ve dhe se afatet e shkurtra dhe shumat e vogla të granteve pengojnë ndryshimet afatgjata. Kufizimet në kohëzgjatjen dhe buxhetin e granteve të FGK-së ishin të dobishme gjatë viteve fillestare të FGK-së, veçanërisht për të menaxhuar rreziqet e mundshme. Tani që FGK është testuar, kufizime të tilla nuk janë më të nevojshme.[155]
- RrGK ka fonde rezervë minimale (duke ndikuar kështu në sigurinë e pagave të stafit), dhe RrGK varet nga fondet e donatorëve të jashtëm edhe për të ardhmen. Të ardhura të

---

[154] RrGK, *Ku janë paratë për të drejtat e grave*, 2020.

[155] Mainlevel Consulting AG, *Vlerësimi i jashtëm i Rrjetit të Grave të Kosovës, strategjisë së saj për 2015-2018 dhe Programeve kyçe që kontribuojnë në strategji*, 2018.

tjera si anëtarësimi, shërbimet e konsulencës dhe donacionet individuale mbeten të kufizuara, pavarësisht përpjekjeve për mbledhjen e fondeve.

- Kosova nuk ka një kornizë ligjore që inkurajon individët dhe bizneset të bëjnë donacione për organizatat jofitimprurëse.
- Duke pasur parasysh avokimin dhe punën e tyre, RrGK dhe anëtarët e saj nuk kishin burime të mjaftueshme njerëzore për të eksploruar mundësitë e filantropisë dhe burimet alternative që mund t'i mbështesnin nëse fondet e huaja reduktohen në të ardhmen. Ky rrezik u rrit në mënyrë eksplicite dhe ishte i pranishëm gjatë pandemisë, pasi shumë OShCG-ë u ndërprenë nga fondet dhe puna e tyre u kufizua ose u mbyllë plotësisht.
- Meqenëse jo të gjitha organizatat kanë projekte të qëndrueshme afatgjata, shumë organizata kanë angazhuar vullnetarë në vend të stafit të përhershëm. Kjo mund të pengojë stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e tyre afatgjatë, duke kontribuar në parregullsi në ruajtjen e njohurisë. Ndërsa vullnetarizmi nxit pro-aktivitetin dhe shmang varësinë nga donatorët e jashtëm, vullnetarizmi i tepërt mund të jetë kundërproduktiv për qëndrueshmërinë, veçanërisht nëse ndryshimi i parashikuar është në plan afatgjatë.[156]
- Edhe pse OSHCG-të kanë rritur kapacitetet e tyre përmes mentorimit të ofruar nga RrGK, disa organizata ende mund të rrisin kapacitetet e tyre organizative, financiare dhe avokuese.[157]
- Komunikimi dhe koordinimi i pamjaftueshëm ndërmjet organizatave, donatorëve dhe palëve të tjera të interesuara mund të çojë në dublim të përpjekjeve, mbivendosje dhe joefikasitete në punën drejt barazisë gjinore.

---

[156] Po aty, f. 37.
[157] Po aty, f. 22.

- Ndërsa disa OShCG-ë kanë përvojë të gjerë në avokim, të tjerat kanë nevojë për mbështetje shtesë për të udhëhequr anëtarët dhe komunitetet e tyre në avokimin për të drejtat e tyre dhe për t'i mbajtur zyrtarët përgjegjës.
- Sipas strukturave patriarkale në Kosovë, gratë priren të jenë "kujdestare" primare. Kjo krijon vështirësi për aktivistët e të drejtave të grave në balancimin e punës së kujdesit me kujdesin për veten dhe profesionet tona. Shumë aktivistë përjetojnë djegie profesionale, gjë që kontribuon në qarkullimin e stafit. RrGK ka ofruar psikoterapi për stafin e saj. Megjithatë, OShCG-të ende duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje nevojës për vetëkujdes, për shkak të vështirësive shëndetësore dhe mendore që lindin dhe shkaktohen nga rraskapitja e rrënjosur, pasi këto mund të minojnë lëvizjen feministe.

Strategjia e RrGK-së

Për të adresuar sfidat e lartpërmendura dhe drejt qëndrueshmërisë afatgjatë të RrGK-së dhe anëtarëve të saj, qëllimi afatgjatë i këtij programi është: **të forcojë lëvizjen ekzistuese feministe në Kosovë, rajon dhe më gjerë**. Drejt këtij qëllimi, RrGK do të përpiqet të arrijë objektivat e mëposhtme sipas kësaj Strategjie.

Objektivi 5.1. Rritja e solidaritetit dhe mirëqenies në mes të organizatave të grave dhe aktivistëve.

Përvoja e RrGK-së sugjeron që avancimi dhe përkrahja e solidaritetit në mes OShCG-ve është vendimtare për të ndërtuar një lëvizje të qëndrueshme feministe. Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet arritjes së rezultateve të pritshme në vijim.

Rezultati i pritur 5.1.1. Më shumë aktivistë burra dhe gra, vajza dhe djem të përfshirë në lëvizjen feministe.

Lëvizja feministe mund të jetë e qëndrueshme vetëm nëse ajo rekruton vazhdimisht anëtarë të rinj, veçanërisht vajza dhe djem, të cilët do ta mbajnë lëvizjen aktive në të ardhmen. Drejt këtij rezultati, RrGK planifikon të vazhdojë takimet e rregullta të rrjetëzimit për të sjellë së bashku aktivistë të ndryshëm; të përfshijë vajza dhe djem, gra dhe burra në avokimin e prioriteteve të tyre; të sigurojë punë praktike për të rinjtë dhe të rejat që të punojnë me RrGK dhe organizatat e saj anëtare, që të fitojnë përvojë dhe shkathtësi; të ofrojë mundësi për vullnetarizëm; dhe t'i përfshijë ata në fushata vetëdijesimi dhe aktivitete të tjera.

Rezultati i pritur 5.1.2. Rritja e vetëkujdesit dhe sigurisë së aktivistëve për të drejtat e grave

Bazuar në mësimet e nxjerra dhe përvojat e AWID, RrGK do të organizojë forume të grave mbi mirëqenien, vetëkujdesin dhe sigurinë e aktivistëve për të drejtat e grave. Organizimi do të sigurojë hapësirë për aktivistët, duke përfshirë përfaqësuesit e organizatave anëtare të RrGK-së, për të folur, reflektuar dhe përfshirë rituale të ndërgjegjes që mund të kontribuojnë në rritjen e ndjenjës së tyre të vetëkujdesit dhe mirëqenies. Kjo do të kontribuonte, siç vëren AWID në një "mjet politik në rritje për të siguruar mbijetesën e lëvizjes feministe, si dhe mirëqenien tonë personale". RrGK gjithashtu do të vazhdojë të ofrojë psikoterapi për stafin dhe anëtarët aty ku është e mundur.

Rezultati i pritur 5.1.3. Përmirësimi i kapaciteteve të anëtarëve të RrGK-së , drejt qëndrueshmërisë së tyre.

Duke kryer Vlerësimin e Kapaciteteve Organizative dhe Avokuese (OACA) me përfituesit e granteve të FGK-së dhe organizatat e tjera anëtare të interesuara, RrGK do të identifikojë fusha specifike në të cilat anëtarët e RrGK-së kanë nevojë për mbështetje. Bazuar në OACA, RrGK do të mbështesë anëtarët në zhvillimin e planeve të përshtatura për zhvillimin e kapaciteteve drejt adresimit të prioriteteve të tyre të

identifikuara për zhvillimin e kapaciteteve. Më pas, RrGK do të ofrojë mentorim individual drejt mbështetjes së anëtarëve në realizimin e synimeve të tyre. RrGK do të vazhdojë të ofrojë grante përmes FGK-së, duke përdorur qasjen 'të mësuarit duke bërë' për avokim, menaxhim organizativ dhe menaxhim të granteve. Duke pasur anëtarë më të fortë, kjo do të kontribuojë në një lëvizje më të fortë feministe.

Rezultati i pritur 5.1.4. Kapacitetet e stafit të RrGK-së të rritura. RrGK ka staf të përkushtuar dhe të fortë, por e konsideron të rëndësishëm të mësuarit dhe zhvillimin e shkathtësive të vazhdueshme. Prandaj, RrGK do të vazhdojë të inkurajojë pjesëtarët e stafit të saj për të vazhduar arsimimin e tyre, për të ndjekur trajnime shtesë dhe për të marrë trajnime dhe mentorim në vendin e punës, drejt rritjes së mëtejshme të kapaciteteve të tyre, veçanërisht lidhur me parimet, metodologjitë dhe strategjitë feministe. RrGK gjithashtu do të krijojë një program më formal të vullnetarëve për të avancuar kapacitetet e aktivistëve të tjerë. Në bashkëpunim me anëtarët e saj, RrGK do të zhvillojë një program që organizon më mirë punën e vullnetarëve dhe përfshirjen e tyre në lëvizjen feministe, duke punuar me RrGK-në dhe anëtarët e saj.

Objektivi 5.2. Përmirësimi i klimës së financimit për organizatat për të drejtat e grave.

Edhe pse disa nisma avokuese mund të ndërmerren mbi baza vullnetare, OShCG-të ende kanë nevojë për burime për të mbështetur shumë aspekte të punës së tyre të rëndësishme. Aktivizmi i qëndrueshëm për të drejtat e grave kërkon burime dhe RrGK do të vazhdojë përpjekjet e saj për të mobilizuar burime të mjaftueshme nga akterët vendorë dhe ndërkombëtarë për të mbështetur lëvizjen e grave në Kosovë dhe më gjerë. Kjo do të arrihet përmes rezultateve të mëposhtme.

Rezultati i pritur 5.2.1. Zbatimi i përmirësuar i Strategjisë së RrGK-së për Mobilizimin e Burimeve.
RrGK do të bashkëpunojë me anëtarët, Bordin dhe partnerët e saj në ndërmarrjen e aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë e Mobilizimit të Burimeve. Kjo përfshin diversifikimin e mëtejshëm të burimeve të RrGK për të mbështetur qëndrueshmërinë e vet afatgjatë.

Rezultati i pritur 5.2.2. Njohuri dhe mirëkuptim i përmirësuar në mesin e financuesve relevantë lidhur me llojet e mbështetjes që OShCG-të e ndryshme kanë nevojë.
Kjo përfshin rritjen e njohurive të tyre në lidhje me ndikimin afatgjatë që mund të kenë OShCG-të në sjelljen e ndryshimeve politike, sociale dhe ekonomike; dhe rëndësinë e ofrimit të mbështetjes afatgjate operacionale për ndikimin strategjik. Bazuar në hulumtimin e RrGK-së,[158] RrGK do të takohet me donatorë të ndryshëm për t'i informuar ata rreth situatës financiare të OShCG-ve dhe lëvizjes së grave, si dhe për të diskutuar mënyrat për të përmirësuar mbështetjen e donatorëve për OShCG-të dhe lëvizjen feministe. RrGK gjithashtu do të shkruajë letra avokuese aty ku është relevante.

Grupet e interesit

Drejt arritjes së këtyre objektivave strategjike, RrGK parasheh bashkëpunim të vazhdueshëm me organizatat e saj anëtare dhe me grupet e të drejtave të grave në rajon. Anëtaret e RrGK dhe vetë rrjeti, do të jenë grupi kryesor i synuar i këtij programi. Qytetarët, veçanërisht gratë dhe vajzat, poashtu do të përfitojnë nga një lëvizje e qëndrueshme feministe që avokon në emër të tyre. RrGK do të bashkëpunojë dhe koordinojë mbështetjen e saj për OShCG-të me akterë të tjerë që kërkojnë të ngritin kapacitetet e shoqërisë civile, të tillë si BE, USAID,

[158] RrGK, *Ku janë paratë për të drejtat e grave*, 2020.

Agjencia Suedeze Ndërkombëtare për Zhvillim (Sida), Fondacioni Kvinna till Kvinna, ADA dhe Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Partnerët për avokim rajonal dhe ndërkombëtar përfshijnë: Fondacionin Kvinna till Kvinna, organizatat partnere në rajon, Shoqata për të Drejtat e Grave në Zhvillim (AWID), MamaCash, Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësi dhe Negociata për Zgjerim (DG NEAR) si përgjegjëse për financimin e OShCG-ve në vendet e BP, Drejtorisë së Përgjithshme për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (DG DEVCO) që luan një rol udhëheqës në vendimet e financimit në nivel ndërkombëtar, Qendra për Përsosmëri Tematike për mbështetjen e Shoqërisë Civile në DG NEAR që është përgjegjëse për ofrimin e udhëzimeve dhe propozimin e qasjeve për financimin e OShC-ve, Këshilltarin Gjinor në DG NEAR, përgjegjës për ndjekjen dhe mbështetjen e zbatimit të PVGJ III. Akterë të tjerë kyç përfshijnë: ABGj, Institucionin e Avokatit të Popullit, Ministrinë e Integrimit Evropian, Zyrën për Qeverisje të Mirë, deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe zyrtarët qeveritarë.

Qasja ndërlidhëse: Mbrojtja e Mjedisit

Ligjet, politikat dhe mekanizmat institucional

- Ligji për Barazi Gjinore kërkon integrimin gjinor të të gjitha ligjeve, rregulloreve, strategjive, planeve të veprimit, rregulloreve dhe dokumenteve të tjera.
- Sipas Strategjisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022, zhvillimi social dhe ekonomik shkojnë paralelisht me një mjedis të shëndetshëm dhe kjo është thelbësore për Kosovën si vend i prekur nga konflikti.
- Strategjia e Kosovës për Ndryshimet Klimatike
- Edhe pse Kosova ende nuk e ka nënshkruar Konventën Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), ajo ka përgjegjësinë t'u përgjigjet kërkesave si një nga nënshkruesit e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Traktati i Komunitetit të Energjisë përcakton gjithashtu objektiva të qarta për ndryshimet klimatike dhe për reduktimin e përdorimit të energjisë së prodhuar nga thëngjilli, ndërsa bën thirrje për një rritje të përqindjes së burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Analiza e situatës

Çështjet mjedisore ndikojnë ndryshe në mirëqenien e grave dhe burrave. Politikat që synojnë të adresojnë nevojat e ndryshme të burrave dhe grave të ndryshme mund të krijohen vetëm duke shqyrtuar se si planifikimi hapësinor dhe politikat mjedisore ndikojnë në mënyra të ndryshme te burrat dhe gratë. Aktualisht, politikat mjedisore në fuqi nuk marrin parasysh perspektivën gjinore. RrGK ka mbështetur Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor së bashku me të tjerët në kryerjen e

analizave gjinore për të informuar buxhetin e vitit 2017. Metodologjia e cila është ndarë me ta ka qenë dhe është ende e dobishme, por përdoret rrallë.

Sfidat kryesore

- Ekzistojnë të dhëna dhe hulumtime të pamjaftueshme në lidhje me ndikimin e degradimit mjedisor dhe ndryshimeve klimatike te burrat dhe gratë e ndryshme nga një qasje ndërsektoriale.
- Pas luftës, Kosova u përball me urbanizim të shpejtë për shkak të migrimit të brendshëm nga zonat rurale në zonat urbane. Prandaj ka shumë çështje lidhur me planifikimin hapësinor dhe mjedisin.
- Gratë dhe burrat e ndryshëm janë konsultuar në mënyrë të pamjaftueshme gjatë procesit të hartimit të legjislacionit dhe politikave në lidhje me mjedisin dhe ndryshimet klimatike, që mund të nënkuptojë se këto nuk adresojnë nevojat e ndryshme të njerëzve dhe në të njëjtën kohë mund të pengojnë zbatimin.

Strategjia e RrGK-së

Objektivi: Përmirësimi i masës në të cilën gjinia, duke përfshirë nevojat dhe interesat e ndryshme të grave dhe burrave të ndryshëm, reflektohet në politikat mjedisore dhe planifikimin urban.

Ky objektiv do të adresohet përmes Programit për pjesëmarrjen e grave në politikë dhe vendimmarrje, i cili përfshin analizën gjinore dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor lidhur me mjedisin. Bazuar në analizat, RrGK do të ndërmarrë avokim të bazuar në dëshmi për krijimin e ligjeve dhe politikave të përmirësuara në lidhje me mjedisin dhe ndryshimet klimatike që integrojnë perspektivën gjinore. Përveç kësaj, RrGK do të punojë për të

siguruar përfshirje të grave të ndryshme në diskutimin e këtyre politikave.

Për më tepër, RrGK siguron ngritjen e kapaciteteve për anëtarët e saj në minimizimin e ndikimit në mjedis të materialeve të marrëdhënieve me publikun, duke përdorur printimin ekologjik dhe ruajtjen e resurseve aty ku është e mundur. Të gjithë përfituesit e granteve të FGK marrin trajnim lidhur me mbrojtjen e mjedisit, si pjesë e sesioneve të detyrueshme orientuese. RrGK synon të mbrojë mjedisin nëpërmjet praktikave të saj organizative, duke përfshirë kursimin e energjisë, riciklimin, përdorimin e printimit ekologjik dhe përdorimin e transportit publik dhe përdorimin e përbashkët të automjeteve kur është e mundur. RrGK gjithashtu mbështet anëtarët dhe partnerët e saj në përpjekjet e avokimit për përmirësimin e kushteve mjedisore në Kosovë.

RrGK do t'i nënshtrohet trajnimeve dhe do të kërkojë të identifikojë mënyra shtesë se si mund të integrojnë vëmendjen ndaj mjedisit dhe ndryshimeve klimatike si pjesë e punës së përditshme të RrGK.

Gjithëpërfshirja

Në përputhje me misionin e saj, RrGK siguron që programet dhe aktivitetet e saj të përfshijnë persona të ndryshëm, pavarësisht nga bindjet e tyre politike, fetare, mosha, niveli i edukimit, orientimi seksual, identiteti gjinor, aftësitë, apo përkatësia etnike. Prandaj, RrGK dhe anëtaret e saj do të sigurohen se të gjitha aktivitetet do të kenë parasysh interesat dhe nevojat e posaçme të personave të ndryshëm gjatë zbatimit të programeve të ndryshme të kësaj Strategjie.

Barazia gjinore është pjesë e misionit organizativ, vizionit, programeve strategjike dhe veprimeve të RrGK-së. Analizat gjinore gjithmonë e informojnë hartimin e programeve dhe iniciativave të RrGK-së. Si pjesë e analizës gjinore, korniza ligjore relevante është analizuar gjithmonë. RrGK rregullisht përcjell grupet e synuara, duke i ndarë sipas gjinisë, moshës, aftësisë, përkatësisë etnike dhe vendndodhjes. Shënimet mbahen në bazën e të dhënave të RrGK-së për Monitorim dhe Vlerësim. Treguesit e ndjeshëm gjinor janë zhvilluar në këtë bazë të dhënash dhe përdoren për të matur progresin rregullisht. Barrierat sistematike për qasje të barabartë në burime dhe shërbime për gratë dhe burrat identifikohen dhe adresohen kryesisht nëpërmjet iniciativave të mbështetura nga FGK, por edhe nëpërmjet avokimit të nivelit kombëtar. RrGK kërkon të adresojë pengesat për pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse në nivel kombëtar përmes mentorimeve të rregullta, vizitave në zonat rurale dhe urbane, dhe mbështetjes për përpjekjet e avokimit në nivel lokal përmes FGK, Lobi-t dhe Koalicionit për Barazi.

Sa i përket **Përfshirjes Sociale**, RrGK ka analizuar kornizën ligjore përkatëse dhe kjo ka informuar iniciativat e saj, si dhe ato të përfituesve të granteve të FGK. Përfituesit e granteve të RrGK dhe FGK vazhdimisht mbajnë shënime për përfituesit, duke ndarë të dhënat sipas gjinisë, moshës, aftësisë, grupit etnik dhe

vendndodhjes. Informacioni regjistrohet në bazën e të dhënave për monitorimin dhe vlerësimin e RrGK.

Në përgjithësi, RrGK-ja synon të sigurojë që asnjë individ ose grup nuk përjashtohet, por kërkon të sigurojë përfshirjen në iniciativat e përkrahura nga RrGK, Lobi dhe FGK, si pjesë e qasjes "Askush të mos mbetet pas" (*Leave no one behind*). Për më tepër, duke pasur organizata të ndryshme të grave si anëtarë, RrGK synon të arrijë në zonat rurale dhe urbane, burra dhe gra të etnive, aftësive, moshave dhe rajoneve gjeografike të ndryshme. RrGK punon drejt forcimit të aftësive sociale, ekonomike dhe politike të organizatave anëtare të saj, shumë prej të cilave i përkasin grupeve të margjinalizuara. Kjo arrihet përmes sesioneve të mentorimit, angazhimit politik në Lobi, Koalicionit për Barazi dhe mundësimin e qasjes së tyre në grantet e FGK-së, veçanërisht për ata që nuk kanë qasje në burime. Standardet ekzistuese të punës dhe kushtet janë pjesë e rregullave dhe rregulloreve të RrGK-së, dhe u kalohen anëtarëve të saj përmes granteve të FGK-së, duke u ofruar atyre shabllone dhe udhëzime gjatë iniciativave të tyre.

Monitorimi dhe Vlerësimi

RrGK monitoron dhe vlerëson përparimin drejt zbatimit të Strategjisë së saj duke përdorur një bazë të të dhënave të Monitorimit dhe Vlerësimit që përmban treguesit për përparimin në secilin objektiv dhe rezultatin e pritshëm. RrGK raporton për progresin e anëtarëve të saj në gjysmëvjetor dhe e publikon këtë informacion në Raportin Vjetor. Informacione të mëtejshme në lidhje me treguesit dhe synimet e RrGK-së janë në dispozicion sipas kërkesës.

Bibliografia

Asatiani, Tengiz, Vlerësimi i Emergjencave të kujdesit obsteterik në Kosovë, Prishtinë: 2008.

Kuvendi i Kosovës dhe Misioni i Kombeve të Bashkuara, Administratës së Përkohshme në Kosovë (UNMIK), Ligji Kundër Diskriminimit, Ligji nr. 2004/3.

_____. Ligji për Barazi Gjinore në Kosovë, Ligji nr. 2004/2, Prishtinë: 2004.

_____. Ligji për trashëgiminë në Kosovë, Ligji nr. 2004/26

_____. Ligji mbi shërbimet sociale dhe familjare, Ligji nr. 02 / L-17.

_____. Kodi Penal i Kosovës 2013, Nr. 04 / L-082.

_____. Kodi i Procedurës Penale i Kosovës. 2013. Nr. 04 / L-123.

_____. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligji nr. 2008/03-L-073.

_____. Ligji për Shëndetësi, Nr. 2012/04-L-125, 2012.

_____. Ligji për Inspektoratin Shëndetësor, nr. 2006/02-L38 2006.

_____. Ligji për Sigurimet Shëndetësore, nr. 04 / L-249 2014.

_____. Ligji i Punës, Nr. 03 / L-212, 2010.

_____. Ligji për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Ligji nr. 2008/03-L072.

_____. Ligji për Policinë, Ligji nr. 03 / L-035.

_____. Ligji për Parandalimin dhe Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, 2013, Ligji nr. 04 / L-218.

_____. Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Pronësore, Ligji Nr. 03/L-154.

_____. Ligji për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje, Ligji nr. 03/L-182 2010.

_____. Ligji për Shëndetin Riprodhues, nr. 2006/02-l76.

_____. Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile të Luftës dhe Familjeve të tyre, Ligji nr. 2011/4-L-061 2014.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 2014 Zgjedhjet Parlamentare, Rezultatet e kandidatëve të zgjedhur, Prishtinë: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës, 2014, në:

http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/Ndarja%20e%20uleseve%20-20140625%20Seats%20Allocation%20ëith%20Parties%20Votes%20and%20Number%20of%20Seats_shtzohjhvp.pdf

Corrin, Chris, "Situata post-konfliktuoze në Kosovë" në *Nëse jo tani, kur?*, 11-16 Qershor 2001.

Këshilli i Evropës, *Konventa për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje*, CETS Nr. 210, 2011.

Demolli, Luljeta për Qendrën Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), *Perceptimet e shërbyesve civilë lidhur me ngacmimin seksual në vendin e punës*, Prishtinë: QKSGJ, 2010, në: http://www.womensnetwork.org/documents/20130510152601762.pdf.

Bashkimi Evropian, Udhëzimi për Punësim të Barabartë, 2000/78 / KE, Dhjetor 2000.

_____. Direktiva e trajtimit të barabartë, 2006/54 / EC, 2006.

_____. *Udhëzimi për pushimin prindëror*, 2010/18 / BE-së 2010.

_____. *Udhëzimi për punëtoret shtatzëna*, 92/85 / EC, tetor 1992.

_____. Programi Shumëvjeçar i Veprimit për Shëndetësi (2014-2020), COM / 2011/0709.

Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën 2013, 2013, në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/kosovo_2013.pdf.

Parlamenti Evropian, Rezoluta e datës 29 mars 2012 mbi Procesin e Integrimit Evropian të Kosovës, 2011/2885 (RSP).

Farnsveden, Ulf dhe Nicole Farnsworth, *Studimi gjinor në Kosovë*, Sida: Dhjetor 2012, në: http://www.swedenabroad.com/ImageVaultFiles/id_8560/cf_347/Sida_Gender_Study_in_Kosovo_2012-12-20_ORGUT_Final.PDF.

Farnsveden, Ulf, Ariana Qosaj-Mustafa, dhe Nicole Farnsworth, *Profili Gjinor i Vendit: Analizë e Diferencave Gjinore në të gjitha nivelet në Kosovë*, Prishtinë: Korniza e Kosovës për Barazi Gjinore me Ambasadën e Suedisë dhe Orgut Consulting, prill 2014 në: http://www.swedenabroad.com/ImageVaultFiles/id_20757/cf_2/Orgut_Kosovo_Gender_Profile_FINAL_2014-05-08.PDF.

Farnsworth, Nicole për RrGK, *Hulumtim kërkimor mbi shkallën e dhunës në baza gjinore në Kosovë dhe ndikimi i saj në shëndetin*

riprodhues të grave, RrGK, Prishtinë: 2008, në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20130204170213282.pdf.

_____. dhe Ariana Qosaj-Mustafa për RrGK, *Siguria fillon në shtëpi*, Prishtinë: Agjencia për Barazi Gjinore, 2008, në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20130204170828216.pdf

_____. dhe Elmaze Gashi për RrGK dhe Alterhabitus, *Ku janë paratë për të Drejtat e Grave?: Një rast studimi për Kosovën*, Prishtinë: RrGK, 2013, në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/11/20140109133636147.pdf

_____. Ariana Qosaj-Mustafa, Milva Ekonomi, Ada Shima dhe Dua Dauti-Kadriu për RrGK, *Me çfarë çmimi? Alokimet Buxhetore për Zbatimin e Kornizës Ligjore kundër Dhunës në Familje në Kosovë*, Prishtinë: RrGK, 2012, në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20130211130931258.pdf

Qeveria e Republikës së Kosovës, *Plani Kombëtar të Veprimit (PKV) për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë*, Vendimi Nr. 09/168, 29 janar 2014.

Hieros International dhe Shevolution, *Vlerësimi i jashtëm i Fondit të Grave të Kosovës*, 15 prill 2014 në: http://www.womensnetwork.org/documents/20140528100924728.pdf.

Hope Fellowships, Komisioni për Ekonomi, *Gratë në ekonominë e Kosovës*, Prishtinë: Hope Fellowships, 2014.

Human Rights Watch (HRW), *Një Javë e terrorit në Drenicë: Shkeljet e Ligjit Humanitar në Kosovë*, SHBA: HRW, 1999.

_____. *Shkeljet e Ligjit Humanitar në Kosovë*, SHBA: HRW, 1998.

_____. Kosova: *Dhunimi si armë e spastrimit etnik.*

Huygens, Pierre, Eva Marn, dhe Nenad Maksimović, *Situata dhe Analizat: Cënimi i LGBT në Kosovë në vitin 2012: Në emër të "Traditës"*, 2013.

Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), *Si votojnë gratë II*, Prishtina: KGSC, 2013, në: http://kgscenter.net/images/stories/howdowomenvoteinkosovo.pdf.

_____. *Të drejtat e trashëgimisë pronësore të grave në Kosovë*, Prishtinë: KGSC, 2011, at:

http://www.womensnetëork.org/documents/20130530153942500.pdf.

Instituti Kosovar për Politika, Hulumtim dhe Zhvillim (KIPRED) dhe Demokracia në Veprim, *Analizë e Zgjedhjeve: Trendet dhe Mësimet e Nxjerra*, Prishtinë: KIPRED, 2008.

Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), *Një fuqi primare: Një doracak për politikën, njerëzit dhe partitë në Kosovë,* Prishtinë: IKS, 2011, në: http://www.iksweb.org/repository/docs/politicallandscape_ENG_913183.pdf.

RrGK, *1325 Fakte & Fabula*, Prishtinë: RrGK, 2011, në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20130204170318465-1.pdf.

_____. Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë, Prishtinë: RrGK, 2016, në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/12/qasja.pdf.

_____. Analiza Gjinore e Kosovës, Prishtinë: RrGK, 2016, në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20181003170921410.pdf

_____. *Raporti i Monitorimit të Kodit të Mirësjelljes së RrGK dhe Plani Zhvillimor i Kapaciteteve për anëtaret*, Prishtinë: RrGK, 2012, në: http://www.womensnetwork.org/documents/20130415103927635.pdf.

_____. *Kodi mbi Etikën dhe Përgjegjësitë i RrGK*, Prishtinë: RrGK, 2007, në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/11/20130205095555770.pdf.

_____. *Grante të vogla, Ndryshime të mëdha*, Prishtinë: RrGK, 2016, në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/11/20170206152130297.pdf

_____. *Grante të vogla, Ndryshime të mëdha*, Prishtinë: RrGK, 2017, në: në: at: https://womensnetwork.org/publications/little-grants-big-changes-2015-2017-2.

_____. Kujdes me PVGj-në, Prishtinë: RrGK, 2018, në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20180305093155479.pdf

_____. *Më shumë se vetëm "Fjalë në Letër"? Përgjigja e Organeve të Drejtësisë ndaj Dhunës në Familje në Kosovë*, Prishtinë: RrGK,

2009, në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20130204170726792.pdf.

_____. Mjaft më me arsyetime: Analizë e qëndrimeve, incidencës dhe reagimeve institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë, Prishtinë: RrGK, 2015, në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20151124105025644.pdf.

_____. Ngacmimi Seksual në Kosovë, Prishtinë: RrGK, 2018, në: RrGK, 2018, në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20160224112147815.pdf.

_____. Arritja e ekulibrit: Opsionet e politikave që synojnë të informojmë amandamentimin e Ligjit të Punës në Kosovë, Prishtinë: 2016, në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20160504154201554.pdf.

_____. Buxhetimi drejt një arsimimi më të mire, Prishtinë: RrGK, 2016, në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20160607151528451.pdf.

_____. *Zëri i votuesve*, Prishtinë: RrGK, 2009, në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/11/20130205095215471.pdf.

Libertas, *Anketa mbi qëndrimet e shoqërisë kosovare ndaj homoseksualitetit: hulumtim sasior dhe cilësor mbi opinionet e qytetarëve të Kosovës,* Prishtina: Libertas, Dhjetor 2012.

Metaj, Elida, *Rishikimi afatmesëm i Projektit "Përkrahja, mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe interesave të grave dhe vajzave",* 8 gusht, 2014, në: http://www.womensnetwork.org/documents/20140902132858302.pdf.

Ministria e Financave, *Të ardhurat dhe shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme,* http://mf.rks-gov.net/en-us/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxhetiqendrore.aspx.

Ministria e Administratës Publike, *Analiza demografike, sociale dhe Vëzhgimi i Shëndetit Riprodhues në Kosovë, Prishtinë: Republika e Kosovës*, 2010.

OSCE, *Kosovo / Kosova: Si shihet, si thuhet, Pjesa III.*

Instituti Riinvest, *Të paguaj apo të mos të paguajë: Një Perspektivë Biznesi e informalitetit në Kosovë*, Prishtinë: Instituti Riinvest 2013.

Savić, Marija për Heartefact Fund, *LGBT të padukshëm: Raporti për pozitën e komunitetit LGBT në Kosovë*, Beograd: Fondi Heartefact, janar 2013,

Shima, Ada dhe Nicole Farnsworth për RrGK, *Buxhetimi për Mirëqenie Sociale: Një Analizë e shpejtë gjinore për informimin e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Prishtinë: RrGK, Bashkëpunim gjerman (GIZ), 2014, në; https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20140702111943317.pdf.

Kombet e Bashkuara, *Konventa e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave*, 1979.

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, *Deklarata e OKB-së për Parimet Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit,* A/RES/40/34, 1985.

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, Rezoluta 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, 2000.

UNDP, *Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2012: Sektori privat dhe Papunësia*, Prishtina: UNDP, 2012.

_____. *Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (Kosova),* në: http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/mdgoverview.

UNFPA, *Dhuna në baza gjinore*, Prishtinë: UNFPA, 2005.

_____. *Pulsi Publik Dokument Veprimi në Shëndetësi në Kosovë: Kënaqshmëria me shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe Perceptimi mbi Praninë e Korrupsionit,* Prishtinë: UNDP, 2013, në: http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/publicpulse/DokumentiPerVeprim_Anglisht.pdf.

_____. *Pulsi Publik mbi Gjininë*, Prishtinë: UNDP 2014.

_____. *Kosovë (KSKB 1244) Martesa e fëmijëve,* Prishtinë: UNFPA, Tetor 2012.

UNICEF in Kosovë, "*Vitet e Hershme*" ueb-faqe, në: http://www.unicef.org/kosovoprogramme/children.html.

_____. *Përmirësimi i shëndetit të grave dhe fëmijve të Kosovës 2007-2010,* Prishtinë: UNFPA, UNICEF, dhe WHO, shtator 2011.

World Bank, *Rezultatet e Analizës së fuqisë punëtore në Kosovë për vitin 2013,* Prishtina: World Bank, korrik 2014.

Youth Initiative for Human Rights (YIHR) dhe Center for Social Group Development, *Liria dhe mbrojtja për lesbiket, gejët, biseksualët dhe transgjininë në Kosovë*, Prishtina: YIHR, 2013.

Rrjeti i Grave të Kosovës
Rr. Kadri Gjata, (ish Feriz Blakçori), Kati I, nr. 8
10000 Prishtinë, Kosovë
+ 383 (0) 38 245 850
www.womensnetwork.org
info@womensnetwork.org
Facebook: Kosova Women's Network